



INICIATIVA E FERMERËVE SIPËRMARRËS

Kooperativa si mjet i rritjes ekonomike & instrument politik

Authors

Adriatik Kotorri
Rezart Prifti

Entrepreneurial Farmer's Initiative

*Cooperatives as a mean to growth and as a
political extension*

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



Entrepreneurial Farmer's Initiative

Cooperatives as a mean to growth and as a political extension

INICIATIVA E FERMERËVE SIPËRMARRËS

Kooperativa
si mjet i rritjes ekonomike
& instrument politik

Gusht 2016

PREAMBUL



Sot në bujqësi nuk është
e rëndësishme thjesht të
prodhosh, por të prodhosh me
cilësi. Bujqësia në Shqipëri po
kalon në një kohë shumë delikate,
me ngrohjen globale, mungesa e
orientimit strategjik të qeverisë,
mungesa e burimeve financiare,
parcelizimi i tokës, si dhe i shumë
çështjeve të tjera kanë sjellë nevojën
për të gjetur një zgjidhje praktike
për fermerët për të prodhuar
mjaftueshëm për tregun vendas dhe
të lulëzojnë me eksportet.

Qëllimi i këtij studimi është për të vlerësuar dhe analizuar mjedisin për kooperativat bujqësore në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë në Lushnje si një nga pjesët më të pershtatshme dhe të zhvilluara në lidhje me bujqësinë.

Rezultati i gjashtë muajve të vlerësimit dhe analizimit nëse kooperativat bujqësore në Shqipëri janë të realizueshme, si është situata në krahasim me vendet e tjera dhe standardin i literaturës, cilat janë çështjet që pengojnë krijimin kooperativave, dhe pse një fermer duhet të bashkohet me një organizatë të tillë? Përveç kësaj, ne kemi analizuar letërsinë dhe shoqatat ekzistuese të fermerëve në Shqipëri për të përcaktuar nevojën e aftësive të duhura për kurrikulat e mundshme të trajnimit.

Në përgjithësi kemi parë se fermerët kishin aftësi të ulët të nivelit dhe njohurive në lidhje me operacionet e tregut, marketingut, logjistikës, dhe politikave të çmimit. Në bazë të nivelit të njohurive të tyre funksionet dhe objektivat e kooperativave janë të vështira për tu kuptuar. Kjo nuk do të thotë se nuk ka hapësirë për zhvillime të bashkëpunimit, përkundrazi, por me një grup rregullash të ndryshme të cilat zbatohen përshtatur me kontekstin.

Ka rezultuar se shumica e faktorëve të cilët ngadalësojnë formimin e kooperativave janë të lidhura direkt me fermerët. Mungesa e vetëdijes, reminishenca komuniste ku kooperativat ishin implementuar në menyrën me të ashpër, injoranca, mungesa e orientimit dhe e mbështetjes së shtetit ishin disa nga faktorët e vlerësuar dhe analizuar. Pavarësisht arsyeve të lidhura me fermerët, ka gjithashtu faktorë të lidhur me qeverinë që mund të bënë një ndryshim të rëndësishëm në lidhje me panoramën e bujqësisë.

Kjo temë është e rëndësishme për tu studiuar për dy arsye. Së pari, rritja ekonomike që është e pashfrytëzuar për shkak të joefikasitetit, gjithashtu mungesa e madhe e optimizimit dhe investimet e duhura. Ndërlikimet shkojnë më tej çlirimin e burimeve të mëdha të kapitalit lidhur me token, prodhimin dhe punësimin. Së dyti, duke marrë parasysh gjendjen socio-ekonomike në Shqipëri, kooperativat janë mënyra shumë të efektshme për fermerët për të krijuar strategji dhe ta përdorin kooperativën si një zgjatim politik.

Studimi fillon me një shqyrtim historik të kooperativave që nga krijimi i tyre, duke përfshirë përkufizimin e tyre nga autorë dhe institucione të ndryshme, çështje të lidhura me to dhe faktorët që

pengojnë krijimin e kooperativave në Shqipëri. Vijnë me një vlerësim të situatës në Shqipëri dhe pse kemi zgjedhur Lushnjen si një rast studimi. Me tej paraqitet si propozim një kurrikul trajnuese me disa module që targetojnë fermerët.

Përqasja jonë për këtë studim filloi me intervista të shpeshta në fshatrat përreth Lushnjes. Ne intervistuam fermerët, pronarët e serave, shitësit e lëndëve të para, dhe fermerët grupuar në mënyrë informale duke i pyetur ata për problemet e tyre, çështjet me tregun, me qeverinë dhe çdo gjë. Pastaj sintetizuar dhe sollem këtu çështjet të më të përmendura. Më pas, ne kemi kryer një shqyrtim të hollësishëm të literaturës mbi temën, dhe analizuam buletinet statistikore që lidhen me Shqipërinë. Pasi krijuam në mënyrë të qartë një ide të gjerë, nga shumë studime dhe manuale trajnimi të bera nga organizatat ndërkombëtare të fokusuara te fermerët dhe shoqatat, ne hodhëm në këtë studim një grup të moduleve të trajnimit dhe çështjet thelbësore, në mënyrë të përshtatur dhe të kontekstualizuar për fermerët në Shqipëri.

Studimi përfundon me gjetjet dhe rekomandimet lidhur me fermerët, qeverinë dhe institucionet financiare.

PREAMBLE



Today in agriculture is not important to produce, but to produce with quality. Agriculture in Albania is facing a very delicate time, with global warming, lack of government strategic orientation, lack of financial resources, parcelization of land, and many others it is becoming essential to find a viable solution for farmers to produce enough for the local market and to thrive with exports. The purpose of this study is to assess and analyze the environment

for farm cooperatives in Albania and specifically in Lushnja as one of the most feasible and developed parts regarding agriculture.

The result of six months of assessing and analyzing whether agricultural cooperatives in Albania are feasible, what is the situation in comparison with other countries and the literature standard, what are the issues impeding cooperatives creation, and why a farmer should join such an organization? In addition, we analyzed literature and existing farmers' associations in Albania in order to define the need of appropriate skills for potential training curricula.

Broadly speaking we found out that farmers had low level skills and knowledge regarding market operations, marketing, logistics, and pricing policies. Based on the level of their knowledge the functions and objectives of cooperatives seem to complex. This does not mean that there is no space for cooperative developments, on the contrary, but with a different set up and implementation adapted to the context.

We found that most factors slowing cooperative formation were related directly to the farmer. Lack of awareness, communistic

reminiscence of harsh and improper cooperative implementation, ignorance, lack of state orientation and support were some of the many assessed and analyzed. Despite farmer related reasons, there are government related that could make a significant change regarding the agriculture panorama.

This topic is important to investigate for two reasons. First, the economic growth that is untapped due to inefficiencies, lack of optimization and appropriate investment is enormous. Its implication go further releasing vast resources of capital related with land, production and employment. Second, taking in consideration the socio-economic situation in Albania, cooperatives are very effective ways for farmers to strategize and use the cooperative as a political extension.

The study starts with an historic review of cooperatives since their creation, including their definition from different authors and institutions, issues related and factors impeding cooperatives creation in Albania. It follows with an assessment of Albanian situation and why we choose Lushnje as a case study. It follows with a proposed training curricula with several modules targeting farmers.

Our approach for this study started with often interviews in the villages around Lushnja. We interviewed farmers, greenhouse owners, sellers of inputs, and farmers grouped informally asking them about their problems, issues with the market, with government and everything. Then we synthesized and brought down the issues to the most mentioned. Afterwards, we conducted a thorough literature review on the topic, and analyzed statistical bulletins related with Albania. After having the big picture, we drew from many studies and training manuals from international organization focusing on farmers and associations, a set of training modules and essential topics in order to adapt and contextualize for farmers in Albania. The study ends with remarks and recommendations regarding farmers, government, and financial institutions.

PËRMBAJTJA



PREAMBUL
PREAMBLE
TABELAT
FIGURAT
SHKURTIMET

1. Kooperativat në perspektivë	23
2. Konteksti historik në Shqipëri	27
3. Infrastruktura ligjore dhe ekonomike e zonës së Lushnjës	32
3.1 Infrastruktura ligjore dhe institucionale	33
3.1.1 Legjislacioni për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.....	34
3.1.2 Politikat për zhvillimin e sektorit të bujqësisë	38
3.2 Statistika demografike, ekonomike dhe financiare	41
3.2.1 Të dhëna të përgjithshme	42
3.2.2 Prodhimi bujqësor, punësimi, mekanika bujqësore	44
3.2.3 Qarku Fier.....	49
3.2.4 Popullsia, dendësia, të ardhurat, investimet dhe punësimi	50
3.3 Bashkia Lushnjë	67
3.3.1 Pozicioni gjeografik dhe klima	67
3.3.2 Të dhëna të përgjithshme	69
3.4 Burimet e financimit të bujqësisë	79
3.5 Grupimet dhe shoqata të bashkëpunimit të fermerëve	84
4. Përkufizimi dhe kategorizimi i kooperativave	88
4.1 Përkufizimi i kooperativave	88
4.2 Parimet e ICA	90
4.3 Kategorizimi i Kooperativave	92
4.4 Rëndësia e kooperativave në zbutjen e varfërisë	94



4.5 Disa strategji që kooperativat duhet të ndjekin për tju përshtatur mjedisit të sotëm	96
4.6 Çështjet me ACS	99
4.7 Faktorët që vështirësojnë zhvillimin e kooperativave në Shqipëri	101
5. Module trajnimi që merren me aftësitë dhe hendekun e njohurive te fermerët	110
6. Gjetjet (Findings)	116
6.1 Faktorët që pengojnë zhvillimin e kooperativave	117
6. Findings (Gjetjet)	122
6.1 Factors impeding cooperative development	123
7. Rekomandime (Policy recommendations)	130
8. Referencat	149
9. Shtojca statistikore	152

1. Ndryshimi i numrit të sipërmarrjeve të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015	38
2. Organizatat e fermerëve sipas qarqeve (2014)	39
3. Popullsia e qarqeve të Shqipërisë sipas Census-it 2011 dhe Regjistrimit civil 2016	51
4. Të dhëna bazë ekonomike të Qarkut Fier	54
5. Të punësuarit në sektorin privat bujqësor dhe jobujqësor në Qarkun e Fierit	55
6. Sipërfaqja e tokës sipas llojit në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ha)	56
7. Sipërfaqja e bimëve të arave në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ha)	57
8. Prodhimi i bimëve të arës në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ton)	57
9. Numri i drufrutorëve në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 rrënje)	58
10. Prodhimi i drufrutorëve në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 ton)	60

11. Numri i gjësë së gjallë për prodhim blegtoral në Qarkun e Fierit (000 copë)	60	22. Prodhimi i drufrutorëve në Bashkinë Lushnjë (000 ton)	76
12. Volumi i prodhimit blegtoral në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi	61	23. Numri i gjësë së gjallë për prodhim blegtoral (000 copë)	77
13. Përpunimi i produkteve blegtorale në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (ton)	62	24. Volumi i prodhimit blegtoral	77
14. Zënie peshku në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (ton)	64	25. Mekanika bujqësore për Bashkinë e Lushnjes	78
15. Mekanika bujqësore për Qarkun Fier dhe në rang vendi	65	26. Numri i institucioneve të kreditit në Bashkinë Lushnjë	81
16. Të dhëna statistikore përmbledhëse për Qarkun e Fierit dhe në rang vendi	66	27. Institucionet e mikrokreditit në Bashkinë Lushnjë	83
17. Temperaturat dhe reshjet në Bashkinë Lushnjë 1900-2012	68	28. Grupimet dhe shoqata të bashkëpunimit të fermerëve	87
18. Sipërfaqja e tokës sipas llojit në Bashkinë Lushnjë (000 Ha)	71	29. Përdorimi i mekanikës në bujqësi për rrethin Lushnjë	105
19. Sipërfaqja e bimëve të arave në Bashkinë Lushnjë (000 Ha)	72	30. Përdorimi i mekanikës në punimin e tokës për rrethin Lushnjë	106
20. Prodhimi i bimëve të arës në Bashkinë e Lushnjës (000 Ton)	74	31. Raporti ne % i mekanizimit	106
21. Numri i drufrutorëve në Bashkinë Lushnjë (000 rrënje)	75		

Fig.1 Temperaturat dhe niveli mesatar mujor i reshjeve në Shqipëri **44**

Fig. 2 Pesha e sektorit bujqësor në përqindje ndaj PBB-së kombëtare **45**

Fig. 3 Ecuria e numrit të punësuarve në sektorin privat bujqësor dhe jobujqësor **47**

Fig. 4 Numri i traktorëve për 100 km² tokë të punueshme **48**

Fig. 5 Qarku i Fierit **50**

Fig. 6 Bashkia e Lushnje **67**

Fig. 7 Ilustrim i parcelizimit të tokës në rajonin e Lushnjes **102**

Fig. 8 Modeli i përthithjes së njohurive sipas E. Dale **112**

PPKZHTSH

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i
Zhvillimit të Territorit të Shqipërisë
2015-2030

AKPT

Agjencia Kombëtare e Planifikimit
të Territorit

MBZHRAU

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit
Rural dhe Administrimit të Ujërave

INSTAT

Instituti i Statistikave

BSH

Banka e Shqipërisë

SHKK

Shoqëri Kursim Krediti

NVM

Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

OJF

Organizatë Jo-Fitimprurëse

SHBB

Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor

SHBR

Shoqëritë e Bashkëpunimit
Reciprok

Iniciative e Fermerëve Sipërmarrës është përgatitur nga Qendra për Sipërmarrje dhe Inovacion (CEI) nën mbështetjen e plotë të fondacionit Freiderich Ebert Stiftung (FES). Ekipi hulumtues dhe shkrimi është bërë nga Adriatik Kotorri dhe Rezart Prifti, të dy lektorë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Ndonjëherë të qenit te jashtëm të jep mundësinë të shikosh diçka të cilën të brendshmit e vështrojnë por nuk e shikojnë, kjo si pasojë se kanë një kohë të gjatë që bashkëjetojnë me problemin. Ideja e studimit erdhi nga diskutimet në lidhje me kapacitetin e fermerëve për të prodhuar dhe fuqisë ekonomiko politike të tyre në treg.

Gjatë punës sonë kemi pasur rastin të takohen me shumë fermerë, faktorë vendorë dhe vendimmarrës. Përvoja ishte mbresëlënëse, sidomos kur vjen nga jashtë kontekstit me perspektiva të freskëta, edhe pse jo gjithmonë të dobishme, shtuar ketu dhe komunikimin e drejtëpërdrejtë me grupet e interesit.

Ne duam të falënderojmë FES për mbështetjen e plotë dhënë kësaj nisme dhe veçanërisht Frank Hantke për diskutime konceptuale që kemi pasur dhe që i dhanë formë strukturës së studimit. Ne gjithashtu duam të falënderojmë ekspertin tonë lokal Dritan Kolleshi, se me përvojën e tij në terren, kapacitetin dhe njohuritë na udhëzoje përmes disa gjetjeve shumë interesante dhe na ndihmojë me informacione shumë të nevojshme.

ACKNOWLEDGMENTS

Entrepreneurial Farmer's Initiative was prepared by Center for Entrepreneurship and Innovation (CEI) under the full support of the Freiderich Ebert Stiftung Foundation (FES). The research and writing team was made up by Adriatik Kotorri and Rezart Prifti, both lecturers at University of Tirana, Faculty of Economy. Sometimes outsiders see something that insiders miss for a long. Being inside of the problem makes them look at it but not see it. The idea of the study came from discussions on farmers capacity to produce and their leverage in the market.

During our work we had the chance to meet with many farmers, local factors, and decision-makers. The experience was impactful, especially when coming out of the context with fresh perspectives, even though not always useful, and talkin directly to the stakeholders.

We want to thank FES for the full support given to this initiative and especially Frank Hantke for conceptual discussions that we had and gave shape to the strudy structure. We also want to thank our local expert Dritan Kolleshi, that with his experience on the field, capacity, and knowledge guided us through some very interesting findings and provided with much needed insightful information.



1.

KOOPERATIVA NË RETROSPEKTIVË DHE PROBLEMATIKA E SOTME

Në mbarë botën kanë ndodhur ndryshime të shumta në fushën e agrikulturës. Me përparimin e mëtejshëm të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, elementet si teknologjia, menaxhimi, kërkimi i specializuar dhe subvencionet shtetërore kanë ndihmuar fermerët të marrin përfitime nga ekonomia e shkallës dhe ekonomia e madhësisë. Rritja e kërkesës për produkte agrikulturale e cila ka ardhur si pasojë e urbanizimit i ka bërë fermerët më të ndjeshëm kundrejt luhatjeve të tregut dhe fenomenve të tjera lidhur me të.

Ka gjithashtu vende të tjera të cilat për shkak të specifikave të tyre kanë ngelur në një stad primitiv, të pa specializuara dhe të pa zhvilluara në këtë sektor. Përpos nivelit të zhvillimit të vendit, agrikultura dhe fermeret kanë përfituar nga grupimi i njerëzve në disa struktura. Nga BE e deri në SHBA, përfitimet e të grupuarit për një interes të përbashkët kanë qenë pozitive të

paktën për njëren palë. Fermerët e qumështit në Francë derdhën rrugëve qumësht të freskët vetëm për të kundërshtuar uljen e subvencionit dhe kushtet e dobëta të punës. Imagjinoni reagimin e një fermeri nga Tanzania ose Shqipëria duke parë gjithë atë qumësht të hedhur dëm vetëm se një grupi i caktuar e paraqet si protestë për të mbrojtur kauzën e tyre.

Nocioni i ndërmarrjeve kolektive daton qysh në shek. e 13 (Poole and Frece 2010). Në Francë dhe në Zvicër prodhuesit e qumështit e grumbulluan qumështin së bashku për të prodhuar djathin. Megjithatë u desh shumë kohë që, prej ndërmarrjeve kolektive të strukturura me mbledhje, rregulla, interesa dhe objektiva të përbashkëta të arrihej në formimin e kooperativave.

Kooperativat formohen kryesisht si grupime njerëzish të cilët kanë të njëjtat nevoja gjithashtu duke dashur të përfaqsojnë fuqishëm interesin e tyre ekonomik. Lëvizja kooperativiste filloi në Evropë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, fillimisht në Angli dhe në Francë. Autorët më të njohur të lëvizjes kooperativiste janë Rober Owen dhe William King. Robert Owen identifikoi disa nga vlerat themelore të kooperativave si kooperimi, dashamiresia, toleranca, respekti dhe barazia. Sipas King: *“Çelësi i prosperitetit ekonomik është të mbajmë një kapital i mjaftueshëm për të marrë në kontroll punën, dhe pastaj mund të zotërojmë kapital dhe forcë punëtore. Por këtë nuk mund ta arrijnë puntorë në mënyrë individuale sepse risku është më i lartë dhe procesi për të krijuar kapitalin e mjaftueshëm është shumë i gjatë dhe nëse sëmuremi apo plakemi atëherë nuk ngelet më asgjë. Por nëse arrijmë të punojmë të bashkuar atëherë mund ta përmbushim procesin.”* Kooperativa e parë u themelua bazuar pikërisht mbi filozofinë e këtyre dy autorëve në vitin 1844 në Rochdale të Anglisë.

Në literaturë është gjerësisht i njohur roli i pionerëve të Rochdale në Angli si thelbi i krijimit të principeve kryesore të kooperativave. Një grup prej 28 burra puntore të kualifikuar, tregtarësh dhe tekstilistesh formuan një shoqëri të udhëhequr nga principet e biznesit dhe ngritën një vend ku mund të shisnin produktet e tyre. Në 1895 në Londër, Angli, u themelua Aleanca Ndërkombëtare e Kooperatives (ANK). ANK vendosi principet bazë mbi

të cilat u krijuan dhe u zhvilluan kooperativat dhe kjo ishte shtysa kryesore për rritjen globale të kooperativave.

Studimet ekonomike të kooperativave nuk nisën deri në vitin 1940 (Chaddad and Cook 2003). Ekonomistët i kategorizuan kooperativat si model, nga tre perspektiva të ndryshme: forma e integruar vertikale, e quajtur dhe si “zgjatim i firmës”, firmë e pavarur – kur kooperativa shikohet si një firmë, apo një grup firmash që veprojnë së bashku – përqasja si koalicion. Ky kategorizim u krye pasi nisis modelimi ekonomik i kooperativave.

Më vonë, formimi i kooperativave dhe statusi ekonomik i tyre në treg filluan të ndikoheshin nga perspektiva të reja teorike si teoria e agjensisë, teoria e sjelljes, teoria e kostove të transaksionit, teoria e lojës etj. Sidoqoftë, mbas viteve 1990 sjellja sipërmarrëse e kooperativave u orientua më shumë drejt koalicioneve dhe bashkimeve. Më tej, kërkimi mbi kooperativat u fokusua mbi strukturat qeverisëse të saj duke qënë se dhe roli menaxherial u rrit së tepërmi. Zhvillimi i kooperativave mori formë përgjate viteve dhe u ndikua nga shumë faktorë lokalë dhe historik. Autorët Ortmann and King (2007) i ndanë këta faktorë ndikues në tre kategori: kushtet ekonomike, organizimi i fermerëve dhe politikat publike. Kushtet ekonomike, përfshijnë ngjarje si lufrat, recesionet dhe bum-et ekonomike, politikat ekonomike të ndjekura nga qeverisjet. Organizatat e fermereve kanë të bëjnë më shumë me aspektet menaxheriale siç janë: cilësia e leadership-it, motivimi dhe besimi në poromovimin e kooperativave, dhe sa potencial negociues kanë fermerët për të ndikuar politikat publike. E fundit, janë politikat publike të vendosura nga interesat qeveritare dhe projektet legjislative të përcaktuara nga interpretimi juridik.

Sipas North (1990), historia ka treguar se zhvillimi ekonomik ka lulëzuar në vendet ku egziston një kornizë intitucionale stimuluesh e cila strukturon veprimet e tregut në mënyrë formale apo informale. Për më tepër, ky argument asociohet me realitetin shqiptar duke marrë parasysh zhvillimin e dobët ekonomik, një kulturë të pa zhvilluar biznesi dhe dhe norma sociale të thyera. Shumë debate teorike trajtojnë kostot e transaksionit, për sa i përket makroekonomisë së kooperativave dhe vendit që ato zënë në teorinë ekonomike. Gjithsesi, në vendet në zhvillim siç është Shqipëria asimetria

e informacionit apo mungesa e plotë e tij është më prioritar si problem sesa ajo e kostove të transaksionit. Në këtë rast, situatat e përmendura nga Jaffe, S (1995) janë pikërisht situatat që i perkasin tregut Shqiptar. E para është kur informacioni asimetrik është mes palëve kontraktuese. Blerësit zakonisht kanë më shumë informacion rreth çmimeve të tregut, se si do marri formë kërkesa dhe karakteristika të tjera të segmenteve të tregut. E dyta, të drejtat e pronësisë në pothuajse të gjitha kontratat nuk janë të specifikuara, prandaj ato nuk mund të përjashtohen ose të transferohen. I fundit është problemi i agjensisë, kur tendenca për të vepruar si kooperative ose si konkurent shtyn situatën drejt interpretimit të mundshëm të rregulloreve dhe marvëshjeve të lidhura.

Literatura e ndan evolucionin e kooperativave në ato të vendeve të zhvilluara siç është SHBA, dhe ato të vendeve në zhvillim dhe të pa zhvilluara. Në vendet në zhvillim kooperativat janë përfshirë nga një valë ristrukturimi dhe konsolidimi në mënyrë që t'ju përgjigjen nevojave të tregut dhe ndryshimeve institucionale. Në vendet e pa zhvilluara kooperativat kryesisht kanë dështuar si struktura. Disa (Akwabi Ameyaw 1997) thonë se tentativat për të grupuar fermerët në kooperative janë penguar për arsye të ndryshme. Gjetja e instrumenteve për të mbajtur një drejtim të përgjegjshëm ndaj anëtarëve të kooperativës ka qenë gjithmonë një sfidë. Çështjet morale kanë qenë rrezik deshtimi për këto struktura, duke e çuar organizatën në një rrugë me politika të papërshtatshme apo dhe me parregullsi financiare në menaxhim. Gjithashtu në literaturë gjejmë argumente se edhe mungesa e ekperiencës në menaxhim dhe mungesa e njohurive kanë qenë shkak i rëndësishëm i dështimit të kooperativave. Literatura (Van Niekerk 1988) njeh si arsye shumë të rëndësishme dështimi, edhe pse e pa studiuar, mungesën e besnikërisë nga anëtarët e organizatës si pasojë e injorancës. Ky vlerësim na sjell më afër kontekstit shqiptar, ekonomik dhe socio – politik.

2. KONTEKSTI HISTORIK NË SHQIPËRI

Pavarësisht historisë së kooperativave dhe principeve mbi të cilat ajo është bazuar, konteksti shqiptar është kryesisht i ndryshëm në krahasim me vendet e tjera. Fatkeqsisht, një histori e gjatë abuzimi dhe keqpërdorimi lidhur me pronën private në Shqipëri ka lënë gjurmët e saj të rrënjosura thellë duke trashëguar edhe sot mungesa të mëdha në sistemin ekonomik. Duke nisur me pushtimin osman, i ndjekur më pas nga reforma të pjesshme të ndërmarra që nga periudha e mbretërisë, masakra dhe padrejtësitë e medha gjate regjimit diktatorial dhe duke vijuar me padrejtësitë e atij që u quajt sistem demokratik. Në krahasim me vende të tjera që kaluan komunizmin, Shqipëria përjetoi formën më të ashpër të brutalitetit ekonomik. Sistemi nuk njihte asnjë formë të pronës private, prandaj konfiskuan dhe shtetëzuan çdo gjë. Shteti gjithashtu krijoi kooperativat me frymë komuniste të cilat çuan në shkatërrim të gjithë ekonominë dhe varfëruan njerëzit në zonat rurale që merreshin me bujqësi dhe e kishin atë si burim të parë ose dhe të vetëm të ardhurash. Themelimi i këtyre strukturave në teori ishte i mirë argumentuar, por praktika tregoi komplet të kundërtën. Periudha më e keqe ekonomike e cila është ende në memorien e njerezve sot edhe në momentet që flasim, ka lënë gjurmët e saj jo vetëm në memorien kolektive të shoqërisë Shqiptare por gjithashtu edhe te iniciativa private. Prandaj, kompleksi në formën e paranojës kur njerëzit dëgjojnë fjalën “kooperativat” është një reminishencë e drejtëpërdrejtë e sistemit më të padrejtë dhe më të tmerrshëm që Shqipëria ka parë ndonjëherë. Gjatë dy dekadave të fundit peizazhi ekonomik shqiptar ka kaluar nëpër një evolucion tranzitor i cili duket se po zgjat tepër për shoqërinë. Më e keqja nga pikëpamja ekonomike është zhvillimi potencial dhe mundësitë e humbura gjatë kësaj kohe. Ashtu si çdo sektor tjetër edhe bujqësia ka kaluar nëpërmjet shumë reformave shpesh të udhëhequra prej vendeve të zhvilluara duke

u munduar që të sjellin eksperiencën e tyre. Me eksperiencën që ato kanë sjellë, duke u munduar të instalojnë sistemin e vendeve të tyre ato me shumë e kanë dëmtuar ekonominë sesa e kanë përmirësuar atë, apo duke u munduar të implementojnë reforma të cilat janë jashtë kontekstit të atij vendi duke i quajtur decentralizim apo reformë agrare. Mbas dy dekadash ku janë hedhur miliona dollarë në reformën e decentralizimit në Shqipëri, BE e kuptoi se decentralizimi nuk funksionon, sidomos pa mbajtjen e përgjegjësisë. Pra, u zhbë një proces 20 vjeçar duke e rindarë në mënyrë administrative territorin Shqiptar. Gjithsesi këtë herë kjo ishte vetëm një reformë administrative, duke lënë jashtë çështjet e pronës private dhe ndarja ekstreme e tokës bujqësore.

Çështja kryesore që ka penguar zhvillimin ekonomik në Shqipëri është pronësia e tokës. Kjo gjithashtu ka qenë një kosto prej miliardash të humbura për vendin si në bujqësi dhe në çdo sektor tjetër. Siç e thamë dhe më parë, mbasi rregjimi komunist i mori çdo gjë pronarëve dhe bëri shtetëzimin, e keqpërdori pronën duke ja dhënë atij që nuk e meritonte duke e shkatërruar atë. Mbas rënies së komunizmit çdo gjë ndryshoi, por prona private përsëri ngeli një problematikë e madhe kryesore duke mos shkuar atje ku duhet. Ndarja dhe parcelizimi i pronës private dhe i asaj të zotëruar më parë nga shteti, ishte gabimi i parë më i kushtueshëm që i është bërë sistemit. Duke mos ja kthyer atë pronarit të vërtetë, por duke bërë një shpërndarje të pabarabartë me anë të praktikave korruptive ngelet edhe sot një mëkat që akoma e përndjek këtë vend.

Sidoqoftë, kjo parantezë u bë për të specifikuar argumentin në mënyrë kontekstuale dhe për ta bërë më lehtë të kuptueshme çdo analizë në vijim apo çdo konkluzion që nuk tingellon shumë orthodoks. Siç u përmend edhe më parë, rritja e kërkesës për produkte bujqësore si pasojë e normave të larta të urbanizimit i ka sjellë fermerët përballë disa vështirësive të lidhura me fenomenet e tregut. Në qoftë se në vendet e zhvilluara masat mbrojtëse ndaj luhatjes së çmimeve të produkteve të tyre është çështja kryesore, në Shqipëri, kjo është një çështje që i përket një të ardhmeje të largët. Nga ana historike egziston një ndarje mes kooperativës si një kusht socio – politik dhe kooperatives si një iniciativë sipërmarrese (Poole and Frece 2010). Si një kusht socio – politik, kooperativat në Shqipëri

rrezikojnë egzistencën e tyre si formë e till organizimi. Ndërsa me të përcaktuar rëndësinë politike të kooperativave diskutimi nuk është më në lidhje me argumentet dhe optimizimin, por kthehet në diskutim i çështjeve politike që në fund përfundon gjithmonë si një çështje besimi. Nga ana tjetër, duke e parë si një sipërmarrje biznesi, kooperativat janë kuptuar si entitet organizativ ku menaxhimi dhe anëtarët janë mjaft të arsimuar duke kuptuar ndërlikimet e biznesit dhe bazat ekonomike që drejtojnë e strukturën. Si një formë organizimi social ku përfaqsohen interesa të përbashkëta, tranzicioni i kooperativës në partner negociues politik është i realizueshëm dhe ndonjëherë i menjëhershëm dhe i pa vënë re. Përtej organizimit dhe interesit ekonomik, kooperativat u përdoren si formë organizimi për qëllime politike. Vende socialiste në Evropë e përdorën këtë praktikë. Pavarësisht përdorimit për qëllime politike, një raport i Bankes Botërore në 2008 theksoi se në realitetin e ri ekonomik kooperativat nuk janë më një formë organizimi bujqësor elitar por më shumë konsiderohen si mjete zhvillimi, që ndihmojnë në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë. Ndërsa si realitet politik janë mjete që ndihmojnë shoqëritë të përmiresojnë qeverisjet dhe për një përfaqësim më të mirë në të gjitha nivelet.

Kushtet e vështira ekonomike dhe sidomos mbështetja e qeverisë kanë qenë stimul i fuqishëm për të shtyrë përpara kooperativën, për më tepër kooperativat kanë qenë një burim force për fermerët në zonat rurale duke i ndihmuar me kredi, shërbime dhe mbështetje të tjera. Kjo është përvoja ndërkombëtare e cila është plot me shembuj dhe raste studimi. Megjithatë, në Shqipëri, shembujt e lidhur me çështjen janë të cunguar dhe të pa bazuar në të dhëna të sakta, për më tepër rastet studimore janë sporadike dhe të paargumentuar mirë me anë të fakteve. Duke analizuar kooperativat nga e gjithë Shqipëria vihet re mungesa e konsiderueshme e ndihmes dhe mbështetjes institucionale prej qeverisë dhe se shumica e iniciativave kanë qenë iniciativa private, programe të huaja mbështetëse dhe iniciativa private të huaja, ku sidomos në dekadën e fundit fermerët dhe sipërmarrësit kanë qenë më të vetëdijshëm për mundësitë e tyre. Përgjithësisht iniciativa të tilla operojnë nën një infrastrukturë të caktuar shtetërore e cila rregullon mbarevajtjen dhe aktivitetin ekonomik. Përveç disa formave ligjore, infrastruktura e çdo lloji nga ana e qeverisë ka munguar ose ka qenë shumë

e papërfillshme. Donatorët e huaj kanë qenë relativisht efektive dhe mbas pesë deri dhjetë vjetësh mbasi janë implementuar projektet e tyre, rezultatet kanë qenë evidente sidmos në sektorin e bulmetit. Fermerët besojnë se projektet nga donatorët e huaj janë më eficientë kur implementohen direkt në marrdhënie me fermerët dhe jo nëpërmjet institucioneve shtetërore, ku mund të themi se bazuar në rastet e analizuara në Shqipëri dhe në rastin tonë qëndror që është Lushnja ky argument ka rezultuar të jetë i vërtetë.



3.

INFRASTRUKTURA LIGJORE & EKONOMIKE E ZONËS SË LUSHNJËS

Bashkia e Lushnjës, pjesë e Qarkut të Fierit, shtrihet në fushën e Myzeqesë, një ndër zonat më të njohura në vend për sasitë dhe rendimentet e prodhimit bujqësore. Në të njëjtën kohë kjo fushë është e pasur me ujëra në formën e lumenjve, liqeneve artificiale dhe lagunave detare. Sipas “Plani të Përgjithshëm Kombëtar Zhvillimi i Territorit të Shqipërisë 2015-2030” (PPKZHTSH) hartuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), Bashkia e Lushnjës përcaktohet si një rajon me perspektivë zhvillimi në bujqësi dhe turizëm. Kjo natyrisht që justifikohet me burimet e mëdha natyrore për të zhvilluar këto dy sektorë ku natyrisht që bujqësia renditet e një rëndësie më të madhe.

Në këtë paragraf do të paraqitet pikërisht infrastruktura e burimeve ekonomike mbi të cilën mbështetet përcaktim i PPKZHTSH-së. Panorama do të mbështetet në statistike të institucioneve kryesore publike si Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Instituti i Statistikave (INSTAT), Banka e Shqipërisë (BSH), etj.

Paraqitja e të dhënave përveç burimeve statistikore dhe studimeve të kryera dhe financuara nga institucione publike apo dhe nga agjenci ndërkombëtare, është bazuar dhe në një analizë deduktive në ato raste kur te dhënat nuk mund të siguroheshin.

Por nuk është e mundur të sigurosh çdo të dhënë që nevojitet për të analizuar bujqësinë në Shqipëri dhe aq më pak për të gjetur të dhëna për një zonë specifike si Bashkia e Lushnjës. MBZHRAU, Instat, Bashkia Lushnjë,

etj. Zotërojnë dhe/ose ofrojnë pak të dhëna të detajuara për bujqësinë në Bashkinë Lushnjë. Përpos kësaj, një pjesë e mirë e të dhënave i përkasin periudhave të disa viteve më parë (viti 2011 ose viti 2013). Nga ana tjetër institucionet bankare nuk ofrojnë informacion për klientët e tyre.

Në kushtet e mungesës së informacionit të plotë dhe të besueshëm nga Bashkia e Lushnjes, MBZHRAU, Instat, bankat e nivelit të dytë dhe shoqëritë e tjera të kreditit që veprojnë në Bashkinë Lushnjë, Banka e Shqipërisë, etj janë përdorur metoda deduktive për të arritur në një përfundim për bujqësinë dhe kreditimin në Bashkinë e Lushnjes.

Përgjithësisht të dhënat nga MBZHRAU dhe INSTAT ofrohen vetëm në nivel qarku dhe konkretisht për Qarkun Fier. Bazuar në ato të dhëna, si dhe në analiza dhe të dhëna të tjera statistikore për Qarkun Fier dhe Bashkinë Lushnjë, janë ndërtuar të dhënat statistikore mbi të cilën do të mbështeten argumentet për mundësinë dhe nevojën e krijimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësore në Bashkinë e Lushnjes.

3.1 Infrastruktura ligjore dhe institucionale

Në studimet e ligjeve me të cilat janë rregulluar veprimtaria e organizatave bujqësore përgjatë viteve vëmë re një mungesë të theksuar të ligjeve të posaçme për bujqësinë. Në vitin 1996 është krijuar një ligj (Nr.8088, datë 21.3.1996), i cili nën kuadrin e tij nuk rregullonte mirëfilli veprimtarinë e organizatave bujqësore dhe që nuk ka arritur të zbatohet ashtu siç duhej. Vetëm në vitin 2012 Qeveria Shqiptare arriti të krijojë një ligj për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (Ligji Nr.38/2012), objekt i të cilit është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe kushteve për themelimin e administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor.

Më poshtë do të japim një përshkrim të shkurtër të ligjeve me të cilat është rregulluar veprimtaria e shoqërive bujqësore përgjatë viteve, duke dhënë edhe disa karakteristika që i kanë shoqëruar organizime të tilla.

3.1.1 Legjislacioni për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor

Referuar legjislacionit Shqiptar sot në Shqipëri ekzistojnë katër forma kryesore të organizimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, ose ndryshe kooperativave, të cilat rregullohen sipas ligjeve përkatëse. Këto forma të organizimit të kooperativave kanë evoluar me kalimin e viteve si pasojë e rritjes së interesit si të vetë individëve ashtu edhe të qeverisë drejt fushës së bujqësisë, si një ndër sektorët kryesorë që ndikojnë në rritjen ekonomike të një vendi, ajo zë 22% të PBB-së në 2015, referuar Bankës Botërore¹.

Organizimi më i hershëm i kooperativave kanë qenë grupe vullnetare të organizuara fermerësh, të cilët kryenin veprimtarinë e tyre individuale pa u mbështetur në ndonjë ligj specifik. Në vitin 2014 në Shqipëri sipas (“Development of Agricultural Cooperation Societies” 2014) ekzistonin 179 organizime të tilla, çka përbën edhe numrin më të madh të regjistruemeve.

Shumë pak fermerë kanë operuar nën kuadrin e ligjit Nr.8088, datë 21.3.1996, për “Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok” (SHBR). Sipas (“Development of Agricultural Cooperation Societies” 2014) në vitin 2014 ishin krijuar rreth 21 të tilla. Ky ligj u jep mundësinë fermerëve që të kryejnë veprimtari ekonomike bashkarisht nga anëtarët e saj. Fitimi neto i shoqërisë përdoret për:

- a) krijimin e rezervës ligjore,
- b) krijimin e rezervës së detyrueshme,
- c) krijimin e rezervës fakultative,
- d) krijimin e rezervës për rreziqet e veprimtarisë,
- e) krijimin e rezervës për interesin e pjesëve të kapitalit,
- f) caktimin e shpërblimeve për veprimet që anëtarët kanë kryer me shoqërinë, çdo anëtarë merr fitime në mënyrë përpjesëtimore me veprimet që ka realizuar me shoqërinë e bashkëpunimit reciprok,
- g) caktimin e shumave për të ulur kostot e blerjes së pasurisë,

¹ data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?locations=AL

shërbimeve, si dhe për shlyerjen e kredive.

Për asnjë arsye rezervat e shoqërisë, cilado qoftë natyra e tyre, nuk mund tu ndahen anëtarëve. Avantazh i kësaj forme organizimi është që fermerët nuk paguajnë tatime duke qenë se nuk e shpërndajnë fitimin e realizuar tek anëtarët e saj. Mirëpo duke qenë se ky ligj u hartua për tu zbatuar në disa fusha të ekonomisë si, në fushën e prodhimit, të shitblerjes së mallrave, në fushën e shërbimeve, të kreditit apo në fushën e ndërtimeve, ishte një ligj i cili nuk arriti të zbatohet në fushën e bujqësisë për shkak të modelit të komplikuar të saj dhe në vitin 2012 u shfuqizua.

Organizimi i fermerëve në formën e organizatave jofitimprurëse është një alternativë që fermerët kanë zgjedhur për të krijuar organizimet e tyre si pasojë e mungesës së një ligji të mirëfilltë për organizimin e fermerëve. Këto organizata rregullohen sipas ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”. Sipas këtij ligji këto organizata nuk duhet të kryejnë aktivitete ekonomike, aktivitetet e tyre duhet të jetë në të mirë dhe në interes të publikut, çka nuk është i përshtatshëm për një organizim që si qëllim të saj ka bashkëpunimin midis anëtarëve për kryerjen e aktivitetit ekonomik, fitimprurës. Mirëpo përkundrejt kësaj fermerët ishin të predispozuar për të krijuar organizatat e tyre konform këtij ligji duke qenë se përjashtoheshin nga taksat mbi të ardhurat. Sipas “Development of Agricultural Cooperation Societies,” 2014 në vitin 2014 në Shqipëri kryenin veprimtari rreth 65 organizime të tilla.

Ligji i parë i mirëfilltë i krijuar posaçërisht për shoqëritë bujqësore u krijua në vitin 2012, ligjit Nr.38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, (SHBB). Ky ligj u erdhi si pasojë e kushteve të mëposhtme:

- 1) mungesa e një ligji që rregullonte veprimtarinë e organizatave bujqësore të krijuara nga fermerët,
- 2) rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve për bashkëpunim qoftë me fermerë vendas apo të huaj,
- 3) orientimi gjithnjë e më i madh i fermerëve vendas për të prodhuar jo vetëm për tregun Shqiptar por edhe për eksport,

- 4) rritja e kërkesës për produkte bujqësore cilësore,
- 5) shtimi i numrit të aktiviteteve në fushën e bujqësisë.

Ky ligj u jep mundësinë fermerëve që të krijojnë organizime vullnetare nga ku do të përfitojnë vetë fermerët dhe do të përmbushen nevojat e të gjithë anëtarëve. Në këtë përkufizim, këto shoqëri veprojnë njësoj si shoqëri tregtare ku detyrohen të paguajnë taksat dhe detyrime në varësi të xhiros së tyre vjetore dhe e vetmja pikë nga ku ndryshojnë me shoqëritë tregtare është pikërisht qëllimi, nëse tek shoqëritë tregtare kemi si qëllim krijimin e fitimit dhe ndarjen e saj midis ortakëve, qëllimi i shoqërive të bashkëpunimit bujqësor është krijimi i kushteve apo ofrimi i shërbimeve sa më të favorshme për anëtarët e saj. Këto shoqëri në varësi të veprimtarisë që ushtrojnë ndahen në,

- a) shoqëri të bashkëpunimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe në marketing,*
- b) shoqëri të bashkëpunimit në veprimtarinë e punës bujqësore,*
- c) shoqëri të bashkëpunimit për konsumin e lëndëve dhe mallrave,*
- d) shoqëri të bashkëpunimit për inputet,*
- e) shoqëri të bashkëpunimit për qëllime të tjera në fushën e bujqësisë.*

Kjo u jep mundësi atyre që të përfitojnë nga ekonomia e shkallës, duke ulur kështu kostot për njësi të prodhimit, shitjes, shpërndarjes, investimeve, blerjes së lëndës së parë si dhe fuqisë punëtore. Përfitimi që marrin nga ekonomia e shkallës do të çojë në rritjen e produkteve cilësore me çmime të lira në treg si dhe do të rriste potencialin për eksporte të këtyre produkteve bujqësore. Përfitim tjetër që do të sjellin këto organizata do të jetë pikërisht krijimi i fermave të mëdha si pasojë e bashkimit të disa fermerëve së bashku për të ofruar një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore duke kontribuar kështu në rritjen e të ardhurave për kooperativat dhe anëtarët e tyre.

Pavarësisht se ky ligj nxit dhe jep mundësinë e transformimit të shoqatave të fermerëve dhe shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellët në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor, vihet re një stepje e fermerëve për të ndërmarrë

një veprim të tillë. Sipas Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)¹, në vitin 2014 u regjistruan 38 dhe në 2015 vetëm 12 Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor duke regjistruar kështu një rënie me rreth 68% të regjistrimit të këtyre shoqërive në vetëm në një vit. Kjo rënie mund të shpjegohet:

Së pari, me “frikën” që mund ti shoqërojnë fermerët për pagesat e tatimit mbi fitimin që janë të detyruar të paguajnë në momentin që regjistrohen si shoqëri të tilla.

Së dyti, kjo mund të vijë nga mungesa e njohurive të mjaftueshme në fushën e menaxhimit apo teknikave të reja bujqësore, duke qenë se organizime të tilla kërkojnë një strukturë të qartë organizate biznesi, duke filluar nga menaxhimi, financa apo metodat e biznesit.

Së treti, konfuzioni që krijon termi kooperativë pasi ndikimin e vet negativ në këtë drejtim. Shumica e fermerëve, si pasojë e mungesës së informimit dhe trajnimit të tyre, nuk arrijnë të bëjnë dot dallimin midis kooperativave bujqësore të stilit të ekonomive të centralizuara (përpara vitit 1992) dhe Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor. Kjo natyrisht që stepi përpjekjet për organizime të tilla të nxitur nga përvoja negative që përjetoi bujqësia shqiptare nga kooperativat e dështuara të viteve të ekonomisë komuniste të cilat më shumë se të bashkëpunimi (kooperimi) vullnetar, bazoheshin tek bashkimi i detyruar i burimeve.

Dhe së katërti, rënia e ndjeshme e numrit të regjistrimeve në vetëm një vit mund të interpretohet edhe si mungesë e mbështetjes dhe nxitjes qeveritare kundrejt sipërmarrjeve të tilla duke qenë se është forma e vetme e ligjore e cila ka shënuar një rënie të tillë.

¹ qkr.gov.al/nrc/documents/Raporti_Vjetor_2015_shq.pdf

Tabela 1: Ndryshimi i numrit të sipërmarrjeve të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015

Forma Ligjore	2014	2015	Krahasimi %
Degë e shoqërisë së huaj	68	72	5.9
Person fizik	14,285	36,899	158.3
Përfaqësues tatimor	0	0	0
Shoqëri aksionare	40	40	0
Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor	38	12	-68.4
Shoqëri e bashkëpunimit reciprok	1	0	-100
Shoqëri e thjeshtë	2	6	200
Shoqëri kursim krediti (SHKK)	3	0	-100
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	2,279	2,612	14.6
Zyrë përfaqësimi e shoqërisë së huaj	15	8	-46.7
<i>Total</i>	<i>16,731</i>	<i>39,650</i>	<i>137</i>

3.1.2 Politikat për zhvillimin e sektorit të bujqësisë

Në vitin 2014 Qeveria Shqiptare ka miratuar programin për “Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”. Qëllimi i këtij programi është mbështetja, promovimi edhe zhvillimi i zonave rurale dhe bujqësisë si sektori i cili ndikon në rritjen e mirëqënies, rritjen ekonomike dhe zbutjen e varfërisë në këto zona. Ky program synon rritjen e buxhetit për bujqësinë nga viti në vit, ku në vitin 2020 sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, pritet të këtë një buxhet prej 14,777 milion lekë, ndërsa për 2016 buxheti i parashikuar është 10,805 milion lekë, ku pjesa më e madhe e buxhetit do të shkojë për skemat e mbështetjes të zhvillimit rural që mbështesin bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun. Objektivat kryesore të këtij programi përfshijnë:

- Rritja e numrit të femrave të cilat punojnë dhe janë drejtuese të kooperativave

Tabela 2: Organizatat e fermerëve sipas qarqeve (2014)

Nr	Rajoni	SHBB		SHBR		OJF		Grupe Fermerësh		
		N	Anëtar	Të	Nr.	Anëtar	Të	Nr.	Anëtar	Të
1	Berat	Akoma Jo			1	9	Po	6	250	Po
2	Dibër	Akoma Jo			Akoma Jo			4	197	Po
3	Durrës	1	8	Po	4	148	Po	5	80	Po
4	Elbasan	4	114	Po	1	380	Po	8	447	Po
5	Fier	1	7	Po	Akoma Jo			2	81	Po
6	Gjirokastrë	Akoma Jo			3	90	Po	2	60	Po
7	Korçë	1	9	Po	4	318	?	1	70	Po
8	Kukës	Akoma Jo			Akoma Jo			7	199	Po
9	Lezhe	Akoma Jo			4	196	Po	Akoma Jo		
10	Shkodër	6	58	Po	1	270	Po	12	285	Po
11	Tirane	5	53	Po	Akoma Jo			Akoma Jo		
12	Vlore	Akoma Jo			Akoma Jo			9	316	Po
13	Lushnjë	1	11	Po	3	77	Po	9	555	Po
Total		1	260	Po	21	1488	Po	65	2540	Po
								179	3366	

- Reduktimi i varfërisë nëpërmjet politikave sociale për grupet në nevojë
- Rritja e punësimit dhe krijimi i mundësive të punësimit, nëpërmjet politikave dhe subvencioneve për iniciativat që kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë
- Krijimi i 9000 vendeve pune në aktivitetet e përpunimit agroushqimor në periudhën 2012 - 2020
- Krijimi i 50-100 mikrondërmarrjeve dhe i 500–1000 vendeve të reja pune në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që sjellin të ardhura.

Po çfarë është bërë në këto 2 vjet?

Pavarësisht hartimit të këtij programi dhe objektivave të vendosura për tu arritur në fushën e bujqësisë, shikojmë që bujqësia sot vazhdon të jap një kontribut shumë të rëndësishëm buxhetit të shtetit pavarësisht se ky i fundit nuk po i jep vëmendjen e duhur. Sipas të dhënave të Bankës Botërore kontributi i bujqësisë në prodhimin e brendshëm bruto në vitin 2015 është rreth 22%, gati sa dyfishi krahasuar me vendet e rajonit (Kosova 13.7%, Maqedoni 11.2%, Mal i Zi 10.2%, Serbi 9.46%). Nga ana tjetër vendi vazhdon të mbetet importues i produkteve bujqësore, duke importuar rreth 5.6 herë më shumë sesa eksporton sipas të dhënave të Instat. Bujqësia gjithashtu vazhdon të dominojë ekonominë shqiptare për nga numri i të punësuarve me 44.26% të totalit. Ndërsa në tremujorin e parë të 2016 referuar Instat shikojmë që kemi një rritje të punësimit në këtë sektor me vetëm 0.7%, është sektori i cili ka shënuar rritjen më të ulët krahasuar me dy sektorët e tjerë, industrinë dhe shërbimet me një rritje respektivisht 15.5% dhe 6%.

Nga analiza e këtyre të dhënave por pa anashkaluar edhe elementë të tjerë si punësimi i femrave në këtë sektor në vetëm këto 2 vite apo krijimi i mikrondërmarrjeve të vogla e të mesme si krijues të vendeve të reja pune, pak më lart përmendëm se në vitin 2015 kishim një rënie shumë të madhe të regjistrimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, mund të themi që mbështetja e politikave dhe planet e hartuara për të nxitur dhe zhvilluar sektorin e bujqësisë në vend nuk është në rrugën e duhur, edhe pse ky

program ka një kohështirje deri në 6 vjet dhe jemi akoma në 2 vitet e para. Ajo se çfarë vlen të përmende është që bujqësia vazhdon të mbetet një sektor shumë i rëndësishëm në Shqipëri. Pavarësisht problemeve dhe mbështetjes qeveritare për të nxitur dhe zhvilluar këtë sektor, pesha e lartë e bujqësisë në ekonomi mund të vijë si pasojë e mungesës së ekspertizës apo zhvillimit të ndonjë sektori tjetër në vend si dhe faktit që vitet e fundit shumë emigrantët po kthen përsëri në vend dhe pjesa më e madhe e tyre janë marrë me bujqësi në vendet ku kanë jetuar e gjejnë si mënyrë më të thjeshtë krijimin e mundësive të punësimit në këtë sektor. Kjo ka një avantazh shumë të madh për zhvillimin e bujqësisë sepse këto individ vijnë me eksperiencë shumë të mira në vendet e Evropës dhe me nivele të konsiderueshme kapitali të cilat i nevojiten këtij sektori.

3.2 Statistika demografike, ekonomike dhe financiare

Në këtë seksion do të paraqitet dhe analizohet situata demografike, ekonomike dhe financiare në përgjithësi dhe specifikisht për sektorin bujqësor. Fokusi i analizës do të jetë nxjerrja e të dhënave dhe përfundimeve lidhur me situatën dhe mundësitë potenciale të zhvillimit në zonën më pjellore të Shqipërisë që është Fusha e Myzeqesë. Kjo fushë përfshihet e gjitha në Qarkun e Fierit dhe pjesa më e madhe dhe më pjellore e saj përfshihet në Rrethin e Lushnjes¹. Analiza dhe paraqitja e situatës ekonomike dhe demografike të Bashkisë së Lushnjes në veçanti dhe, në përgjithësi, të Qarkut të Fierit ku bën pjesë kjo bashki, është në funksion të vizatimit të një panorame sa më të qartë dhe të saktë të ambientin ku fokusohet studimi dhe mundësia e ngritjes së shoqërive të bashkëpunimit bujqësor.

Për të realizuar këtë studim, janë përdorur statistika zyrtare të Census-it të fundit të zhvilluar nga INSTAT në vitin 2011; të dhëna statistikore nga INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit

¹ Rrethi i Lushnjes nuk ekziston më si koncept administrativ që pas miratimit të Reformës Administrativo-Territoriale në vitin 2014. Kjo reformë, të njëjtat njësi administrative që përfshinte Rrethi i Lushnjes, i ndau në dy bashki: Bashkinë e Lushnjes dhe atë të Divjakës.

të Ujërave; përcaktime të siguruara nga Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të Qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë” si dhe të dhëna të siguruara nga Bashkitë Fier, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Roskovec dhe Patos. Për të pasur një vlerësim sa më aktual për ato fusha ku nuk mund të gjendeshin të dhëna zyrtare aktuale janë përdorur vlerësime të studiuesve të njohur botuar në publikimet e institucioneve publike si INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore si dhe publikime në faqen e Reformës Administrativo Territoriale.

Një element që do ta bënte të vështirë në llogaritje të saktë të parametrave ekonomik dhe demografik në lidhje me Qarkun e Fierit dhe Bashkinë e Lushnjës lidhet me migracionin e brendshëm dhe sidomos emigracionit drejt vendeve të Bashkimit Evropian gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, etj. Lëvizjet e popullsisë dhe investimeve janë të vështira për t’u llogaritur me saktësi në kushtet e mungesës së shifrave zyrtare. Përveç kësaj, për individët dhe investimet e zhvendosura brenda dhe jashtë vendit nuk mund të thuhet me siguri nëse largimi i tyre është përfundimtar apo i përkohshëm.

3.2.1 Të dhëna të përgjithshme

Shqipëria është pozicionuar në perëndim të Gadishullit të Ballkanit, midis koordinatave gjeografike 39° dhe 16° gjatësi dhe 42° 39° gjerësi, në largësi pothuajse të barabartë nga Ekuatori dhe Poli i Veriut¹. Lartësia mesatare e Shqipërisë është 708 metra mbi nivelin e detit, një nivel ky rreth dy herë më i madh se sa mesatarja e Evropës.

Në veri-perëndim Shqipëria kufizohet nga Mali i Zi; në veri-lindje nga Kosova; në lindje nga Maqedonia; në jug e jug-lindje nga Greqia; në perëndim dhe jug-perëndim laget nga detet Adriatik dhe Jon. Sipërfaqja e përgjithshme është 28,748 km² nga të cilat 24.2% ose 6,960 km² janë tokë bujqësore dhe pjesa tjetër prej 75.8% ose 21,790 km² janë pyje, livadhe


¹ Burimi: Këshilli i Ministrave, Arkiva, <http://arkiva.km.gov.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=54>

e kullota dhe sipërfaqe ujore. Sipërfaqet ujore në Shqipëri përfaqësohen nga 11 lumenjtë me një numër total prej 152 degësh; 4 liqene të mëdha natyrore; dhe një numër i madh liqenesh të vegjël dhe liqenesh artificiale si dhe nga 316 km vijë bregdetare.

Shqipëria është një vend me klimë mesdhetare, e përfshirë në një zonë me klimë sub-tropikale dhe me lagështirë. Për shkak të këtij pozicioni janë të dallueshme të katërta stinët gjatë të cilave bien mesatarisht 1,485 mm shi në vit. Në vend numërohen mesatarisht 240-300 ditë me diell në varësi të viteve të ndryshme dhe zonave të ndryshme të vendit duke pasur një mesatare prej 2,400 orë diell në vit.

Temperatura mesatare vjetore luhetet midis vlerave 17°C për zonën jugperëndimore (bregdeti jonian) dhe shkon deri në 7°C për zonat me lartësi mbi 1200m (kryesisht në veri të vendit). Muaji me i nxehte është Korriku me një temperaturë mesatare prej 25°C në zonat e ulëta që prek ultësirën perëndimore dhe zonën jugperëndimore të vendit (bregdeti jonian). Muaji me i ftohtë është Janari me një temperaturë mesatare prej 10 °C në zonat e ulëta që prek ultësirën perëndimore dhe zonën jugperëndimore të vendit (bregdeti jonian). Temperatura më e lartë historike e shënuar në një zonë të banuar është 44°C (Kuçovë) dhe temperatura më e ulët e shënuar është -29.4°C (Manastir).

Fig. 1: Temperaturat dhe niveli mesatar mujor i reshjeve në Shqipëri



3.2.2 Prodhimi bujqësor, punësimi, mekanika bujqësore

B1 – Prodhimi bujqësor


Bujqësia është në sektor i cili ka pasur një rëndësi dhe peshë të madhe për ekonominë shqiptare gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar. Deri në vitin 1990, sipërfaqja e tokës prej 696 mijë hektarësh shfrytëzohej pothuaj tërësisht dhe prodhimi bujqësor ishte pjesë e planeve buxhetore. Toka ishte e ndarë mes kooperativave dhe fermave bujqësore me pronësi shtetërore respektivisht:

- Në 340 kooperativat bujqësore të cilat punonin rreth 556 mijë hektarë ose 80% e tokës bujqësore të punueshme.
- Në 8 ferma të mëdha shtetërore të cilat punonin pjesën tjetër prej 20% ose 140 mijë hektarësh.

Sipas kësaj ndarjeje një fermë zotëronte mesatarisht 17,400 hektarë tokë dhe në kooperativë mesatarisht 1,640 hektarë tokë. Pas hapjes së vendit

dhe ndarjes së tokës u krijuan ferma të vogla përbërë nga parcela shumë të vogla dhe të shpërndara. Aktualisht në Shqipëri numërohen mbi 350 mijë ferma bujqësore të vogla të cilat zotërojnë mesatarisht 1.2 Ha tokë secila (2013).

Fig. 2 Pësja e sektorit bujqësor në përqindje ndaj PBB-së kombëtare



Parcelizimi i tokës është i skajshëm duke arritur në një mesatare prej 3.9 parcela për fermë çka do të thotë se një parcelë ka në sipërfaqe mesatare kombëtare prej 0.3 ha. Ky faktor, bashkuar edhe me nivelin e ulët të fondeve publike dhe private për shkak të nivelit të lartë të varfërisë, shkaktuan braktisjen e tokës në vitet 1993-2000 çka uli prodhimin bujqësor dhe peshën e këtij sektori në ekonominë kombëtare. Konkretisht, pësja e bujqësisë në PBB është rritur nga 33.6% e PBB-së në vitin 1980 në 55.8% të PBB-së në vitin 1995. Pas këtij viti sektori bujqësor ra në një kolaps të thellë dhe pësja e tij ra menjëherë në 37.5% të PBB-së në 1996 duke zbritur në nivel minimal historik prej 19.4% e PBB-së në vitin 2008. Aktualisht, sipas të dhënave të vitit 2015 ky sektor zë 22% të PBB-së.

I rëndësishëm është fakti se ky sektor ka po përjeton një stanjacion sa i përket kontributit të tij në PBB-në kombëtare. Që prej vitit 2004 kur pësja

e bujqësisë në PBB-në kombëtare ishte 22.9% e deri në vitin 2015 ku pesha e këtij sektori shënon 22% kemi një periudhë 12 vjeçare me luhatje të vogla përreth vlerave të 22%.

B2 – Të ardhurat dhe Punësimi

PBB e Shqipërisë është 1,335 miliardë lekë ose rreth 10.6 miliardë USD (me kursin 125.79 USD/ALL datë 31/12/2015). Popullsia e Shqipërisë është 2,886,026 banorë dhe PBB për frymë është rreth 462 mijë lek ose rreth 3,680 USD.

Forca e punës është rreth 1.122 milion persona (2015) dhe numri i të punësuarve në të gjithë sektorët është 1,024,691¹. Nga këta, 164,170 janë të punësuar në sektorin shtetëror dhe 860,521 janë të punësuar në sektorin privat. Në sektorin privat bujqësor janë të punësuar 460,035 persona ose 53.4% e të punësuarve të krejt sektorit privat dhe pjesa tjetër prej 46.6% ose 400,486 persona, janë të punësuar në sektorin privat jobujqësor.


Që prej ndarjes së tokës dhe hapjes së ekonomisë së vendit fenomeni i emigrimit dhe migrimit të brendshëm në nivele të mëdha ka zhvendosur një pjesë të madhe të popullsisë në zonat e mëdha urbane. Kjo tendencë drejt zonave urbane dhe drejt profesioneve që ofrohen nga bizneset e këtyre zonave vazhdon akoma dhe sot. Si rezultat e kësaj tendence shfaqet numri i të punësuarve në bujqësi nuk ndjek të njëjtin ritëm rritjeje me numrin e të punësuarve në sektorët e tjerë jobujqësor.

Sipas të dhënave tremujore për 4 vitet e fundit (Tremujori i parë 2012-Tremujori i parë 2016) vërehet një tendencë e rritjes së numrit të të punësuarve në sektorin privat jobujqësor. Ndërkohë në sektorin privat bujqësor numri i të punësuarve ka ardhur në rënie e pasuar nga një stanjacion me tendenca të lehta rritjeje gjatë 3 viteve të fundit².

¹ Kjo shifër i përket të dhënave të tremujorit të parë të viti 2016 (INSTAT)

² Duhet nënvizuar se numri i të punësuarve në bujqësi shpesh ka qenë pjesë e debateve me natyrë politike. Ky numër ka qenë subjekt i ndryshimit të metodave të vlerësimit duke sjellë shpesh dhe diferenca që burojnë nga vlerësimi dhe jo nga ndonjë ndryshim thelbësor i numrit të të punësuarve në këtë sektor.

Fig. 3: Ecuria e numrit të punësuarve në sektorin privat bujqësor dhe jobujqësor



B3 – Mekanika bujqësore


Historikisht Shqipëria është cilësuar si një vend me një bujqësi pak të motorizuar. Aktualisht (2015) në Shqipëri numërohen 29,226 mjete motorike të llojit traktorë, ministraktorë, makina mbjellëse, motokorrëse, autokombajna dhe freza. Nga kjo shifër numri i traktorëve me rrota dhe zinxhirë është i rëndësishëm pasi janë ata të cilët punojnë tokën. Mjetet e tjera motorike si, minitraktorë, makina mbjellëse, motokorrëse, autokombajna dhe freza, kryejnë një proces pasues të dorës së dytë dhe të tretë. Në këtë kontekst në vitin 2015 në Shqipëri numërohen 10,357 traktorë (me rrota dhe zinxhirë). Kjo shifër, edhe pse ka ardhur në rritje gjatë 5 viteve të fundit, mbetet e ulët si në terma absolutë dhe në terma relativë.

Duke marrë parasysh se në Shqipëri numërohen rreth 351,605 ferma bujqësore, atëherë i bie 0.02 traktorë për fermë. Kjo shifër është e ulët krahasuar me vendet e rajonit si Maqedonia me 403 mijë traktorë. Duke ditur që në Maqedoni numërohen rreth 171 mijë ferma kjo shifër i korrespondon rreth 0.5 traktorë për fermë. E thënë ndryshe, në Maqedoni ka 18 herë më shumë traktorë për një fermë.

–Numri i traktorëve është i ulët krahasuar edhe në raport me sipërfaqen e tokës së punueshme. Sipas të dhënave të viteve të fundit në Shqipëri numërohen 148.8 traktorë për 100 km² tokë të punueshme. Ky raport mbetet i ulët krahasuar me Maqedoninë e cila numëron më shumë se 1200 traktorë për 100 km² tokë të punueshme ose mbi 8 herë më shumë.

–Numri i traktorëve mbetet i ulët krahasuar me periudhën më të mirë të bujqësisë shqiptare kur shfrytëzohej niveli maksimal i tokës. Edhe pse me një bujqësi pak të motorizuar, në vitin 1990 në Shqipëri numëroheshin 212.4 traktorë për 100 km² tokë të punueshme, numër i cili për shkak të amortizimit dhe mungesës së interesit tek bujqësia ra viti pas viti duke kapur në vitin 2003 nivelin e 102.4 traktorë për 100 km² tokë të punueshme. Pas këtij viti janë shfaqur tendencat e rritjes së interesit ndaj tokës dhe investimit në bujqësi duke rritur në këtë mënyrë dhe numrin e traktorëve dhe mjeteve të tjera motorike të nevojshme për proceset e mëvonshme.

Fig. 4: Numri i traktorëve për 100 km² tokë të punueshme



3.2.3 Qarku Fier

Qarku i Fierit është qarku i dytë më i madh në Shqipëri pas Qarkut të Tiranës. Ai shtihet në perëndim të vendit, në pjesën jugore të Ultësirës Perëndimore, specifikisht në juperëndim të pllajës bregdetare të Shqipërisë dhe përkatësisht në fushën e Myzeqesë duke zënë pjesën më të madhe të saj. Ky qark ka në përbërjen e tij disa bashki, njësi administrative dhe dhjetëra fshatra. Ashtu si çdo qark tjetër në Shqipëri, edhe ky qark ka pësuar ndryshime strukturore nga pikëpamja administrative të ndodhur për shkak të Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2014. Aktualisht ky qark ka përbërjen e tij 6 bashki nga 3 të tilla që kishte deri në prill të vitit 2014. Konkretisht, Qarku Fier përbëhet nga bashkitë e Fierit, Lushnjes, Patosit, Roskovecit, Divjakës dhe Mallakastrës të cilat së bashkë përfaqësohen nga 42 njësi administrativo territoriale.

Kjo ndarje e re administrativo territoriale e Qarkut Fier nuk ka ndonjë ndikim domethënës në rezultatet e këtij studimit. Ashtu si ndarja e mëparshme administrative e këtij qarku në 3 bashki të mëdha, ashtu edhe ndarja aktuale në 6 bashki, nuk ndikojnë në matjen e potencialeve dhe burimeve të mundshme të përmirësimit të situatës ekonomike dhe sociale nëpërmjet krijimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor.

Në tabelën¹ dhe figurën² e mëposhtme paraqiten pikërisht njësitë administrative territoriale respektive për secilën bashki të qarkut të Fierit.

Kjo ndarje e re administrative u realizua për një menaxhim më të mirë të njësisë të qeverisjes vendore me fokus uljen e shpenzimeve administrative në funksion të rritjes së shpenzimeve për investime dhe mbështetje ekonomike dhe sociale.

¹ Kjo tabelë është ndërtuar bazuar në të dhënat e Ligji nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo territoriale të njësisë të Qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”

² Harta e Qarkut Fier është ndërtuar nga autorët e këtij studimi bazuar në “Hartën me 61-Bashki” të publikuar nga Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore.

Fig. 5: Qarku i Fierit

Bashkia DIVJAKË

Divjakë	Gradishtë
Tërbuf	Remas
Grabjan	

Bashkia FIER

Fier	Dërmenas
Cakran	Topojë
Mbrostar	Levan
Ura	Frakull
Libofshë	Portëz
Qendër	



Bashkia LUSHNJË

Lushnjë	Karbunarë
Allkaj	Ballagat
Bubullimë	Fier Shegan
Hysgjokaj	Kolonjë
Golem	Krutje
Dushk	

Bashkia ROSKOVEC

Roskovec	Kurjan
Kuman	Strum

Bashkia PATOS

Patos	Ruzhdie
Zharëz	

Bashkia MALLAKASËR

Ballsh	Ngraçan
Qëndër	Kutë
Greshicë	Fratar
Aranitas	Selitë
Hekal	

3.2.4 Popullsia, dendësia, të ardhurat, investimet dhe punësimi

A1 – Popullsia dhe dendësia

Popullsia e Shqipërisë për çdo qark është mbajtur gjithnjë bazuar në Regjistrat civil deri sa u organizua Census-i i viti 2011. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 nëpërmjet Census-it të organizuar nga INSTAT nxori një shifër për çdo qark të Shqipëri. Në atë kohë Qarku i Fierit, i përbërë nga tre bashki të mëdha, numëronte një popullsi rezidente prej

310,331 banorësh të shpërndarë respektivisht: 165,356 banorë në Rrethin e Fierit, 117,913 banorë në Rrethin e Lushnjes dhe 27,062 banorë në Rrethin e Mallakastrës. Kjo popullsi, e cila në numër përbën qarkun të dytë me të madh në Shqipëri, në përqindje përbën rreth 11,1% të popullsisë së Shqipërisë.

Tabela 3: Popullsia e qarqeve të Shqipërisë sipas Census-it 2011 dhe Regjistrit civil 2016

Qarku	Census 2011		1 Janar 2016		Rritja vjetore
	Numri popullsisë	i Pesha	Numri popullsisë	i Pesha	
Berat	141,944	5.1%	139815	4.8%	-0.30%
Dibër	137,047	4.9%	134153	4.6%	-0.42%
Durrës	262,785	9.4%	278775	9.7%	1.22%
Elbasan	295,827	10.6%	298913	10.4%	0.21%
Fier	310,331	11.1%	312448	10.8%	0.14%
Gjirokastrë	72,176	2.6%	70331	2.4%	-0.51%
Korçë	220,357	7.9%	221706	7.7%	0.12%
Kukës	85,292	3.0%	84035	2.9%	-0.29%
Lezhë	134,027	4.8%	135613	4.7%	0.24%
Shkodër	215,347	7.7%	215483	7.5%	0.01%
Tiranë	749,365	26.8%	811649	28.1%	1.66%
Vlorë	175,640	6.3%	183105	6.3%	0.85%
Totali	2,800,138	100.0%	2886026	100.0%	0.61%

Për ndërtimin e kësaj table janë përdorur të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë kryer nga Census-i i vitit 2011 të vëna përballë të dhënave të regjistrit të gjendjes civile të vitit 2016 i cili është në vazhdimësi të regjistrimeve të kryera nga Census-i.

Deri në momentin e realizimit të Census-it, në Regjistrin civil të Qarkut Fier numëroheshin 486,891 banorë përkundrejt një shifre të zvogëluar

prej 310,331 banorë që prodhoi Census-i. Këtu është për t'u nënvizuar se nga vetë mënyra e mbledhjes së të dhënave, Census-i tregon numrin e popullsisë faktike në çdo qark dhe në tërë territorin. Ndërsa regjistri i gjendjes civile 2011 tregonte banorët që figurojnë të regjistruar në çdo qark duke përfshirë edhe ata të cilët kanë emigruar brenda apo jashtë vendit dhe duke mos përfshirë ata të cilët janë rezident në një qark por nuk janë regjistruar si të tillë. Në këtë kuptim të dhënat e Census-it dhe ato që janë bazuar mbi të janë më të vlefshme pasi tregojnë një situatë më reale dhe të dobishme për çdo studim me natyrë ekonomike dhe sociale.

Ndryshimi i popullsisë përgjatë 5 viteve të fundit (2011-2016) ka qenë në nivele të ulëta jo vetëm për Qarkun e Fierit por për krejt vendin. Vetëm 0.61% është rritja vjetore e popullsisë së Shqipërisë në periudhën 2011-2016 përkundrejt shifrave deri në 2.5% që ka pasur kjo rritje deri në vitin 1990. Qarku i Fierit ka pësuar një rritje vjetore të popullsisë në vlerat e 0.14% në vit duke qenë nën mesataren e vendit.

Përfundimisht, mbështetur në regjistrimet e INSTAT, në 1 Janar të vitit 2016 popullsia e Shqipërisë është 2.886.026 banorë çka dëshmon një rritje prej vetëm 3.1% në 5 vjet ose 0.61% në vit. Nga këto, 1,896,961 ose 65.7% janë në moshë pune pasi i përkasin grupmoshave nga 20 vjeç deri në 69 vjeç. Pjesa tjetër prej 743,332 ose 25.8%, i përkasin moshave më të vogla se 20 vjeç dhe vetëm 245,733 ose 8.5% i përkasin moshave mbi 69 vjeç.

Qarku i Fierit në 1 Janar 2016 numëronte 312,488 banorë duke përbërë përsëri qarkun e dytë më të madh të vendit me 10.8% të popullsisë totale në Shqipëri. Ky qark ka një shpërndarje pothuaj të barabartë të popullsisë sipas gjinisë. Nga 312,448 banorë, 159,901 ose 51% janë meshkuj dhe 152,547 ose 49% janë femra.

Qarku i Fierit është një qark me dendësi të madhe të popullsisë. Nga 97.4 banorë/km² që është dendësia mesatare e popullsisë në Shqipëri, në qarkun Fierit kjo dendësi është 3.2 herë më e madhe dhe kap nivelin e 320.28 banorë/km².

A2 – Të ardhurat dhe investimet

Për matjen e të ardhurave për familjet dhe nivelin e investimeve në Qarkun e Fierit do të përdoren të dhënat e fundit zyrtare që ofron INSTAT të cilat i referohen viteve të fundit. Sipas “Vjetarit Statistikor Rajonal 2015” të publikuar nga INSTAT Produkti i Brendshëm Bruto në rang vendi është 1,335 miliardë lek dhe të ardhurat mesatare vjetore për frymë të popullsisë ishin 460,436 lek.

Qarku i Fierit rezulton i dyti sa i përket volumit total të prodhimit me 166.2 miliardë lekë duke kontribuar me 12.4% të PBB-së kombëtare. Edhe të ardhurat për frymë të popullsisë janë mbi mesataren e vendit dhe të dytat në rang vendi me një vlerë prej 520,813 lek në vit për frymë të popullsisë.

Për investimet mund të përdorim të dhënat e siguruar nga CENSUSI 2011¹. Investimet publike në zonë nga njësitë e qeverisjes lokale kanë qenë në nivele të ulëta. Nga 14.3 EUR për banorë që ishte niveli mesatar i investimeve në Shqipëri nga njësitë e qeverisjes vendore në vitin 2011, për Qarkun e Fierit ky nivel i investimeve ishte dukshëm poshtë mesatares në nivelin e 10.34 EUR.

Edhe të dhënat lidhur me investimet nga njësitë e qeverisjes vendore janë të vlefshme dhe të ngjashme me këto investime në vitin 2016 për shkak të ndryshimeve të papërfillshme në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore gjatë kësaj periudhe.

¹ Këto janë të dhënat e vetme zyrtare të besueshme deri në momentin aktual. Këtyre të dhënave u referohen dhe botime të ndryshme të institucioneve të tjera publike në Shqipëri.

Tabela 4: Të dhëna bazë ekonomike të Qarkut Fier

Qarku	PBB (mln lek)	Pesha	PBB për fryme
Kukës	27,898	2.1 %	319,935
Gjirokastrë	29,093	2.2 %	392,225
Dibër	43,236	3.2 %	309,670
Lezhë	45,349	3.4 %	327,027
Berat	54,192	4.1 %	371,324
Shkodër	71,805	5.4 %	323,480
Korçë	72,962	5.5 %	321,697
Vlorë	77,182	5.8 %	422,054
Elbasan	105,245	7.9 %	346,054
Durrës	132,212	9.9 %	481,007
Fier	166,222	12.4 %	520,813
Tiranë	510,093	38.2 %	649,737

A3 – Punësimi

Shqipëria mbetet një vend me natyrë bujqësore me perspektivë relativisht të lartë të rritjes së peshës së këtij sektori të ekonomisë. Kontributi në PBB i këtij sektori është i ndjeshëm krahasuar me sektorë të tjerë duke zënë pak më shumë se 22% të PBB vjetore të vendit. Të punësuarit bujqësi vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të të punësuarve të sektorit privat. Nga 1,024,691 të punësuar në të gjithë Shqipërinë¹, 164,170 janë të punësuar në sektorin shtetëror dhe 860,521 janë punësuar në sektorin privat. Nga këta të fundit, 460,035 janë të punësuar në bujqësi duke përbërë rreth 45% të të gjithë të punësuarve në vend dhe 53.5% të të punësuarve në sektorin privat.

¹ Kjo shifër i përket të dhënave të tremujorit të parë të viti 2016 (INSTAT)

Në Qarkun e Fierit në total janë numëruar 95,044 persona të punësuar në sektorin privat nga të cilët 77,373 janë punësuar në bujqësi. Ky nivel punësimi në bujqësi në masën 81.5% të të punësuarve në sektorin privat është në tregues për natyrën bujqësore të ekonomisë që zhvillohet në këtë qark dhe natyrisht në një masë të ngjashme në bashkitë dhe njësitë administrative përbërëse të tij (edhe në Bashkinë Lushnje).

Tabela 5: Të punësuarit në sektorin privat bujqësor dhe jobujqësor në Qarkun e Fierit

Rajoni	Total	Jo-Bujqësi	Bujqësi	Pesha në Bujqësi
Qarku Fier	95,044	17,671	77,373	81.4%
Rang vendi	860,521	400,486	460,035	53.5%

Kjo shifër tregon se 81.4% e të punësuarve të sektorit privat në rajon punojnë në sektorin privat bujqësor nga 53.5% që është mesatarja në rang vendi. Kjo natyrisht që reflekton natyrën thellësisht bujqësore të zhvillimit ekonomik të zonës bazuar dhe në burimet e bollshme që zotëron ky rajon për këtë sektor.

B – Toka, kulturat bujqësore dhe blegtoria

TOKA

Shqipëri është tashmë e njohur si një nder vendet me sipërfaqen më të vogël të tokës bujqësore në Evropë. Nga 2.8 milion hektarë tokë në rang vendi, 696,00 hektarë janë tokë bujqësore duke zënë në këtë mënyrë vetëm 24.2% të sipërfaqes totale.

Tabela 6: Sipërfaqja e tokës sipas llojit në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ha)

Rajoni	Total	Pyje, livadhe e kullota dhe tokë tjetër	Tokë bujqësore	Pesha e tokës bujqësore
Qarku Fier	189	67	122	64.6%
Rang vendi	2,875	2,179	696	24.2%

Qarku i Fierit zotëron 122,000 hektar tokë bujqësore duke zënë në këtë mënyrë kështu 17.5% të sipërfaqes totale. Me këtë shifër ky është qarku me sipërfaqen më të madhe të tokës bujqësore të punueshme dhe me mundësi ujitjeje në Shqipëri. Kjo sipërfaqe e madhe bën që pesha e tokës bujqësore në raport me totalin e sipërfaqes së tokës në Qarkun Fier të jetë 64.6% nga 24.2% që është kjo peshë në rang vendi. Vetëm një pjesë e vogël e saj prej 67,000 hektarësh përbehet nga format e tjera të tokës të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë me kostot të ulët¹.

BIMËT E ARAVE

Nga 122,000 hektarë tokë bujqësore pjesa dërrmuese e saj prej 90,400 hektarë është mbjellë me bimë arash të tilla si drithëra, patate, fasule, perime, fara vajorë, foragjere, etj. Për shkak të mungesës së tregut për të thithur të gjithë potencialin prodhues të këtij qarku për drithëra dhe produkte të tjerë are për konsum, *pjesën dërrmuese të sipërfaqeve e zënë foragjeret* të cilat ofrojnë mbështetje për blegtorinë. Nga 90,400 hektarë të mbjella, 46.500 hektarë ose 51% e zënë foragjeret dhe 49% e tokës së mbjellë përdoret për produkte për konsum nga individët.

¹ Sipas të gjitha vlerësimeve të konsultuara nëpër studime të ndryshme, kostoja për njësi e të ushqyerit nëpërmjet kullotave është më e ulët se sa kostoja e ushqimit të siguruar në forma të tjera të tilla si agroindustria apo përdorimi i tokës bujqësore për të siguruar ushqim për blegtorinë.

Tabela 7: Sipërfaqja e bimëve të arave në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ha)

Rajoni	Sipërfaqe e mbjellë me bimë arash	Drithëra	Patate	Fasule	Perime	Fara vajore	Duhan	Foragjere	Te tjera ¹²
Qarku Fier	90.4	31.9	1.1	3.8	6.3	0.6	0.0	46.5	0.1
Rang vendi	413.2	136.5	10.1	14.9	37.2	0.7	1.2	207.3	5.3
Pesha	21.9%	23.4%	10.9%	25.6%	17.0%	94.1%	1.0%	22.4%	2.8%

Vlen të theksohet se Qarku i Fierit është vendi ku mbillen pjesa dërrmuese e sipërfaqes së farërave vajorë (luledielli) në Shqipëri (94.1%) dhe ka angazhuar një pjesë të mirë të sipërfaqes në prodhimin e foragjereve, fasuleve, drithërave dhe perimeve të fushës dhe serës.

Për shkak të sipërfaqeve të mëdha, Qarku i Fierit është prodhuesi më i madh i produkteve të bimëve të arës në vend. Nga 8 milion ton prodhime are që është prodhimi vjetor i 12 qarqeve në Shqipëri, vetëm Qarku i Fierit prodhon mbi 2.2 milion ton ose 28.5% të totalit të prodhimit.

Tabela 8: Prodhimi i bimëve të arës në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 Ton)

Rajoni	Sasi prodhimi me bimë arash	Drithëra	Patate	Fasule	Perime	Fara vajore	Duhan	Foragjere	Të tjera
Qarku Fier	2286.9	154.2	33.3	5.7	326.7	1.9	0.03	1,764.9	0.3
Rang vendi	8013.9	695.5	245.0	28.0	1,030.0	2.0	2.2	6,000.0	11.2
Pesha	28.5%	22.2%	13.6%	20.5%	31.7%	92.6%	1.2%	29.4%	2.6%

Ky qark është hambari i drithërave, perimeve dhe fasuleve në Shqipëri duke siguruar respektivisht 22%, 31.7% dhe 20.5%. Është pothuajse vendi i vetëm ku prodhohen farëra vajore (luledielli) për industrinë agropërpunuese. Nga 2,000 ton që është prodhimi vjetor në rang vendi i farërave vajor, 1,852 ton ose 92.6% prodhohen në Qarkun e Fierit.

DRUFRUTORËT

Bimët të cilat prodhojnë kulturat drufrutore zënë një numër të konsiderueshëm në Qarkun Fier. Nga 29,021 pemë frutore, ullinj, agrume dhe pjergulla që janë mbjellë në gjithë Shqipërinë, 4,622 prej tyre ose 15.9% janë mbjellë në Qarkun Fier. Gjithashtu nga 10,438 hektarë vreshta të mbjella në gjithë Shqipërinë 19.8% e tyre ose 2,062 hektarë janë mbjellë në Qarkun e Fierit.

Tabela 9: Numri i drufrutorëve në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 rrënje)

Rajoni	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Vreshta (ha)	Pjergulla
Qarku Fier	1,258.0	2,244.0	319.0	2,062.0	801.0
Rang vendi	12,405.0	9,225.0	1,282.0	10,438.0	6,109.0
Pesha	10.1%	24.3%	24.9%	19.8%	13.1%

Nga 81,302 Ha të mbjella me drufrutorë në të gjithë Shqipërinë, Qarku i Fierit zë vendin e parë si hambarë edhe për këto kultura me 19,963 Ha duke përbërë në këtë mënyrë afërsisht $\frac{1}{4}$ e gjithë sasisë së mbjellë në rang vendi.

Natyrisht që është kjo sipërfaqe e madhe e mbjellë do të korrespondojë me prodhim të drufrutorëve në sasi po në të njëjtat nivele krahasuar me rajonet e tjera të vendit. Nga 576,000 ton prodhim në kultura drufrutore që sigurohet nga 12 qarqet në të gjithë Shqipërinë, 98,600 ton ose 17.1% e tyre prodhohen në Qarkun e Fierit.



Tabela 10: Prodhimi i drufrutorëve në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (000 ton)

Rajoni	Drufrutorë total	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Rrush
Qarku Fier	98.6	25.1	23.7	6.0	43.8
Rang vendi	576.0	245.0	96.0	30.0	205.0
Pesha	17.1%	10.3%	24.7%	20.1%	21.3%

Vlen të nënvizohet se ky qark prodhon pothuaj 1/4 e ullinjve dhe mbi 1/5 agrumeve në të gjithë vendin me një prodhim respektivisht 23,700 ton dhe 6,000 ton në vit nga respektivisht 96,000 ton dhe 30,000 ton që është prodhimi total i këtyre kulturave në rang vendi.

BLEGTORIA

Pavarësisht një sipërfaqeje të vogël me kullota, sipërfaqja e madhe e tokës e mbjellë me foragjere në Qarkun e Fierit mundëson rritjen e një numri të madh të bagëtive dhe shpendëve. Nga 8.9 milion copë bagëti në rang vendi, 964 mijë rriten në Qarkun Fier duke përfaqësuar 10.8% të numrit total të bagëtive.

Tabela 11: Numri i gjësë së gjallë për prodhim blegtoral në Qarkun e Fierit (000 copë)

Rajoni	Bagëti	Shpendë	Bletë
Qarku Fier	964.0	2,491.0	23.0
Rang vendi	8,954.0	8,558.0	271.0
Pesha	10.8%	29.1%	8.5%

Ajo që spikat më shumë sa i përket peshës, është numri i shpendëve që rriten në këtë qark duke përfaqësuar 29.1% të totalit të shpendëve që rriten në gjithë Shqipërinë.

Prodhimi i produkteve blegtorale në Qarkun e Fierit zë një peshë të rëndësishme në prodhim total në rang vendi. Shfrytëzimi i më shumë se gjysmës së sipërfaqes së tokës bujqësore për mbledhjen e foragjereve e bën këtë qark prodhuesin më të madh në vend të qumështit, mishit dhe leshit për të cilat zë respektivisht 18.5%, 18% dhe 23.7% të prodhimit në rang vendi.

Tabela 12: Volumi i prodhimit blegtoral në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi

Rajoni	Qumësht (000 ton)	Vezë (mln kokrra)	Lesh (ton)	Mjalt (ton)	Mish (peshë e gjallë) (000 ton)
Qarku Fier	209.2	88.5	791.2	375.8	28.4
Rang vendi	1,131.0	830.0	3,332.0	3,200.0	158.0
Pesha	18.5%	10.7%	23.7%	11.7%	18.0%

Sa i përket prodhimit të mjaltit dhe vezëve ky qark zë një vend të rëndësishëm duke qenë për të dyja produktet qarku i tretë prodhues më i madh në vend, respektivisht për mjaltin pas Qarkut Korçë (707.5 ton) dhe Vlorë (520.2 ton) dhe për vezët pas Qarkut Durrës (277.7 mln. kokrra) dhe Shkodër (102.1 mln. kokrra).

AGROINDUSTRIA DHE PESHKIMI

AGROINDUSTRIA

Niveli i zhvillimit të agroindustrisë në Shqipëri është relativisht i ulët dhe larg nivelit të prodhimit të produkteve lëndë të parë për këtë sektor. Nga 1.13 milion ton qumësht që prodhohet në rang vendi, vetëm 0.13 milion ton përpunohen nga agroindustria ose rreth 1% në formën e qumështit dhe pjesa tjetër përpunohet në formën e nënprodukteve të tjera djathë,

gjalpë dhe kos. Kjo vërehet në nivelet e larta të produkteve të importit të qumështit dhe nënprodukteve të tij që gjenden në pikat e shitjes në gjithë Shqipërinë.

Tabela 13: Përpunimi i produkteve blegtorale në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (ton)

Rajoni	Qumësht	Djathë	Gjalpë	Kos
Qarku	10,600.0	2,708.0	147.0	2,674
Fier				
Rang vendi	116,971.0	12,480.0	579.0	7,765
Pesha	9.1%	21.7%	25.4%	34.4%

Qarku i Fierit, si prodhuesi kryesor i qumështit, zë një peshë të rëndësishme në këtë sektor. Më shumë se 1/3 e kosit, më shumë se ¼ e gjalpë dhe më shumë se 1/5 e djathit në rang vendi prodhohet në këtë qark.

PESHKIMI

Peshkimi është një sektor i cili njësor si bujqësia dhe blegtorja është i përshtatshëm për të nxjerrë përfitime nëpërmjet krijimit të shoqatave të bashkëpunimit. Qarku i Fierit është i pasur në këtë drejtim me ujëra natyrorë dhe artificiale, detarë dhe të brendshëm. Në këtë qark është i zhvilluar peshkimi bregdetar, lagunor dhe ai në ujërat e brendshëm (lumenj dhe liqene artificiale). Pavarësisht burimeve potenciale relativisht të larta për peshkim ky qark kontribuon pak në prodhim kombëtar në sektorin e peshkimit.

Nga 7,704 ton që është sasia e peshkimit në rang vendi, Qarku i Fierit ka kontribuar me 242 ton duke zënë rreth 3.1% të prodhimit. Në këtë kuptim bëhet fjalë për një prodhim në nivele modeste kjo e ardhur nga mungesa e porteve në këtë qark e cila pamundëson peshkimin detar si burimin kryesor të prodhimit në këtë sektor. Është për t'u nënvizuar se ky qark dallon për



nivele relativisht të larta të zënies së peshkut në bregdet dhe në laguna duke zënë respektivisht 17.2% dhe 19.8% të prodhimit total në rang vendi. Kjo natyrisht kushtëzohet nga dendësia relativisht e lartë e lumenjve dhe lagunave që përfshin në territorin e vet ky qark.

Tabela 14: Zënie peshku në Qarkun e Fierit dhe në rang vendi (ton)

Rajoni	Peshkim total	Detar	Bregdet	Laguna	Ujra të brendshëm	Akuakultura	Molusqe
Qarku Fier	242.0	-	110.0	55.0	77	-	-
Rang vendi	7,704.0	2,681.0	640.0	278.0	1,770	1,585	750
Pesha	3.1%	0.0%	17.2%	19.8%	4.4%	0.0%	0.0%

MEKANIKA BUJQËSORE

Qarku i Fierit është rajoni më i motorizuar në Shqipëri sa i përket mjeteve të mekanikës bujqësore e përbërë nga traktorë me rrota dhe zinxhirë, ministraktorë, makina mbjellëse, motokorrëse, autokombajna dhe freza. Nga 29,226 mjete motorike në të gjithë Shqipërinë, 7,318 prej tyre gjenden në këtë qark. Kjo përbën më shumë se $\frac{1}{4}$ e mjeteve motorike në rang vendi (25.04%).

Me 3,234 traktorë (me rrota dhe zinxhirë) të cilët përdoren për të punuar 122,000 hektarë tokë (ose 1.220 km²) ky qark arrin një mesatare prej 265 traktorë për 100 km² tokë të punueshme. Kjo shifër është 1.78 herë më e madhe se sa mesatarja rang vendi prej 148.8 traktorë për 100 km².

Gjithsesi këto shifra janë të larta në rang vendi por mbeten të ulëta nisur nga nevojat që ka bujqësia. Nëse do të vazhdonim të bënim krahasimin me Maqedoninë si një vend me potenciale natyrore për të zhvilluar bujqësinë jo më të mira se sa të Shqipërisë, Qarku i Fierit ka akoma nevojë për

Tabela 15: Mekanika bujqësore për Qarkun Fier dhe në rang vendi

Rajoni	Traktor me rrota	Minitraktore	Makina mbjellëse	Motokorrëse	Autokombanja	Traktor me zinxhirë	Freza
Rang Vendi	10,101	5,238	3,759	2,531	699	256	6,642
Qarku Fierit	3,200	1,051	1,002	615	199	34	1,217
Pesha	31.7%	20.1%	26.7%	24.3%	28.5%	13.3%	18.3%

investime në drejtim të shtimit të mekanikës bujqësore. Në Maqedoni përdoren mbi 1,200 traktorë për 100 km² një shifër kjo 4.5 herë më e madhe se sa vlerat në Qarkun e Fierit.

E – Përmbledhëse statistikore

Bazuar në panoramën e mësipërme për të dhënat statistikore të qarkut të Fierit mund të ndërtojmë një panoramë përmbledhëse me elementët kryesorë përcaktues dhe ato për të cilat spikat ky qark në raport me qarqet e tjera të Shqipërisë.

Tabela 16: Të dhëna statistikore përmblledhëse për Qarkun e Fierit dhe në rang vendi

Zëri/ nënzëri	Rang Vendi	Qarku Fierit	Pesha	
Numri i bashkive	61	6	9.8%	
Popullsia	2,886,026	312,448	10.8%	
Rritja vjetore e popullsisë	0.0061	0.0014		
Dendësia e popullsisë banorë/km²	97.4	320.3		
PBB (mld. Lek)	1,335.0	166.2	12.4%	
Të ardhurat për frymë	460,436.0	520,813.0		
Investimet publike mesatare (EUR për banorë)	14.3	10.3		
Punësimi	761,454	95,044	12.5%	
Të punësuar në sektorin bujqësor	442,883	77,373	17.5%	
Të punësuar në sektor jo-bujqësorë	318,571	17,671	5.5%	
Sipërfaqja e tokës (000 Ha)	2,875	189	6.6%	
Sipërfaqja e tokës bujqësore (000 Ha)	696	122	17.5%	
Pyje, livadhe e kullota dhe tokë tjetër (000 Ha)	2,179	67	3.1%	
Sipërfaqet e bimëve të arave (000 Ha)	413.2	90.4	21.9%	
Prodhimi i bimëve të arave (000 Ton)	8,013.9	2,286.9	28.5%	
Numri i drufrutorëve (000 rrënjë)	29,021	4,622	15.9%	
Vreshta (000 Ha)	10.4	2.1	19.8%	
Prodhimi i drufrutorëve (000 ton)	576.0	98.6	17.1%	
Numri i gjësë së gjallë për prodhim blegtoral (000 copë)				
	Bagëti	8,954	964	10.8%
	Shpendë	8,558	2,491	29.1%
	Bletë	271	23	8.5%
Volumi i prodhimit blegtoral				
	Qumësht (000 ton)	1,131.0	209.2	18.5%
	Vezë (mln kokrra)	830.0	88.5	10.7%
	Lesh (ton)	3,332.0	791.2	23.7%
	Mjalt (ton)	3,200.0	375.8	11.7%
	Mish peshë e gjallë (000 ton)	158.0	28.4	18.0%
Përpunimi i produkteve blegtorale				
	Qumësht (000 ton)	116.97	10.60	9.1%
	Djathë (000 ton)	12.48	2.71	21.7%
	Gjalpë (ton)	579.0	147.0	25.4%
	Kos (000 ton)	7.77	2.67	34.4%
Peshkimi (ton)	7,704.0	242.0	3.1%	
Mekanika bujqësore				
	Traktor me rrota	10,101	3,200	31.7%
	Minitraktore	5,238	1,051	20.1%
	Makina mbjellëse	3,759	1,002	26.7%
	Motokorrëse	2,531	615	24.3%
	Autokombajna	699	199	28.5%
	Traktor me zinxhirë	256	34	13.3%
	Freza	6,642	1,217	18.3%

3.3 Bashkia Lushnjë

Bashkia e Lushnjes është një ndër 6 bashkitë e Qarkut të Fierit dhe 1 nga 61 bashkitë në rang vendi. Deri në vitin 2014 ekzistonte Rrethi i Lushnjes i cili përfshinte 16 njësi administrative. Reforma Administrativo-Territoriale e vitit 2014 e ndau në dy pjesë këtë rreth nga i cili u krijuan Bashkia e Lushnjes me 11 njësi administrative dhe Bashkia e Divjakës me 5 njësi administrative.

Bashkia e re e Lushnjes a një sipërfaqe prej rreth 372.72 km² duke përbërë 1.3% të sipërfaqes së vendit dhe 19.7% të sipërfaqes së Qarkut të Fierit. Kjo bashki e re e krijuar në vitin 2014 aktualisht ka në përbërje të saj 11 njësi administrative dhe 85 fshatra. Njësitë administrative përbërëse të kësaj bashkie janë: Lushnjë, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballakat, Fier Shegan, Kolonjë dhe Krutje.

3.3.1 Pozicioni gjeografik dhe klima

Bashkia e Lushnjes shtrihet në ultësirën perëndimore dhe i përket pjesën veri-lindore të Qarkut të Fierit. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së bashkisë shtrihet në Fushën e Myzeqesë dhe një pjesë në zonat kodrinore të Dumresë.





Fig. 6 Bashkia e Lushnje

Bashkia e Lushnjes kufizohet në veri me Bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me Bashkinë e Peqinit, në lindje me Bashkinë e Belshit, në jug-lindje me Bashkinë e Ura Vajguore, në Jug me Bashkinë e Roskovecit, në jug-perëndim me Bashkinë e Fierit dhe në perëndim me Bashkinë e Divjakës. Ndarja e re administrative e ka kthyer Leshnjen në një bashki në brendësi të territorit të vendit pa dalje në det për shkak se njësitë administrative me dalje në det të rrethit të Lushnjes u bënë pjesë e Bashkisë së Divjakës.

Bashkia e Lushnjes i përket një rajoni me klimë mesdhetare dhe me luhatje të vogla të ekstremiteteve krahasuar me mesataren e vendit në lidhje me temperaturat dhe nivelin e reshjeve përgjatë gjithë vitit. Sipas të dhënave të cilat janë bazuar në një vëzhgim 112 vjeçar për periudhën 1900-2012, temperatura mesatare mujore luhatet nga 5.34 °C për muajin më të ftohtë që është muaji Janar deri në mesatarisht 23.29 °C për muajin më të ngrohtë që është muaji Gusht.

Tabela 17: Temperaturat dhe reshjet në Bashkinë Lushnjë 1900-2012

Muaji	Reshjet (mm/muaj)	Temperatura (mes. Mujore)
Janar	119.25	5.34
Shkurt	113.53	6.13
Mars	102.97	8.85
Prill	96.33	12.35
Maj	75.76	16.83
Qershor	52.97	20.31
Korrik	34.85	23.19
Gusht	44.71	23.29
Shtator	77.21	19.86
Tetor	113.94	15.3
Nëntor	152.73	10.48
Dhjetor	137.72	6.72
Total	1,121.97	-
Mes	93.498	14.054



Niveli i reshjeve është i shpërndarë përgjatë gjithë vitit me një përqendrim më të madh gjatë periudhës Tetor – Mars me nivele mesatare mujore që luhaten nga 102.97 mm (Mars) në 152.73 mm (Nëntor) shi dhe me një nivel më të ulët për periudhën Prill – Shtator me nivele që luhaten nga

mesatarisht 34.85 mm (Korrik) në 96.33 mm (Prill). Në total, në Bashkinë e Lushnjes bien mesatarisht 1,122 mm shi në vit një shifër kjo nën nivelin mesatar në rang vendi prej 1,485 mm në vit dhe temperatura mesatare vjetore është rreth 14 °C dhe kjo nën temperaturën mesatare të ultësirës perëndimore prej 17 °C.

Bashkia Lushnjë ka një karakter të theksuar bujqësor dhe një pjesë e sipërmarrjeve janë fokusuar në tregti për shkak të rrugëve që kalojnë në këtë bashki. Rreth 65% e fushës së Myzeqesë përdoret për qëllime bujqësore ndërsa pjesët përgjatë autostradës janë fokusuar tek biznesit e shërbimeve (hoteleri, restorante) dhe tek industria e lehtë dhe në prodhimin e çimentos, asfaltit, metalit dhe mermerit.

3.3.2 Të dhëna të përgjithshme

POPULLSIA

Bashkia Lushnjë ka një popullsi prej 129,962 banorë nga të cilët 74,962 banorë, ose 57.7% banojnë zonat rurale me aktivitet kryesor fermat bujqësore. Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia e re Lushnjë ka një dendësi popullsie prej 244.7 banorë për km² një dendësi kjo më e madhe se dendësia e popullsisë në rang vendi prej 97.4 banorë/km² por më e vogël se sa dendësia e popullsisë në rang qarku prej 320.28 banorë/km².

BUJQËSIA DHE BLEGTORIA

Bashkia Lushnjë bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare dhe duke iu referuar të dhënave pedologjike, kjo bashki bën pjesë në zonën e tokave “të linjta” kafe. Për shkak të llojit të tokës dhe kushteve atmosferike në Bashkinë e Lushnjes janë të zhvilluara format kryesore të kulturave të arave, pemëtarisë dhe rritjes së gjësë së gjallë. Për shkak të klimës së favorshme dhe ritmit të shpejtë të zhvillimit të serave, toka në Bashkinë Lushnjë në një pjesë të saj shfrytëzohet edhe dy herë në vit me produkte të cilat janë bazë të stinës së verës, kryesisht në perime.

TRANSPORTI

Pozicioni gjeografik i bashkisë së Lushnjës bën të mundur transportin e shpejtë dhe në volume të mëdha të produkteve bujqësore brenda dhe jashtë vendit.

Së pari në këtë bashki kalon superstrada Tiranë - Fier SH4 e cila në veri shkon në Durrës - Tiranë dhe më tej në gjithë qarqet qendrore dhe veriore të vendit, dhe në jug kjo superstradë degëzohet një krah për në Vlorë-Himarë-Sarandë dhe një krah tjetër për në Tepelenë – Gjirokastër, duke lidhur në këtë mënyrë Bashkinë e Lushnjës me veriu, qendrën dhe jugun e vendit. Kjo rrugë e bën këtë Bashki lehtësisht të arritshme në tregjet e mëdha brenda vendit të ndodhur kryesisht në qendrat e mëdha të banimit si Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, etj si dhe mundëson eksportin nëpërmjet transportit rrugor kryesisht për në Malin e Zi, Kosovë, Serbi, Maqedoni, etj.

Së dyti, Bashkia e Lushnjës përshkruhet nga linja hekurudhore Vlorë-Fier-Lushnjë-Rrogozhinë. Që prej këtej (Rrogozhinës) mund të arrihet Tirana, Durrësi, Elbasani, Pogradeci dhe deri në veri në Shkodër. E kombinuar me transportin rrugor mund të arrihet Korça, Maqedonia dhe Greqia. Aktualisht volumi i transportit të produkteve bujqësore nëpërmjet rrjetit hekurudhor është shumë i ulët. Gjithsesi ekzistenca e kësaj linje hekurudhore në Bashkinë e Lushnjës përbën një potencial të ardhshëm për transport të shpejtë, në volume të mëdha dhe me kostot të ulët të produkteve bujqësore brenda dhe jashtë vendit. Deri në vitin 1990 rrjeti hekurudhor ka transportuar volume të mëdha të produkteve bujqësore të Fushës së Myzeqesë drejt Portit të Durrësit dhe drejt kufirit verior të Hanit të Hotit me Ish- Jugosllavinë për të eksportuar produktet bujqësore drejt Evropës qendrore dhe asaj lindore.

TOKA

Nga 37,272 hektarë (372.72 km²) sipërfaqe tokë në Bashkinë e Lushnjës, pjesa dërrmuese prej 30,681 hektarë është tokë bujqësore e punueshme. Kjo shifër tregon se 82.3% e sipërfaqes së tokës në këtë bashki është tokë bujqësore një raport ky shumë më i lartë se sa mesatarja në rang vendi prej

24.2% dhe më i lartë dhe se mesatarja e qarkut të Fierit prej 64.6%. Në total, toka bujqësore që zotëron Bashkia e Lushnjes është pak më shumë se $\frac{1}{4}$ e tokës bujqësore të qarkut të Fierit dhe 4.4% e tokës bujqësore të të gjithë Shqipërisë.

Pjesa që mbetet prej 6,491 hektarësh është e përbërë nga pyje, livadhe e kullota dhe tokë tjetër. Ky është një nivel i ulët krahasuar me qarkun dhe në rang vendi. E thënë me shifra, Bashkia e Lushnjes zotëron toka në formën e pyjeve, livadheve, kullotave, etj. Një sipërfaqe e cila është 0.3% e sipërfaqeve të tokave të tilla në rang vendi dhe vetëm 9.8% e këtyre tokave në rang qarku. Shkaku qëndron se, edhe pse Bashkia e Lushnjes zotëron toka kodrinore në zonën e Dumresë në të cilën shtrihen njësitë administrative Ballagat dhe Hysgjokaj, tokat në këto zona janë të shpyllëzuara dhe shfrytëzohen për mbjelljen e bimëve të arave dhe ndërtimin e serrave, njësoj si tokat në Fushën e Myzeqesë.

Tabela 18: Sipërfaqja e tokës sipas llojit në Bashkinë Lushnjë (000 Ha)

Rajoni	Total	Pyje, livadhe e kullota dhe tokë tjetër	Tokë bujqësore	Pesha e tokës bujqësore
Bashkia Lushnje	37.272	6.591	30.681	82.3%
Qarku Fier	189	67	122	64.6%
Rang Vendi	2,875	2,179	696	24.2%
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>19.7%</i>	<i>9.8%</i>	<i>25.1%</i>	-
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>1.3%</i>	<i>0.3%</i>	<i>4.4%</i>	-

Nga 30,681 hektarë tokë bujqësore, pjesa dërrmuese prej 25,778 hektarësh ose 84% është tokë arë e përdorur për bimët e arës dhe pjesa tjetër prej 16% ose 4,902 hektarësh përdoret për frutikulturë, kryesisht në pemëtari, ullishte, agrume dhe vreshta. Vlen të theksohet se vetëm 200 hektarë tokë është e papërdorur në këtë bashki që është një peshë e papërfillshme prej 0.65% të totalit të tokës bujqësore që zotëron kjo bashki.

BIMET E ARAVE

Bashkia e Lushnjes njihet për sipërfaqet e mëdha dhe prodhimet e dukshme të bimëve të arave qoftë në Qarkun e Fierit ashtu dhe në rang vendi. Siç përmendëm më sipër, 84% e sipërfaqes së tokës bujqësore përdoret për kultivimin e bimëve të arave kryesisht për drithëra, perime dhe foragjere. Ashtu siç ndodh në gjithë Qarkun e Fierit dhe në gjithë Shqipërinë, në Bashkinë e Lushnjes 12,500 hektarë që përbën 48.4% të sipërfaqes së mbjellë me bimët e arave, e zënë foragjeret për blegtorinë. Kjo sipërfaqe përbën rreth 27% të sipërfaqes së mbjellë me foragjere në Qarkun e Fierit dhe 6% të kësaj sipërfaqeje në rang vendi.

Tabela 19: Sipërfaqja e bimëve të arave në Bashkinë e Lushnjes (000 Ha)

Rajoni	Total bimë arash	Drithëra	Patate	Fasule	Perime	Fara vajore	Duhan	Foragjere	Tetjera
Bashkia Lushnjë	25.78	9	0.2	0.7	2.7	0.4	0.011	12.5	0.04
Qarku Fier	90.4	31.9	1.1	3.8	6.3	0.6	0.013	46.5	0.15
Rang Vendi	413.2	136.5	10.1	14.9	37.2	0.7	1.2	207.3	5.3
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>28.5%</i>	<i>29.1%</i>	<i>19.8%</i>	<i>17.3%</i>	<i>42.5%</i>	<i>63.8%</i>	<i>84.6%</i>	<i>26.9%</i>	<i>27.8%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>6.2%</i>	<i>6.8%</i>	<i>2.2%</i>	<i>4.4%</i>	<i>7.2%</i>	<i>60.1%</i>	<i>0.9%</i>	<i>6.0%</i>	<i>0.8%</i>

Angazhimi i sipërfaqeve të konsiderueshme në një tokë pjellore dhe me mundësi të mëdha për vaditje dhe arritjen e rendimenteve të larta reflektohen në një prodhim me peshë në totalin e prodhimit bujqësor jo vetëm në Qarkun e Fierit por dhe për gjithë Shqipërinë. Nga rreth 8 milion ton prodhime të bimëve të arave në vit, vetëm Bashkia e Lushnjës, e cila zotëron 1.3% të sipërfaqes së Shqipërisë, prodhon 728 mijë ton ose 9.1% të prodhimit të bimëve të arave në rang vendi. Kjo natyrisht lidhet me rendimentet e larta të produkteve bujqësore të cilët vijnë falë cilësisë së tokës dhe kushteve të favorshme klimatike. Një faktor me ndikim është dhe mundësia që një pjesë e kulturave të bimëve të arave mund të mbillen dhe më shumë se një herë të tilla si patatat, perimet e serave dhe foragjeret.



Tabela 20: Prodhimi i bimëve të arës në Bashkinë e Lushnjes (000 Ton)

Rajoni	Total bimë arash	Drithër a	Patat e	Fasul e	Perim e	Fara vajore	Duha n	Foragjer e	Të tjera
Bashkia Lushnjë	728.06	48	7	1.0	132.3	1.2	0.02	538.2	0.1
Qarku Fier	2286.9	154.2	33.3	5.7	326.7	1.9	0.03	1,764.9	0.3
Rang Vendi	8013.9	695.5	245.0	28.0	1,030.0	2.0	2.2	6,000.0	11.2
<i>Pesha në rang</i>	<i>31.8%</i>	<i>31.4%</i>	<i>20.4%</i>	<i>17.4%</i>	<i>40.5%</i>	<i>64.8%</i>	<i>65.2%</i>	<i>30.5%</i>	<i>36.3%</i>
<i>Qarku</i>									
<i>Pesha në rang</i>	<i>9.1%</i>	<i>7.0%</i>	<i>2.8%</i>	<i>3.6%</i>	<i>12.8%</i>	<i>60.0%</i>	<i>0.8%</i>	<i>9.0%</i>	<i>0.9%</i>
<i>vendi</i>									

Rajoni i Lushnjes (Bashkitë Lushnjë dhe Divjakë) është prodhuesi kryesor në Shqipëri për drithërat, perimet, foragjeret dhe farërat vajorë. Bashkia e Lushnjes e vetme është prodhuesi kryesor në vend për farërat vajorë (60% të prodhimit); një prodhues i rëndësishëm i foragjereve për blegtorinë (9% e prodhimit kombëtar) dhe prodhon sasi të konsiderueshme të perimeve dukë dhënë 40.5% të prodhimit të qarkut dhe 12.8% të prodhimit kombëtar.

DRUFRUTORËT

Edhe pse pjesa më e madhe e tokës bujqësore përdoret për prodhimin e bimëve të arave dhe vetëm 4,902 hektarësh (16% e tokës bujqësore) përdoret për frutikulturë, Bashkia e Lushnjes është një zonë që njihet jo vetëm për sasi të konsiderueshme prodhimi por dhe për një numër të madh dhe të larmishëm kulturash drufrutorësh që kultivon. Konkretisht në tokat e kësaj bashkie kultivohen katër kategoritë e drufrutorëve:

a) Pemët frutore ku në total janë mbjellë 458 mijë rrënjë në të cilat pjesën më të madhe e zënë fiqt, kumbullat, pjeshkat, mollët, qershitë, dardhat, kajsitë, hurmat, shegët ftojnë, manat dhe arrat. Këto pemë frutore përbëjnë

më shumë se 36% të numrit total të këtyre pemëve të mbjella në Qarkun e Fierit dhe rreth 3.7% të numrit total të pemëve frutore në rang vendi. Përveç tyre është dhe një sipërfaqe prej 592.4 hektarësh me vreshta duke përfaqësuar 28.7% të sipërfaqes me vreshta të qarkut dhe 5.7% të në nivel kombëtar.

b) Ullinj në të cilët një pjesë e mirë prej 38% të numrit total të rrënjëve prodhojnë ullinj të destinuar për vaj; një pjesë e vogël prej 10% destinohet të prodhuar ullinj për kripë (ullinj tavoline) dhe pjesa tjetër prej 52% prodhon varietete të destinuara edhe për prodhim vaji dhe për ullinj tavoline.

c) Agrume të cilat në pjesën më të madhe përfaqësohen nga portokallet dhe një pjesë tjetër e mbjellë me mandarina, limona, etj.

d) Rrushi në Bashkinë Lushnjë prodhohet në dy forma: për tavolinë dhe për tu përpunuar në pije alkoolike. Sasia e rrushit prodhohet nga 592.4 hektar vreshta dhe 180.600 pjergulla të cilat përbëjnë respektivisht 5.7% të sipërfaqes së vreshtit dhe 3% të numrit të pjergullave në rang vendi.

Tabela 21: Numri i drufrutorëve në Bashkinë Lushnjë (000 rrënje)

Rajoni	Gjithsej peme (pa vreshtat)	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Vreshta (ha)	Pjergulla
Bashkia Lushnjë	1142.2	458	426	77.4	592.4	180.6
Qarku Fier	4622.0	1,258.0	2,244.0	319.0	2,062.0	801.0
Rang Vendi	29021.0	12,405.0	9,225.0	1,282.0	10,438.0	6,109.0
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>24.7%</i>	<i>36.4%</i>	<i>19.0%</i>	<i>24.3%</i>	<i>28.7%</i>	<i>22.5%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>3.9%</i>	<i>3.7%</i>	<i>4.6%</i>	<i>6.0%</i>	<i>5.7%</i>	<i>3.0%</i>

Me 1.14 milion rrënje pemë dhe 592.4 hektarë vreshta Bashkia e Lushnjes është një prodhues i rëndësishëm i këtyre kulturave të cilat në të vërtetë janë të përshtatshme për tu rritur në krahina të tjera të Shqipërisë. Kështu me 3.7% të numrit total të pemëve frutore në rang vendi Bashkia e Lushnjes

arrin të prodhoj 4.2% të prodhimit total; me 4.6% të numrit total të ullinjve në rang vendi kjo bashki prodhon 6.5% të prodhimit total të ullirit dhe me 5.7% të sipërfaqes së vreshtave dhe 3% të numrit të pjergullave në rang vendi kjo bashki prodhon 7.7% të rrushit. Të gjitha këto shifra disproporcionale tregojnë për rendiment më tepër se sa mesatarja e vendit në pemët frutore në përgjithësi, ullinjtë, vreshta dhe pjergulla. Vetëm në agrume prodhimi ka peshë më të vogël (5.7%) se sa numri i agrumeve të mbjella në rang vendi që janë 6%. Kjo më shumë i dedikohet jo rendimentit të ulët por moshës së re të një pjese të madhe të agrumeve të mbjella në këtë rajon, kryesisht pas vitit 2005.

Tabela 22: Prodhimi i drufrutorëve në Bashkinë Lushnjë (000 ton)

Rajoni	Drufrutorë total	Pemë frutore	Ullinj	Agrume	Rrush
Bashkia Lushnjë	33.9	10.2	6	1.7	15.7
Qarku Fier	98.6	25.1	23.7	6.0	43.8
Rang Vendi	576.0	245.0	96.0	30.0	205.0
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>34.4%</i>	<i>40.7%</i>	<i>26.5%</i>	<i>28.5%</i>	<i>35.8%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>5.9%</i>	<i>4.2%</i>	<i>6.5%</i>	<i>5.7%</i>	<i>7.7%</i>

BLEGTORIA

Bashkia e Lushnjës është më shumë një rajon me zhvillim primar bujqësinë. Blegtoria nuk është një sektor dallues për këtë krahinë. Ajo që dallon është numri relativisht i lartë i lopëve dhe prodhimit të qumështit. Kjo më së shumti vjen për shkak dhe të sipërfaqeve të mëdha të mbjella me foragjere për këtë sektor. Në Bashkinë e Lushnjës mbarështohen 71,454 copë bagëti të llojeve gjedhë, telishta, të dhirta dhe derra. Ky numër është 7.4% e numrit total të bagëtive të Qarkut të Fierit dhe vetëm 0.8% e numrit total të bagëtive që mbarështohen në Shqipëri. Ky rajon njihet më shumë për rritjen e një numri të madh shpendësh prej 660,789 copë të cilët përbëjnë më shumë se ¼ e shpendëve në rang qarku dhe 7.7% të tyre në rang vendi.

Tabela 23: Numri i gjësë së gjallë për prodhim blegtoral (000 copë)

Rajoni	Bagëti	Shpendë	Bletë
Bashkia Lushnjë	71.454	660.8	3.67
Qarku Fier	964.0	2,491.0	23.0
Rang Vendi	8,954.0	8,558.0	271.0
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>7.4%</i>	<i>26.5%</i>	<i>15.9%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>0.8%</i>	<i>7.7%</i>	<i>1.4%</i>

Ajo që është karakteristike lidhet me faktin se edhe pse me 0.8% të numrit total të bagëtive, në Bashkinë e Leshnjës prodhohet 5.4% e sasisë së qumështit në rang vendi ose 61.5 milion litra. Kjo i dedikohet faktit se në këtë bashki më shumë se 20% e bagëtive janë lopë (14,734 copë) të cilat një pjesë janë raca të zgjedhura me rendiment të lartë në sasinë vjetore të qumështit.

Tabela 24: Volumi i prodhimit blegtoral

Rajoni	Qumësht (000 ton)	Vezë (mln kokrra)	Lesh (ton)	Mjalt (ton)	Mish (peshë e gjallë) (000 ton)
Bashkia Lushnjë	61.537	34.0	97.2	44.1	6.44
Qarku Fier	209.2	88.5	791.2	375.8	28.4
Rang Vendi	1,131.0	830.0	3,332.0	3,200.0	158.0
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>29.4%</i>	<i>38.4%</i>	<i>12.3%</i>	<i>11.7%</i>	<i>22.7%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>5.4%</i>	<i>4.1%</i>	<i>2.9%</i>	<i>1.4%</i>	<i>4.1%</i>

Rendimenti i lartë nuk vërehet për kategoritë e tjera të gjësë së gjallë. Kështu prodhimi i mjaltit zë një peshë 1.4% në rang vendi, aq sa është dhe pesha e numrit të bletëve në rang vendi çka do të thotë se rendimenti është i barabartë me mesataren kombëtare. Prodhimi i vezëve është me një rendiment më të ulët se sa mesatarja në rang vendi për shkak se prodhohen

34 milion kokrra vezë duke zënë 4.1% të prodhimit kombëtar ndërkohë që ky rajon rrit 7.7% të shpendëve në rang vendi.

MEKANIKA BUJQËSORE

Bashkia e Lushnjes është një rajon me një nivel të ulët mekanizimi. Në total në këtë Bashki numërohen 1,135 mjete motorike nga të cilët 632 traktorë për të punuar tokën. Kjo shifër është e ulët qoftë në terma rajonal dhe në terma kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Bashkia e Lushnjes zotëron rreth 15.5% të mekanikës bujqësore në rang qarku dhe 3.9% në rang vendi.

Me një sipërfaqe toke bujqësore 30,681 hektarë (306.8 km²), Bashkia e Lushnjes ka një mesatare prej 206 traktorë për 100 km² tokë bujqësore. Ky nivel është më i lartë se sa mesatarja e Shqipërisë prej 148.8 por më i ulët se sa mesatarja e qarkut të Fierit me 265 traktorë për 100 km². Natyrisht që kjo shifër mbetet larg niveleve që ka një konkurrent rajonal si Maqedonia në të cilën numri i traktorëve për 100 km² është mbi 1,200.

Tabela 25: Mekanika bujqësore për Bashkinë e Lushnjes

Rajoni	Traktor me rrota	Minitraktore	Makina mbjellëse	Motokorrëse	Autokombanja	Traktor me zinxhire	Freza
Bashkia Lushnjë	618	0	74	133	55	14	241
Qarku Fierit	3,200	1,051	1,002	615	199	34	1,217
Rang Vendi	10,101	5,238	3,759	2,531	699	256	6,642
<i>Pesha në rang Qarku</i>	<i>19.3%</i>	<i>0.0%</i>	<i>7.4%</i>	<i>21.6%</i>	<i>27.6%</i>	<i>41.2%</i>	<i>19.8%</i>
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>6.1%</i>	<i>0.0%</i>	<i>2.0%</i>	<i>5.3%</i>	<i>7.9%</i>	<i>5.5%</i>	<i>3.6%</i>

Ajo që bie në sy është numri relativisht i lartë i traktorëve me rrota dhe autokombajnave, duke zënë respektivisht 7.9% dhe 6.1% të numrit total të këtyre mjeteve në rang vendi. Kjo i dedikohet më së shumti terrenit fushor të Bashkisë së Lushnjes. Duke marrë për bazë dhe faktin që prodhimi i drithërave dhe bimëve të arës është i lartë mund të themi se rendimenti i punës së mekanikës bujqësore që zotëron kjo zonë është i lartë. Edhe pse me 3.9% të mjeteve motorike në rang vendi, me 1.3% të sipërfaqes dhe 4.4% të tokës bujqësore në rang vendi, Bashkia e Lushnjes prodhon 9.1%

të sasisë së bimëve të arave dhe 5.9% të sasisë së prodhimit të drufrutorëve. Natyrisht që përpos cilësisë së tokës, kushteve të favorshme atmosferike një faktor me rëndësi është dhe tradita dhe shfrytëzimi me efikasitet mbi mesataren të mjeteve motorike në dispozicion.

3.4 Burimet e financimit të bujqësisë

Nevojat financiare të fermerëve në Qarkun e Fierit dhe Bashkinë e Lushnjes lindin gjatë periudhës së investimit dhe blerjes së inputeve bujqësore. Kostoja e tokës është zero pasi pjesa më e madhe e fermerëve janë vetë pronar të tokës dhe për atë pjesë që përdorin sipërfaqe toke të marrë me qira pagesa e qirasë është relativisht e ulët dhe e përballueshme duke variuar nga 3,300-4,500 lek në vit. E thënë me pak fjalë, nevojat financiare të fermerëve lindin për blerjen e materialeve për investim dhe inputeve bujqësore. Burimet financiare të pjesës më të madhe të fermerëve në Bashkinë e Lushnjes vijnë nga tre kategori të burimeve.

a) *Burimet e brendshme të biznesit bujqësor.* Këto burime vijnë nga fitimet e këtij biznesi. Të ardhurat që sigurohen nga shitjet e produkteve bujqësore, pasi përdoren për shlyerjen e detyrimeve dhe shpenzimeve të ndryshme të lidhura, shkojnë për riinvestim në këtë biznes. Në Bashkinë e Lushnjes, gjatë periudhës në vëzhgim, për muajt muajve qershor dhe korrik 2016 janë konstatuar rritje të blerjeve nga fermerët për pajisje të cilat i përdorin për ndërtimin e serave, magazinave, stallave etj. Këto pajisje blihen për mirëmbajtjen e këtyre ambiente apo dhe për t'i zgjeruar ato me qëllim shtimin e kapaciteteve prodhuese. Ky është në fenomen që përsëritet çdo vit pothuaj në sezonin e parambjelljeve: dhjetor-janar dhe qershor-korrik.

b) *Shtim kapitali* nga pronarët familjarë. Përveç ndonjë përjashtimi, të gjitha të ardhurat nga biznesi bujqësor shkojnë si investim në këtë biznes. Këto të ardhura nuk janë të gjitha burime të brendshme financimi pasi jo të gjitha të ardhurat e biznesit bujqësor janë fitim. Një pjesë e këtyre të ardhurave duhen përdorur dhe për shlyerjen e pagave për gjithë orët e punës që janë përdorur për nxjerrjen e produktit përfundimtar. Nga analiza

e disa bizneseve familjare në Bashkinë e Lushnjës, u arrit në përfundimin se të ardhurat e biznesit familjar që përdoren nga familjarët përfaqësojnë më pak se 50% e orëve të punës që ata kanë dhënë në këtë biznes. E thënë ndryshe, pjesa tjetër që nuk tërhiqet është kontribut shtesë i familjarëve/pronarëve të këtij biznesi familjar.

c) *Financim i jashtëm* nga bankat dhe institucionet e tjera të mikrokreditit. Financim bankar dhe nga institucionet e mikrokreditit për të mbuluar nevoja financiare të fermerëve në Bashkinë e Lushnjës ka tre karakteristikat e mëposhtme:

- është një *burim relativisht i pamjaftueshëm* i fondeve për fermerët e Bashkisë së Lushnjës. Ky është një përfundim i arritur nga intervistimet e fermerëve dhe analizat e kryera me specialistët e fushës së bujqësisë dhe oficerët e kredisë së bankave dhe institucioneve të tjera të mikrokreditit që veprojnë në Qarkun e Fierit dhe specifikisht në Bashkinë e Lushnjës. Institucionet publike nuk zotërojnë/ofrojnë asnjë të dhënë për nivelin e kreditimit. Vetë institucionet e kreditit janë të rezervuar për të ofruar të dhënat e tyre të biznesit).
- financimi bankar dhe nga institucionet e tjera të mikrokreditit *ka kosto dukshëm më të lartë* se sa format e ngjashme të financimit në sektorët jobujqësor. Kështu një institucion mikrokrediti në Qarkun Fier dhe Bashkinë Lushnjë aplikon norma interesi që sipas llogaritjeve efektivisht janë mbi 16% dhe mund të shkojë edhe deri në 30%. Vetëm në raste të veçanta mund të ndodhë që *norma efektive e interesi* për kreditë në bujqësi dhënë në institucionet e kreditit që veprojnë në Qarkun e Fierit të jetë me e vogël se 16% dhe më e lartë se sa 30%.
- *Afti i kredisë* përgjithësisht është disa muaj dhe maksimalisht mund të shkojë deri në 4 Vjet. Në të shumtën e rasteve afati varion nga 6 muaj deri në 3 vjet. Në raste të veçanta mund të ndodhë që kredia të jetë mbi 4 vjet. Dhe kur ndodhin këto raste nuk janë kredi të marra nga fermerë individuale dhe as nga biznese bujqësore familjare .
- *Shuma e kredisë* është e lidhur direkt me nivelin e të ardhurave

dhe qarkullimit të likuiditeteve. Si për çdo rast tjetër, bankat dhe institucionet e mikrokreditit financojnë në shuma dhe afat më të gjatë ato subjekte të cilët sigurojnë të ardhura më të mëdha. Zakonisht bankat dhe institucionet e kreditit që veprojnë në Bashkinë e Lushnjes nuk financojnë një kredi e cila është më e madhe se sa 50% e të ardhurave vjetore të biznesit. Kjo natyrisht që zvogëlon burimet financiare që mund të sigurohen nga kjo formë financimi.

Për shkak të kostove të larta dhe kushteve të pafavorshme, *ekziston një bindje e përgjithshme* mes fermerëve se bankat dhe nga institucionet e kreditit ofrojnë kredi bujqësore me normat e larta interesi. *Reputacioni* i oficerëve të kredisë së disa institucioneve të mikrokredisë është relativisht i ulët. Kjo e ka kthyer financimin bankar dhe nga institucionet e kreditit si një rrugë për të zgjidhur situatat ekstreme të nevojës për fonde dhe jo si një fenomen shoqëruar i ngritjes dhe rritjes së biznesit bujqësor.

Edhe sipas të dhënave zyrtare publikuar nga Banka e Shqipërisë¹, financimi për bujqësinë në rang vendi është në nivele të ulëta krahasuar me sektorë të tjerë të ekonomisë. Nga 500 degë dhe agjenci bankare të shpërndara në gjithë Shqipërinë për vitin 2015, 41 prej tyre (8.2%) janë stacionuar në Qarkun e Fierit dhe vetëm 14 degë dhe agjenci bankare funksionojnë në Bashkinë e Lushnjes.

Nga 111 Shoqëri të Kursim Kreditit (SHKK) të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, 13 prej tyre ushtrojnë aktivitet financues në Bashkinë e Lushnjes.

Tabela 26: Numri i institucioneve të kreditit në Bashkinë Lushnjë

Rajoni	SHKK	Banka	Institucione të tjera krediti
Bashkia Lushnje	13	14	2
Rang Vendi	111	500	2
<i>Pesha në rang vendi</i>	<i>11.7%</i>	<i>2.8%</i>	<i>100%</i>

¹ Burimi: Banka e Shqipërisë, “Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2015”

Në total në Bashkinë e Lushnjës operojnë 29 degë dhe agjenci bankare, SHKK dhe institucione të tjera mikrokrediti. Natyrisht që i rëndësishëm më shumë se sa numri është volumi i financimit. Por numri i ulët në një rajon si Bashkia e Lushnjës me natyrë thellësisht bujqësore të ekonomisë tregon për një interes të ulët sidomos nga bankat për të financuar këtë sektor të ekonomisë.

Nga pikëpamja strukturore, portofoli i subjekteve të kredidhënies dhe të qirasë financiare në Shqipëri për vitin 2015 dominohet kryesisht nga financimet për bizneset e cila përbën 91.7% të totalit të financimit. Nga ky portofol kredie vetëm 12.9% janë shpërndarë në sektorin e “Bujqësisë, gjuetisë dhe silvikulturës” dhe pjesa tjetër për sektorët e tjerë. Është financimi nëpërmjet SHKK-ve dhe Unioneve të kreditit ai që mbështet më shumë sektorin bujqësor me financim. Pjesa më e madhe e financimit të tyre shkon për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) të orientuara në pjesën më të madhe në sektorin e bujqësisë.

Për vitin 2015 financimet në rrjetin e SHKK-ve dhe unioneve, janë kryesisht të orientuara në sektorin e “bujqësisë, gjuetisë dhe silvikulturës”, me rreth 46.48%, ndjekur nga financimet në sektorin e “shërbimeve kolektive, sociale dhe personale” me rreth 19.41%, sektorit “hotele dhe restorante” me rreth 15.91% dhe sektorit të “tregtisë, riparimit të automobilave dhe artikujve shtëpiakë” me rreth 13.73%. Në total, për vitin 2015, bankat, SHKK dhe unionet e kreditit kanë akorduar kredi për sektorin e “Bujqësisë, gjuetisë dhe silvikulturës” një shumë sa 1.3% e totalit të kredisë. Kjo përbën një peshë të papërfillshme për një sektor të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.

Në kushte të tilla një formë e rëndësishme financimi për fermerët në Bashkinë e Lushnjës është kredia informale dhe ajo tregtare. Sipas të argumenteve dhënë nga fermerët dhe specialistët e këtij rajoni, këto forma përbëjnë një burim kryesor të fondeve të jashtme të cilat janë përdorur që prej reformës agrare dhe janë orientuar kryesisht për të financuar blerjen e inputeve bujqësore. Edhe në sezonin e parë të vitit 2016 janë përdorur gjerësisht këto forma informale financimi. Mënyra e zhvillimit të financimit informal zhvillohet në dy mënyra kryesore:

Tabela 27: Institucionet e mikrokreditit në Bashkinë Lushnjë

Nr	SHKK	Institucione të tjera mikrokrediti
1	Agro partner Sh.P.K	NOA
2	Shoqëria e kursim-kreditit “Gramshi”,	Fondi “Besa”
3	Shoqëria e kursim-kreditit “Ardenicë”,	
4	Shoqëria e kursim-kreditit “Bubullimë”	
5	Shoqëria e kursim-kreditit “Gorre”	
6	Shoqëria e kursim-kreditit “Fier seman”	
7	Shoqëria e kursim-kreditit “Allkaj”	
8	Shoqëria e kursim-kreditit “Remas”	
9	Shoqëria e kursim-kreditit “Mize”	
10	Shoqëria e kursim-kreditit “Mërtish”	
11	Shoqëria e kursim-kreditit “Krutje”,	
12	Shoqëria e kursim-kreditit “Çërme”	
13	Shoqëria e kursim-kreditit “Lushnja 2010“	

1) mes vetë fermerëve të cilët i lidh produkti, ose kanë lidhje gjaku dhe miqësie

2) mes fermerëve dhe pikave të ofrimit të inputeve bujqësore. Këto të fundit e shohin shitjen me pagesa të shtyra si të vetmen mënyrë për të mbajtur klientelën. Në këtë drejtim kredia e keqe dhe problemet e likuiditetit kanë qenë bashkëshoqëruese të këtij biznesi. Vitet e paskrizë (2007) e thelluan krizën e likuiditetit për këto biznese duke bërë që një pjesë e mirë e detyrimeve të mos shlyen duke vënë në vështirësi këto biznese apo dhe duke çuar në falimentim një pjesë të tyre. Aktualisht kjo formë financimi për bujqësinë po vjen duke u pakësuar për shkak të këtyre problemeve me likuiditetin.

3.5 Grupimet dhe shoqata të bashkëpunimit të fermerëve

Organizatat e fermerëve në Qarkun e Fierit dhe Bashkinë e Lushnjë janë të pakta në numër. Ç’është më e rëndësishmja, ritmi i rritjes së numrit të tyre ka ardhur duke rënë. Dy format bazë juridike të organizimit të fermerëve në këtë qark, ashtu si në gjithë Shqipërinë, janë (1) grupimet e fermerëve dhe (2) shoqatat e bashkëpunimit.

Grupimet e fermerëve

Siç u nënvizua më sipër këto grupime nuk bazohen mbi marrëdhënie ekonomike dhe si të tilla nuk kanë qëllim fitimin. Këto shoqata krijohen bazuar në ligjit Nr.8788, datë 7.5.2001, “Për Organizatat Jofitimprurëse”. Ashtu si në zonat urbane edhe në zonat rurale fermerët mund të organizohen në shoqata fermerësh me qëllim:

- rritjen e tyre profesionale,
- informimin për zhvillimet e reja në tregjet e inputeve dhe tregjet e produkteve përfundimtare,
- organizimi i tregtimit mbi baza më të avancuara,
- sensibilizimi i anëtarëve për zhvillimet që ndikojnë sasinë dhe çmimin e produktit përfundimtar,
- njohjen me risitë në fushën e inputeve bujqësore
- informimin dhe trajnimin për të synuar arritjen e standardeve ndërkombëtare të cilësisë të nevojshme për të prodhuar produkte të përshtatshme për eksport.

Bazuar në këtë ligj në Qarkun e Fierit, sipas të dhënave për vitin 2015, ekzistojnë 6 grupime fermerësh me një numër total prej 71 anëtarësh nga të cilët asnjë grupim nuk është krijuar në Bashkinë e Lushnjë . Ky është një numër shumë i ulët jo vetëm në terma absolutë por dhe në terma relativë. Në total në Shqipëri ekzistojnë 179 grupime fermerësh me 3,366 anëtarë. Kjo do të thotë që Qarku i Fierit me sipërfaqen më të madhe të

tokës krahasuar me qarqet e tjera, volumin më të lartë të prodhimit në shumë kultura bujqësore dhe me 77,373 fermerë të zërë vetëm 3.4% të numrit të grupimeve të fermerëve të cilët përfaqësojnë 2.1% të anëtarëve të këtyre grupimeve në rang vendi. E thënë ndryshe, 1 në 132 fermerë në rang vendi është pjesë e një grupimi fermerësh ndërkohë që në Qarkun e Fierit ky raport është 1 në 432 ose mbi 3 herë më i ulët.

Shoqatat e bashkëpunimit

Shoqatat e bashkëpunimit në thelb janë bashkime vullnetare me natyrë ekonomike të fermerëve, në funksion të rritjes së prodhimit dhe tregtimit në kushte favorizuese. Ekzistojnë dy forma bazë ligjore mbi të cilat mund të ndërtohet ky bashkëpunim: (a) Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) dhe (b) Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok (SHBR).

a) Sipas nenit 1 të ligjit Nr.8088, datë 21.3.1996 për “Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok” përcaktohet se këto shoqëri janë “bashkime vullnetare të personave fizikë ose juridikë, për kryerjen e veprimeve ekonomike në fusha të ndryshme”. Edhe pse ligji ka krijuar mundësinë e këtyre bashkimeve që në vitin 1996 shoqatat e bashkëpunimit janë krijuar pas viti 2000 çka ka ndikuar në ndryshimet ligjore të vitit 2003 dhe 2007. Në qarkun e Fierit aktualisht (të dhënat e vitit 2015) nuk është krijuar asnjë shoqëri e tillë në nivel urban dhe rural. Ndërkohë në gjithë vendin ekzistojnë 21 grupime të tilla me 1,488 anëtarë.

b) Shoqatat e bashkëpunimit bujqësor janë produkt i një ligji të posaçëm i cili nxit bashkëpunime direkte mes fermerëve në drejtim të bashkimit të burimeve të tyre ekonomike. Specifikisht ligji përcakton se këto shoqëri janë një organizim vullnetar ndërmjet personave fizike ose juridike, me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të tyre në tre fushat e mëposhtme:

- a. prodhimit,
- b. përpunimit
- c. tregtimit të produkteve bujqësorë e blegtorale,

Format ligjore se si mund të përmbushen nevojat e mësipërme nëpërmjet këtyre shoqërive është *“nëpërmjet marrëveshjeve apo bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet tyre dhe shoqërisë për shërbime, mallra apo produkte të sektorit bujqësor ose blegtoral, si dhe nëpërmjet promovimit të veprimtarive të tyre ekonomike¹”*. Është për t'u nënvizuar fakti se këto shoqëri përfitojnë lehtësira duke qenë subjekt i lehtësive fiskale dhe skemave mbështetëse qeveritare.

Kjo formë organizimi, e cila, përpos përfitimeve ekonomike për anëtarët e saj të cilat burojnë nga ekonomitë e shkallës, mundëson dhe përfitime fiskale dhe buxhetore, nuk është përdorur si një mundësi përfitimi qoftë në Qarkun e Fierit qoftë dhe në rang vendi. Në vitin 2015 në Shqipëri ekzistojnë 19 shoqëri të tilla me 260 anëtarë në total. Qarku i Fierit ka vetëm një shoqëri të tillë me 7 anëtarë e cila ndodhet në Bashkinë e Lushnjes.

Grupimet dhe shoqata të bashkëpunimit të fermerëve janë organizime të cilat janë zhvilluar në nivele shumë të ulëta qoftë në rang vendi qoftë dhe në Bashkinë e Lushnjes. Nga 442,883 fermerë vetëm 5,114 janë anëtarë në grupet e fermerëve, SHBB dhe SHBR. E thënë ndryshe 1 në 87 fermerë është anëtar në një organizim të tillë (Këtu nuk merret parasysh fakti që i njëjti fermer mund të jetë anëtar në më shumë se një shoqëri. Shtuar dhe këtë argument raporti do të ishte edhe më i vogël). Për Qarkun e Fierit raportet janë akoma më të vegjël. Nga 77,373 fermerë në këtë qark vetëm 277 janë pjesë e një grupimi. E thënë ndryshe në 282 fermerë vetëm një është pjesë e grupimeve dhe shoqatave të bashkëpunimit. Në Bashkinë e Lushnjes ky raport është më i ulët. Nga 32,554 fermerë të Bashkisë së Lushnjes, vetë 88 janë pjesë e një grupimi ose shoqate bashkëpunimi. Ky raport do të thotë që në 370 fermerë vetëm 1 është pjesë e grupimeve dhe shoqatave.

¹ Neni 3, Ligji nr. Nr.38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”

Tabela 28: Grupimet dhe shoqata të bashkëpunimit të fermerëve

Rajoni	Fermerë	Grupe fermeresh		SHBB		SHBR	
		Grupime	Anëtare	Grupime	Anëtare	Grupime	Anëtare
Bashkia e Lushnjes	32554	0	0	1	11	3	77
Qarku Fier	77373	6	179	2	18	3	77
Rang vendi	442883	179	3,366	19	260	21	1,488
Pesha në rang Qarku	42.1%	0.0%	0.0%	50.0%	61.1%	100.0%	100.0%
Pesha në rang vendi	7.4%	0.0%	0.0%	5.3%	4.2%	14.3%	5.2%



4. PËRKUFIZIMI DHE KATEGORIZIMI I KOOPERATIVAVE

4.1 Përkufizimi i kooperativave

Sipas ICA (International Cooperative Alliance), Kooperativat përkufizohen si: *“Një grup i pavarur njerëzish të cilët punojnë së bashku në mënyrë vullnetare për të plotësuar nevojat e tyre të përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore, nëpërmjet një ndërmarrje si pronë e përbashkët dhe e kontrolluar në mënyrë demokratike”*.

Ndërkohë, Craig (1993) i cituar nga (Saleh 2012) thotë se kooperativa është aplikimi i një ideje shumë të vjetër: kooperimi. Kooperimi përkufizohet si një proces social në të cilin individët punojnë së bashku për të arritur një qëllim apo sukses të përbashkët.

E parë nga një perspektivë tërësore kooperativat janë një sistem i organizimit social i bazuar në principet e bashkimit, demokracisë, barazisë dhe lirisë (Watkins, 1959). Kooperativat janë sipërmarrje biznesi të cilat kanë tre karakteristika kryesore, formën e pronësisë, kontrollin dhe përdorimin e shërbimeve, karakteristika këto që i dallojnë nga format e tjera të biznesit (Laidlaw, 1980).

Në vazhdim të Laidlaw, Staatz gjithashtu përkufizon kooperativat si marrdhënie biznesi në pronësi të antarëve të vet të cilet ndjekin të paktën disa nga principet e Rochdale, të renditura nga Roy:

- Marzha neto shpërndahet sipas pronësisë;
- Kontrolli demokratik, një anëtar – një votë;
- Kthim i kufizuar në aksione;
- Numër i kufizuar aksionesh për një individ;
- Antarësi e hapur;
- Tregëtimi i bazuar në para në dorë;
- Formimi i anetarëve bazuar në edukimin e sistemit të kooperativave të të bërit biznes;
- Paanësia politike dhe fetare;
- Nuk përjashtohen ato që quhen në rregullin financiar risqe të jashtëzakonshme;
- Mallrat e shitur me çmimet e tregut, me marzhën neto;

Sipas Barton (1989), i cituar nga Karlson (2005), koncepti i kooperativës është i lidhur me tre marrdhëniet që egzistojnë midis kooperativës dhe anëtarëve:

- Principi Përdorues – **Pronar** – personi i cili ka në pronësi dhe financon kooperativën është personi i cili e përdor atë.
- Principi Përdorues – **Kontrollues** – personat që kontrollojnë kooperativën janë personat që e përdorin atë.
- Principi Përdorues – **Përfitues** – përfitimet që marrin pronat varen nga koha që përdorin atë.

Në vazhdim, Cook dhe Chaddad (2003) argumentojnë se modelet organizative të kooperativave ndryshojnë nga të drejtat e pronësisë që kanë agjentët ekonomike të lidhur me firmën, siç janë anëtarët, pronarët dhe investitorët.

Nga pikepamja e të drejtave të pronarit modelet e kooperativës janë ndarë në dy kategori kryesore, të cilat janë ato me të drejta të kufizuara pronësie të anetarëve dhe të atyre me të drejta të pa kufizuara. Kjo ndarje sipas Cook përfshin modelet jo tradicionale të kooperatives.

Me të drejta të kufizuara ndarja shkon më tej dhe ndahen në të transferueshme dhe jo të transferueshme, kjo përfaqëson më tej gjeneratën

e re të modelit të kooperativave. Kur janë të transferueshme, përfitimet e kooperativës mund të jenë për anëtarët ose investitorët, të njohur më vonë si kooperativa anëtar – investitor. Si përfundim, përfitimet mund të jenë të transferueshme në mënyrë proporconale ose jo-proporcionale dhe kjo përbën ndarjen e fundit të kategorive. Investimet jo proporcionale të anëtarëve janë kooperativat tradicionale, ndërsa të tjerat janë quajtur “Kooperativa me Investim Proporcional”.

Pronësia me të drejta të pa kufizuara ndahet në dy kategori, të drejta të pa konvertueshme dhe të drejta të konvertueshme, ose firmat e orientuara nga investitorët. Të pa konvertueshmet përfshijnë dy kategori siç janë Kooperativat me Kapital që kërkojnë kompani me kapital të jashtëm jo në kooperativë, dhe kooperativat me kapital investitor me kapital të jashtëm në kooperativë. Këto lloj kooperativash nuk janë modele tradicionale dhe janë larg të qenit të realizueshme në vende të pa zhvilluara të cilat kanë mungesa njohurish për të kuptuar një dinamikë dhe marrdhënie të tillë.

4.2 Parimet e ICA

“Parimet e Kooperativës” të ICA janë njohur si guida më e mirë për të bërë dallimin mes kooperativës dhe forma të tjera të organizimit. Këto principe janë amenduar në vitin 1995, si më poshtë:

1. Anëtarësia e hapur dhe në mënyrë vullnetare

Kooperativat janë organizime vullnetare, të hapura kundrejt gjithë njerëzve të aftë për të përdorur shërbimet e tyre dhe që vullnetarisht pranojnë përgjegjësinë në anëtarësi, pa dallim gjinie, shtrese sociale, racë, politike apo feje.

2. Kontrolli demokratik i anëtarëve

Kooperativat janë organizata demokratike që kontrollohen nga anëtarët e tyre, të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive në vendosjen e politikave dhe marrjen e vendimeve. Së pari, anëtarët e kooperativës kanë të drejtë të

barabartë vote (një anëtar- një votë) dhe kooperativat e llojeve të tjera janë gjithashtu të organizuara në mënyrë demokratike.

3. Pjesëmarrja ekonomike e anëtarëve

Anëtarët kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe të kontrolluar në mënyrë demokratike në kapitalin e kooperativës. Së paku, një pjesë e kapitalit zakonisht është pronë e përbashkët e kooperativës. Anëtarët i shpërndajnë tepricat për këto qëllime: zhvillimin e kooperativës, mundësisht duke ngritur rezerva një pjesë e të cilave është e padukshme; i japin përfitime anëtarëve në proporcion me ndërveprimet e tyre në kooperativë dhe mbështesin aktivitete të tjera të miratuara nga anëtarësia.

4. Autonomia dhe pavarësia

Kooperativat janë autonome, organizata vetë financuese të kontrolluara nga antarësia e tyre. Nëse ato hyjnë në marrveshje me organizata të tjera, përfshirë qeverinë, apo ngrenë kapitalin nga burime të jashtme, ato e bejnë këtë në kushte që sigurojnë kontrollin demokratik nga anëtarët e saj mbajnë autonominë kooperative.

5. Formimi, trajnimi, informacioni

Kooperativat sigurojnë formim dhe trajnim për anëtarët e tyre, për përfaqësuesit e zgjedhur, për menaxheret dhe punojësit në mënyrë që ata të japin kontributin e tyre për të zhvilluar kooperativën. Ata informojnë publikun, veçanërisht të rinjtë dhe opinionistët rreth natyrës dhe përfitimeve të bashkëpunimit.

6. Bashkëpunimi mes kooperativave

Kooperativat ju shërbejnë anëtarëve të tyre në mënyrë shumë eficiente dhe përforcojnë lëvizjen kooperativiste duke punuar nëpërmjet strukturave lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

7. Shqëtesimi për komunitetin

Kooperativat punojnë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit të tyre nëpërmjet politikave të miratuara nga anëtarët e tyre.

4.3 Kategorizimi i Kooperativave

Kooperativat ju sigurojnë fermerëve pjesë të tregut, të cilat ndikojnë në rritjen e të ardhurave duke rritur prodhimin e produkteve bujqesore dhe gjithashtu duke rritur kërkesën për produkte cilësore. Autorë të ndryshëm i kanë klasifikuar kooperativat në mënyra të ndryshme. Kooperativat sipas Nilsson dhe Bjorklund (2003) janë klasifikuar në dy kategori: Tradicionale dhe Sipërmarrëse.

Sipas modelit tradicional, janë ato kooperativa me karakter kolektiv më antarësi të hapur. Në këto kooperativa anëtarët stimulohen të prodhojnë volume të larta përfitimesh nga ekonomia e shkallës. Kolektivizimi dhe heqja e barrierave për të hyrë në to janë dy elementët çelës të cilët formojnë kooperativat tradicionale.

Modeli Siper marrës i Kooperativës karakterizohet nga individualiteti, që do të thotë se të drejtat e pronësisë janë të tregtueshme për të gjithë anëtarët. Kontrollin e kanë anëtarët e fondit të jashtëm të cilët i blejnë të drejtat, dhe përfitimi bazohet në kontributin e secilit prej tyre. Një tjetër kategorizim që vjen nga literatura e ndan kooperativën në: tradicionale, kooperativa pjesmarrëse, kooperative e degëzuar dhe kooperativa e gjeneratës së re.

Kooperativat tradicionale janë ato në cilat kontrolli është plotësisht në duart e anëtarëve, partnerët e jashtëm nuk kanë ndikim në këto kooperativa, nuk ka hyrje të lirë për anëtarët, sipërmarrja është në pronësi të kompanisë, kështu që nuk ka sipërmarrje individuale. Kooperativat tradicionale janë të integruara vertikalisht dhe fokusohen në kushtet e tregut. Këto kooperativa ndjekin strategjinë e lidhshimit të kostos. Ky model përfaqëson formën më të vjetër të kooperativës.

Në modelin e kooperativave me pjesëmarrje, pronësia është e individualizuar dhe investitorët kanë të drejtën e votes në asamblenë e përgjithshme. Ata kanë më shumë burime për R&D dhe për produktet e avancuara. Këto kooperativa ndjekin strategjinë e diversitetit. Në modelin suplementar të kooperativës investitorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm, ku janë pjesë e asamblesë së përgjithshme dhe përfitimet ndahen ndërmjet pronareve dhe anëtarëve. Ky model krijon mundësinë për të rritur shumë kapitalin, më shumë se modelet e tjera.

Në modelin e Gjeneratës së Re, anëtarësia nuk është e hapur, anëtarët mund ti blejnë të drejtat e ofrueshme nga kooperativa. Këto kooperativa operojnë si sipërmarrje individuale ku secili anëtar merr pjesë nga fitimi bazuar në të drejtat që ka blerë.

Ndërkohë ICA ka një klasifikim tjetër për kooperativat:

Kooperativat konsumatore

Kooperativat prodhuese

Kooperativat e punëtorëve

Kooperativat e Blerjes



- Kooperativat konsumatore, janë në pronësi të personave që blejnë mallra ose përdorin shërbimet e kooperatives. Ato operojnë në mbarë botën në fushat e shitjeve me pakicë, energjisë, financiare, shëndetësore etj. Mund të përmendim disa shembuj:

“Shoqëria Kooperativa Konsumatore Daneze” (FBD), ka si aktivitet kryesor të kooperativës menaxhimin e shitjeve me pakicë, menaxhimin e reklamave dhe menaxhimin e pronës. Ajo ka më shumë se 1.6 milionë anëtarë. “Otter co – op” është një kooperativë konsumatore më qendër në Kanada, ajo filloi si një nismë e disa njerëzve që kishin për qëllim të promovonin dhe ndërgjegjësonin njerezit mbi bujqesinë dhe përmirësimin e jetës. Ajo ka më shumë se 53.000 anëtarë dhe 396 punojës. Të ardhurat e saj shkojnë përafërsisht 183.866.549 dollarë.



- Kooperativat prodhuese janë në pronësi të prodhuesve të ndryshëm të cilët punojnë së bashku për të hedhur produktin e tyre në treg.

Një shembull i këtij modeli është “Gujarat Cooperative Milk Marketing Federation” Ltd., e cila është organizata e marketingut më e madhe e prodhimit të ushqimit në Indi me një xhiro vjetore 3.5 miliardë dollarë. Kjo kooperativë ka 3.6 milionë anëtarë prodhues.



- Kooperativat e punëtorëve, këto kooperativa janë në pronësi dhe menaxhohen nga vetë punojësit.

“Alvaro Street Bakery” është një shembull i kooperativave të punëtorëve. Ajo e ka qendrën në Sonoma County, California. Kompania është një furnizues global për produktet e pjekura dhe aktualisht punëson mbi 100 njerëz si dhe prodhon dhe shpërndan mbi 30 lloje artikujsh organikë pjekur.



- Kooperativat e Blerjes, janë shoqëri fitimprurëse biznesi të cilat punojnë së bashku për të rritur fuqinë e tyre blerëse dhe konkurrencën.

Për shembull, “Ace Hardware” është një kooperativë e blerjes me qendër në Illinois, SHBA. Kjo kooperativë operon në më shumë se 50 shtete me më shumë se 4.800 dyqane Ace Hardware Co-op.

Në 2007 ILO i klasifikoi kooperativat në dy grupe kryesore, e para janë ato kooperativa të cilat ofrojnë shërbime për anëtarët e tyre duke përfshirë unionet e kreditit, kooperativat konsumatore, kooperativat bujqësore etj. E dyta janë kooperativat të cilat kanë si qëllim të sigurojnë punë për anëtarët e saj, siç janë kooperativat prodhuese dhe kooperativat e punëtorëve.

4.4 Rëndësia e kooperativave në zbutjen e varfërisë

Sot kooperativat luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social si dhe në uljen e varfërisë për një vend (Schultz, 1953) (Kuznetz, 1966) (Dercon & Gollin, 2014) (Loayza & Raddatz, 2006). Organizatat e fermerëve si kooperativa dhe grupet e fermerëve si institucione bujqësore financiare, mund të luajnë një rol kyç në zhvillimin e zonave rurale në vendet në zhvillim si dhe në luftën kundër varfërisë.

Kooperativat krijojnë vende pune në zonat e varfra ku nuk kërkohet kualifikim i lartë i forcës punëtore. Ato ndikojnë drejtpërdrejtë në zbutjen e varfërisë duke punësuar njerëz nëpër këto zona. Kooperativat ndikojnë

në zbutjen e varfërisë, prodhojnë produkte me çmime të ulëta, rrisin fuqinë blerëse të konsumatorëve të varfër (Dethier & Effenberg, 2012). Duke qenë se kooperativat drejtohen dhe kontrollohen nga anëtarët e saj dhe bazohen në principe demokratike, ato vendosin njerëzit në vendin e parë. Sipas UNDP në kontekstin e zbutjes së varfërisë kooperativat kontribuojnë në:

- Fuqizimin e burrave dhe grave, strategji e cila përfshin angazhimin politik për të siguruar mbrojtjen politike, ekonomike, sociale dhe të të drejtave të njeriut të njerëzve të varfër si dhe formimin e tyre dhe kujdesin shëndetësor. Në shumë vende kooperativat kanë rol kyç në prodhimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme. Sipas ICA në vitin 2001, kooperativat kontrollojnë 100% të tregut të patateve në Hollande, 40% të eksporteve në Uruguai, 33% të shërbimeve bankare në Finland, duke krijuar kështu mundësi të mëdha punësimi për njerëzit që jetojnë në ato zona.
- Barazia gjinore, në Karaibe gratë përbëjnë 58% të anëtarëve të unioneve të kreditit dhe 42% janë të zgjedhura drejtuese në këto unione. Karakteristike e ketyre rajoneve është gjithashtu se numri i grave të arsimuara po rritet gjithmonë e më shumë duke rezultuar në zbutje të varfërisë.
- Përfitime globale nga konkurrenca globale, ka të bëjë me prodhimin e produkteve dhe eksportimin e tyre në vende të ndryshme të botës me të cilat këto kooperativa kanë marrdhënie. Anëtarët e kooperativave marrin mënyrat sesi punojnë vendet e zhvilluara, duke u njohur me pajisjet për prodhimin e produkteve dhe shërbimet dhe politikat që ato ndjekin për të përmirësuar prodhimin.
- Mbështetja ndërkombëtare, bëhet përgjithësisht për vende të varfra që kanë qeveri të korruptuara dhe një infrastrukturë të dobët institucionale. Shpesh buxheti për zbutjen e varfërisë bie në duar të gabuara. Duke ditur këtë, shumë donatorë nga vende të ndryshme kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës, implementimin e teknologjive të reja apo trajnimin e anëtarëve të kooperativës.

Kooperativat si alternative ekonomike janë krijuar për të plotësuar nevojat e njerëzve dhe bazohen në idenë se duke punuar së bashku në grup mund të arrihet ajo që nuk arrihet dot i vetëm. Kooperativat zbusin varfërinë dhe rrisin numrin e të punësuarve, ato ndikojnë në rritjen e fuqisë blerëse në treg duke punësuar ata burra e gra me të ardhura të pamjaftueshme duke ju mundësuar në këtë mënyrë që të blejnë produkte të ndryshme.

Kooperativat nxisin pjesëmarrjen e plotë të të gjithë njerëzve dhe shpërndarje të barabartë ndërmjet anëtarëve, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit. Sipas (Levin, 2002), promovimi i kooperativave duhet të konsiderohet si një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik kombëtar dhe ndërkombëtar.

4.5 Disa strategji që kooperativat duhet të ndjekin për t'ju pershtatur mjedisit të sotëm

Sot, jo vetëm kooperativat por edhe biznesi po përballlet me sfida që kërkojnë veprime konkrete për t'ju pershtatur kushteve të tregut. Rënia e komunizmit në Shqipëri dhe globalizimi i tregjeve ndryshoi në mënyrë radikale mjedisin ku kooperativat bujqësore veprojnë dhe ndërveprojnë. Kooperativat e fermerëve duhet të kenë anëtarësi dhe potencialin për tu zhvilluar ekonomikisht. Kjo do të thotë se fermeri duhet të zotërojë mjaftueshëm tokë, të përballojë kreditë dhe të zhvillojë njohuritë dhe teknikat e kërkuara. Fermeri duhet të informohet mbi tregun dhe të krijojë kontakte biznesi. Tregjet e reja ekonomike në të cilat operojnë kooperativat kanë sjellë një lloj të ri konsumatori i cili kërkon cilësi të lartë produkti, çmime të arsyeshme dhe preferon produkte të shëndetshme. Kështu që kooperativat janë të detyruara të implementojnë strategjitë e duhura për t'ju pershtatur tregut. Disa nga strategjitë që kooperativat duhet të ndjekin për të hyre sa më mirë në treg janë: E-commerce, inkurajimi dhe përfshirja e anëtarëve, të sigurojnë mbështetje teknike në fushën e marketingut dhe të pajisjeve, të jenë të shpejtë në shpërndarjen e produktit (Saleh, 2012). Mbrojtja mjedisore ka një vëmendje të veçantë në ditët e sotme, ku për sa i përket kooperativave ato kanë avantazhin sepse duke u bazuar në

disa principe dhe vlera specifike ato kanë si qëllim të mbrojnë anëtarët e tyre. Këta njerëz janë gjithashtu pjesë e komunitetit ku kooperativat operojnë dhe kanë përgjegjësinë të ruajnë mjedisin duke transmetuar edhe përgjegjësi sociale tek të tjerët.

Kooperativat si një formë organizimi në komunitetet rurale ndihmojnë fermerët në mbrojtjen e intersave të tyre dhe në disa aspekte të tjera si:

- Argumenti kryesor mbi të cilin organizohen së bashku fermerët është fuqizimi i tyre si komunitet që ndan një interes të përbashkët dhe ka objektiva relativisht të njëjta. Një organizim i tillë i ndihmon ata të marrin kontrollin e interesit të tyre ekonomik dhe zhvillimin e së ardhmes.
- Fermerët duhet të mësojnë dhe të trajnohen rreth shumë principeve menaxheriale, dinamikës së grupimit, mbi planifikimin dhe kontrollin. Gjatë vëzhgimeve tona në vizitat nëpër fermerë apo grupe në krijim, u vu re se një aftësi ishte shumë e nvojshme, ajo ishte teknika negociatore dhe e zgjidhjes së konflikteve.
- Një tjetër rol i kooperativave mund të jetë zhvillimi i burimeve njerëzore dhe optimizimi i atyre që kanë. Anëtarët dhe njerëzit që menaxhojnë punën duhen trajnuar e prezantuar me mjete e pajisje të reja për ti bërë më të aftë dhe për ti fuqizuar duke i bërë të kuptojnë rolin e tyre me kalimin e kohës.
- Kooperativa duhet të shihet si një institucion i zgjidhjes së problemeve dhe roli i saj duhet të perceptohet si i drejtë dhe edukativ.
- Kooperativa duhet të identifikojë mundësitë e tregut për produktet e saj përmes strukturave menaxheriale.



4.6 Çështjet me ACS

Ashtu si çdo formë tjetër organizimi edhe kooperativa ka problematikat dhe vështiresitë e veta në menaxhimin e dinamikës së saj. Çështje që fillojnë që nga marrdhëniet mes anëtarëve, burimet njerëzore, meknizmat e anëtarësimit, kapitali, përgjegjësia menaxheriale etj, janë dhe më të debatuarat në literaturë. Gjithsesi, duket se argumentat që gjejmë në literaturë konvergojnë realisht me problematikat që prekin kooperativat. E para është, “*free rider problem*”. Ideja e këtij problemi është që anëtarët përdorin kapitalin dhe burimet e kooperativës duke marrë përfitime prej tyre por ndërkohë nuk kontribuojnë në mënyrë proporcionale duke u krahasuar me anëtarët e tjerë, si dhe në raport me atë çka marrin, qoftë kapitali apo për çfarëdo lloj gjëje. E dyta, është problemi i horizontit të investimeve. Teknikisht, ky problem lind kur Anëtarët pretendojnë nga të ardhurat neto të gjeneruara nga një aktiv kur jeta e këtij aktivi është me e shkurtër se horizonti i investimit. Me fjalë të tjera financimi i një kooperative has vështirësi bashkëpunuese lidhur me heterogjenitetin në mesin e anëtarëve të saj.

E treta, problemi i portofolit. Kur një kooperativë ka një anëtarësi të hapur dhe nuk është homogjene, anëtarë të ndryshëm kanë preferenca të ndryshme kur vjen puna të investimet, risku, operacionalizimi i objektivave etj. Në këtë situatë është e vështirë për organizatën të diversifikojë interesat preferenciale të individëve, prirjen për riskun dhe investimet. Sjellja bipolare e unifikimit të interesit të përgjithshëm të organizatës dhe i fermereve si individë krijon problemin portfolio.

Kontrolli është një çështje që has çdo organizatë, ose e njohur ndryshe edhe si problemi i agjensisë. Problemi i agjensisë ndodh kur njëra palë presupozohet të veprojë në interesin më të mirë të një pale tjetër. Konkretisht vihet re kur menaxheret presupozohet kur menaxherët mendohet të marrin vendime në të mirë të kooperatives dhe anëtarëve të saj.

Së fundmi, problemi i influencës. Të qënurit shumë anëtarë në kooperativë bën që një numër interesash të diskutohen në tryezën e menaxhereve. Gjithsesi, disa intersa zënë peshë më të madhe sesa të tjerat. Madhësia

e disa interesave krijon lakueshmërisë në shpërndarjen e autoritetit, që mund të ketë efekt në vendimmarrjen dhe në konfliktet e mundshme që mund të ngrihen më pas. Pavarësisht nga gjetjet teorike ka disa vërejtje që vlen të theksohet se janë reagime të drejtpërdrejta nga intervistat me fermerët e rajonit në studim. Ajo që duket të jetë çështja e parë kur flitet për fermerët është niveli i injorancës që ata kanë në njohuritë dhe aftësitë themelore.

Ndonjëherë dukej se njohuritë e akumuluar që kanë pasur deri në atë moment ishin fituar në rrugë jo konvencionale, do të thotë me anë të instinktit siç bëjnë kafshët, ose përmes metodës “provë dhe gabimi”. Përdorimi i një metode të tillë në bujqësi është një eksperiment që merr shumë kohë. Duke qenë se është një proces sa individual edhe social, karakteristike në të tilla procese sociale është koha e gjatë e implementimit. Duhet mbajtur parasysh këtë boshllëk në njohuri dhe aftësi shpesh fshatarët grupohen në forma primitive të kooperatives, ose kur i pyet për t’ju bashkuar një kooperative ata përgjigjen se nuk e ndjejnë veten pronarë të kooperativës. Në kontekstin shqiptar kjo nuk është thjeshtë një “free riding problem”, apo një çështje eksternaliteti makroekonomik, është më shumë e lidhur me njohuri të deformuara dhe sjellje të ç’rregullta të trashëguara nga rregjimi komunist. Mbas kolektivizimit dhe konfiskimeve nga qeveria, çdo gjë e humbi vlerën dhe askujt nuk i interesonte kush ishte.

Për më tepër, në mënyrë që fermerët të bashkohen në një organizatë, anëtarët kanë të drejtë të dinë në mënyrë të qartë rregullat e anëtarësisë dhe përcaktimin e ndarjes së fitimit. E lehtë për tu thënë, por jo aq për tu vënë në praktikë. Sidoqoftë ky është një problem i kooperativave.

Edhe nëse dikush arrin të vendosi rregulla të qarta të anëtarësisë dhe ndarjes së fitimit, tja shpjegosh ato fermerëve është një mision përtej të kuptuarit.

4.7 Faktorët që vështirësojnë zhvillimin e kooperativave në Shqipëri

Zhvillimi ekonomik në Shqipëri është ndoshta në një fazë të jo të mirë për vet vendin por optimale për lëvizjet kooperativiste. Mungesa e zhvillimit institucional, nivelet e larta të korrupsionit mes administratës, mbështetje të ulët shtetërore për bujqësinë dhe tilla të ngjashme, përbëjnë kushtet e duhura ekonomike dhe socio politike për grupimin e fermerëve në kooperativa jo vetëm për arsye ekonomike, por edhe për arsye politike.

Një shembull episodik vjen pikërisht nga një fshat i Lushnjes, që përbën dhe fokusin tonë në këtë studim. Vetëm dy muaj para zgjedhjeve të përgjithshme në Shqipëri, fermerët e atij fshati u mbledhën për të diskutuar situatën e fshatit të tyre. Shumica në atë kohë kishin investuar në ngritjen e serave me projekte donatorësh ndërkombëtare dhe sipërmarrës të huaj. Përpos gjithë investimeve, korrjeve të mira, prodhimit të mirë dhe punës së madhe ata nuk kishin rrugë për të shkuar deri te fushat e mbjella dhe ishte e pamundur për produktet e tyre ti transportonin deri te kamionët që prisnin gati për ekport. Rrugët e fshatit ishin një çështje parësore dhe e domosdoshme për lulëzimin e se ardhmes së tyre dhe për të marre mbrapsht përfitimin e këtij investimi të madh.

Çështja i ishte bërë e njohur tashmë pushtetit vendor dhe qëndror e megjithatë neglizhenca, politikanët e korruptuar, mungesa e llogaridhënies dhe shumë si këto kanë bërë që problemi të vazhdojë duke mos pasur asnjë shenjë pozitive. Krerët lokalë të tri partive kryesore që kandidonin në zgjedhje, PDSH, PS, LSI, u mbledhën dhe vendosën të nxisin elektoratin e tyre për të bojkotuar votimin për çdo parti derisa të përmbushen kërkesat e tyre. Duke përdorur influencën e tyre në fshat, e gjithë popullsia vendosi të bojkotonte votimet e atyre zgjedhjeve. Përgjigja erdhi shpejt dhe brenda një muaji u ndertua rruga e re me standarte urbane dhe u inagurua pikërisht përpara zgjedhjeve. Pra shkurt, ky episod tregon se të bashkuar ata jo vetëm mund të reduktojnë kostot e prodhimit por gjithashtu të rrisin fuqinë e tyre negociuese.

Siç e përmendëm edhe më parë, Shqipëria ka një kontekst socio politik dhe

ekonomik. Cilat janë disa nga çështjet me të cilat përballen fermerët dhe bujqësia në Shqipëri në shkallën makro? Disa nga çështjet më shqetësuese gjatë dy dekadave të fundit që ne mund të arrijmë nga literatura dhe nga intervistat me fermerët janë përmbledhur më poshtë:

- Është përlllogaritur se toka bujqësore mesatarisht për familje është 1.02 ha, një sipërfaqe qesharake kjo krahasuar me vendet e zhvilluara. Gjithsesi, kjo vjen si rezultat i hapsirave të vogël që ka vendi ynë dhe se më shumë se 60% e territorit përbëhen nga malet. Problemi bëhet më keq kur marrim në konsideratë parcelizimin e tokës që ka ndodhur në Shqipëri, pasi ra regjimi komunist. Ndarja e tokës u bazua në numrin e pjesetareve që kishte një familje, prandaj duke e bërë të pamundur për çdo familje apo individ të arrinte të përfitonte nga ekonomia e shkallës dhe e madhësise nga prona e tij. Fragmentimi siç ilustrohet në imazhin më poshtë tregon ndarjen alogjike të tokës. Problemi me operacionalizimin e tokës nuk mbaron me parcelizimin e këq te saj.

Fig. 7 Ilustrim i parcelizimit të tokës në rajonin e Lushnjës



- Në Shqipëri çështja më e keqe që tregon çdo vit prej më shumë se dy dekadash në çdo raport ndërkombëtar vlerësimin e rreziqeve të investimeve në vend dhe që mban larg investorët e mëdhenj dhe strategjikë është pasiguria me pronën private. Niveli i lartë i korrupsionit, një sistem shumë i korruptuar dhe i njëanshëm gjyqësor, mungesa e sundimit të ligjit, ka bërë të vështirë për të gjetur se kush është pronari i vërtetë i pasurisë ose e një cope tokë. Në çdo kohë disa pronarë me dokumente të njëjta mund të shfaqen duke pretenduar pronësinë e të njëjtës pjesë toke.
- Duke supozuar se kemi tokën, çështja ngrihet me vullnetin drejt bashkimit në kooperativë me legjislacionin që mbulon forma të tilla të organizimit. Mentaliteti i kooperativave që ka ngelur nga sistemi totalitar e bën të vështirë për njerëzit për t'ju bashkuar me dëshirë iniciativave të tilla, në vijim një pjesë tjetër mbulon çështje ligjore dhe kuadrin institucional në detaje në lidhje me Shqipërinë.
- Politika publike nuk ka qenë kurrë në favor të kooperativave. Shumë është folur gjatë dy dekadave të fundit, mirëpo asgjë nuk është bërë në praktikë kundrejt formave të tilla organizative. Mungesa e politikave mbështetëse dhe rregulluese çon në mungesë të politikës fiskale për fermat kooperative, me qëllim stimulimin e tyre.
- Financimi është një tjetër problem që lidhet me bujqësinë. Ka pasur nisma që kanë patur për qëllim të ndihmonin fermerët në këtë drejtim, megjithatë ato ishin institucione hije që rrallë zgjasin në misionin e tyre. Fermerët nuk mund të marrin kredi direkt nga bankat për shkak se zakonisht nuk kanë kolateral dhe interesat janë shumë të larta. Megjithatë, unionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare kanë qenë të njohur për kreditimin grabitqar dhe për normat e tyre tepër të larta të interesit duke mashtruar fermerët.
- Çmimet e larta të inputeve bujqësore (nuk ka prodhim të pesticideve, kimikateve bujqësore dhe farave në Shqipëri). Tregu i inputeve të tilla mund të themi se është oligopolistik, megjithatë iniciativat private nga firmat e huaja thyejnë barrierat e çmimeve oligopolistike. Për

shembull, për të ndërtuar sera në Lushnjë për qëllime eksporti, një kompani izraelite ka sjellë farat e veta dhe mekanizmat, jo duke u mbështetur nga kompanitë lokale kur vjen puna e inputeve. Një tjetër kompani gjermane që ka shumë çështje me kulturën e piperit në Greqi, është në kërkim të një mundësie në Shqipëri. Kompania gjermane është e gatshme të japë çdo lloj inputi përfshirë fara, dhe gjithashtu një treg të gatshëm për të shitur korrat e tyre.

- Çmimi i lartë i karburantit. Fermerët shqiptarë përdorin lëndë djegëse për bujqësi me të njëjtin çmim që e përdorin njerëzit për konsum normal. Ka pasur debat të madh mbi këtë çështje, sepse Shqipëria ka karburantin më të shtrenjtë në rajon për shkak të monopolit në treg, organet e korruptuara të qeverisë, dhe tatimi i lartë i karburanteve e ka bërë situatën të padurueshme. Për shembull, fermat pranë qytetit të Shkodrës e blejnë karburantin nga Mali i Zi, ata afër Kosovës e blejnë karburantin në Prizren (qytet i Kosovës), dhe ata që janë në Korçë dhe Pogradec zakonisht i mbushin depozitat e tyre në Maqedoni. Kjo do të thotë se shpenzimet e transportit dhe të gjitha rreziqet janë të krahueshme me ndryshimin e çmimit të karburantit që është në Shqipëri në krahasim me rajonin. Ky diskutim është më shumë i lidhur me faktorët që pengojnë fermerët në vend, se direkt me kooperativat. Megjithatë, inpute të tilla të rëndësishme si lëndët djegëse që perbejnë zakonisht një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të prodhimit prek të paktën në mënyrë indirekte formacionet e kooperativave.

- Në hierarkinë ekonomike shqiptare fermerët nuk janë fuqëzuar mjaftueshëm dhe kryesisht shihen dhe trajtohen si “kategori tjetër”. Kjo i bën fermerët të qendrojnë larg nga kooperativat dhe format e tjera të organizatave pa e ditur se çfarë do të kishte qenë ndryshe.

- Për një kohë të gjatë fermeri ka punuar në mënyrë primitive, me mungesë aftësish, të njohurive teknike dhe të menaxhimit. Kjo situatë i bën ata të pavetëdijshëm për shumë mundësi, jo vetëm duke u grupuar në kooperativa, por edhe kur ju marketon atyre mundësitë e biznesit, mungesa të tilla ekstreme të njohurive i bëjnë ata gjithmonë skeptik ndaj propozimeve.

- Mentaliteti i fermerëve për të punuar në grupe nuk është i zhvilluar mirë. Dinamika e grupit është pjesa më e vështirë për tu menaxhuar në kontekstin shqiptar. Injoranca e rrënjosur thellë ka prodhuar gjithmonë keqkuptime që në shumë raste kanë qenë fatale, edhe duke qenë të afërt vëllezër, kur bëhet fjalë për mosmarrëveshje mentaliteti është një realitet i ashpër. Duke i shtuar këtij mentaliteti, në pjesën e shpjeguar më parë, reminishencën nga e kaluara komuniste, e bën kooperativën si nocion, një ide shumë të vështirë për t'u zbatuar.

Disa nga pikat e lart-përmendura përmbledhin elementët pengues për formimin e kooperativave. Në anën tjetër është pyetja e fermerit: Pse duhet të bashkohem në një kooperativë? Përveç faktorëve pengues të formacioneve të kooperativave, anëtarësimi në një kooperativë i jep fermerit mundësi të mëdha për të kapërcyer të gjitha pengesat. Përveç kësaj, disa arsye pse fermerët duhet të bashkohen në një kooperativë janë përmbledhur shkurtimisht më poshtë: Makineritë e fermave të vjetra

Tabela 29: Përdorimi i mekanikës në bujqësi për rrethin Lushnjë

	4.Kultivime		5. Sperkatje		6.Korrje te lashtash			Me autokombajne
	Gjithsej	Mekanike	Gjithsej	Mekanike	Gjithsej	Korrje	Shirje	
Bashkia Lushnje	460	370	1100	800	475	475	475	475
Raporti i Punimit me mekanike		80%		73%		100%		100%

Tabela 30: Përdorimi i mekanikës në punimin e tokës për rrethin Lushnjë

	Toke e punuar		Ngark.	1. Plugime		2. Shkriferime		3. Mbjellje	
	Gjithsej	Mekanike		Gjithsej	Mekanike	Gjithsej	Mekanike	Gjithsej	Mekanike
Bashkia Lushnje	3418.2	2741.4	59.15617021	3175.4	2380	2300	2300	3175.4	3050
Raporti i Punimit me mekanike	80%			75%		100%		96%	

Tabela 31: Raporti ne % i mekanizimit

Nr	Emertimi		Njesia	Volumi i punimeve gjithesej	Me mekanike	%
I	Toke e punuar gjithsej		ha	51108.24	x	x
	Nga kjo: Punuar me mekanike		"	x	43348	x
	Ngarkesa e nje traktori me rrota ne ha fizik		"	33.5	x	x
1	Plugime		"	45300	33900	74.8
2	Shkriferim (diskim+frezim)		"	33540	33540	100.0
3	Mbjellje gjithsej		"	45300	43480	96.0
4	Kultivime		"	13363	10690	80.0
5	Sperkatje		"	15400	9240	60.0
6	Korrje te lashtash gjithsej (korrje+shirje)		"	10058	10058	100.0
	Korrje		"	10058	10058	100.0
	Shirje		"	10058	10058	100.0
	Nga kjo: Korrje me autokombajne		"	x	9417	x

Tabelat e mësipërme tregojnë se sa pjesë e punës është bërë nga makineritë dhe duke mbajtur në konsideratë zhvillimin e bujqësisë shqiptare këto përqindje janë të kënaqshme. Megjithatë, këto të dhëna nuk kanë marrë në konsideratë optimizimin e tokës. Për shembull, në qoftë se potenciali i përdorshmërisë së tokës është për 100 ha, dhe për arsye të ndryshme fermerët përdorin vetëm 10 ha, dhe ato 10 ha janë të gjitha të pluguara nga makineritë, ky nuk është një tregues që tregon gjendjen reale të zhvillimit të bujqësisë. Përveç kësaj të dhënës e mësipërme nuk tregojnë amortizimin i makinerive të përdorura, sa moderne dhe të dobishme janë, dhe nëse janë dhënë me qira ose blerë nga fermerët. Gjithashtu në këtë pikë duket të jetë më shumë një pengesë për fermerët në vend se për kooperativat si organizata.

- Kooperativat janë struktura menaxheriale dhe përveç funksioneve të tjera thelbësore ato ndihmojnë fermerët duke krijuar lehtësi në marketing, vende magazinimi, paketimin dhe përpunimin e produkteve të tyre. Sinergjia e krijuar nga një organizatë kolektive kursen shpenzimet lidhur me ambjentet frigoferike, magazina mbledhjeje, transportin, dhe financimin. Një grup formal në periferi të Lushnjës ka dhënë me qira makineri dhe ofron shërbime për anëtarët e saj me çmime shumë të lira, ndërsa për makineritë që nuk përdoren, ato i ofrojnë si shërbime për jo anëtarët, me çmimet e tregut. Nëse nuk do të ishte për kooperativën, ata fermerë bulmeti kurrë nuk do të kishin qenë në gjendje të jepnin me qira një traktor të vetëm. Për më tepër, ata negociuan një marrëveshje të mirë me një prej prodhuesve më të mëdhenj të qumështit në vend ku u përfshinë kushte të tilla si: prodhuesi të sigurojë enë të re për qumështin që do mblidhet dhe do të ruhet në vendin e duhur dhe prodhuesit do të vijnë në kohë të caktuar të marrin produktin. Tani ata janë në kërkim të mundësive të tjera se si të përdorin pozicionin strategjik të përfituar nga bashkimi, edhe pse në mënyrë të qartë nuk kanë njohuri dhe kanë horizonte të shkurtër nga mungesa e vizionit.

- Fermerët kanë aftësi të dobëta negociuese jo vetëm nga mungesa e njohurive dhe aftësive, por edhe nga shkalla e tyre e vogël e prodhimit. Një investitor gjerman donte të eksportonte më shumë se 200 kw

perimeve të ndryshme. Fermeri nuk mund të perballonte një shumë të tillë të prodhimit duke u përgjigjur se ajo që mund të ofronte ishte një maksimum prej 15 kw. Duke u bashkuar me një kooperativë ndihmon me ekonomitë e madhësisë dhe të përballohen kërkesat e tregut.

- Në të gjitha iniciativat e kooperativave që kemi analizuar jo vetëm në Lushnjë, por në të gjithë Shqipërinë, pothuajse të gjitha nuk kanë patur kanale marketingu. Ato nuk kishin qasje për kanalet e tregut, nuk kishin politikë çmimesh, dhe të gjitha ishin afruar së pari nga shpërndarësit ose direkt nga klientët. Në kooperativat funksione të tilla janë thelbi i veprimtarisë së saj operacionale. Kostot optimizuese, burimet njerëzore, burimet arsimore, planifikimi i biznesit, etj

- Një çështje tjetër e rëndësishme që fermerët përballen dhe mund të zbutet duke u bashkuar në një kooperativë është ajo në lidhje me tregun e punës. Njerëzit e aftë për punë mungojnë në qytete e jo më në fshat, edhe pse kooperativa mund të zgjedhë, jo vetëm të gjejë personat e duhur e të punojë me shumë njerëz, por edhe përmes trajnimit të vendasve dhe ngritjes së kapaciteteve optimizuese, derisa ata të fitojnë aftësitë e duhura. Kooperativa zgjedh atë që ata kanë në tregun lokal dhe mund të përballojë paga më të larta, me anë të ndarjes së shpenzimeve, për të paguar një ekspert dhe konsulent bujqësor aq të nevojshëm.

- Së fundi, hulumtimi është elementi më i rëndësishëm, i cili nuk kuptohet ende siç duhet në vendet ku elitat supozohet të jenë si psh. universitetet, jo më pastaj në mesin e fermerëve. Ky proces thelbësor, aq shumë i rëndësishëm për çdo pjesë të organizatës, proceset e biznesit, inovacionin, dhe vendim-marrjen, është më pak i praktikuari. Më keq akoma është fakti se ka qarkullim të pak vetëdije në drejtim të procesit kërkimor sa që rëndësia e saj ende nuk është kuptuar. Kooperativat ndihmojnë me kërkim të centralizuar, apo departamenteve R&D, për të prodhuar vendimmarrje më të mirë, menaxhim më të mirë, zgjidhje efikase të problemeve, dhe orientimin e tregut për atë që është më e mirë dhe më e mira për të korrur dhe prodhuar.



5.

MODULE TRAJNIMI QË MERREN ME AFTËSITË & HENDEKUN E NJOHURIVE TE FERMERËT

Objektivi kryesor i këtij seksioni është të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e kooperativave të fermerëve në Shqipërinë rurale. Në krahasim me vendet e tjera, analiza e hendekut të aftësitësive dhe njohurive te fermerët në Shqipëri ka një tjetër standard hyrës. Gjatë intervistave me fermerët kemi vënë re konfliktualitetin në diskutime në grup, dhe sa e vështirë ishte për ta të konvergojnë në një qëndrim, për një problem të caktuar. Përveç kësaj, ne kemi vërejtur se për shumë fenomene dhe çështje ata nuk kishin dijeni. Prandaj, ne kemi vendosur që moduli i parë i kurrikulave të trajnimit duhet të jetë i tillë që ti vendosë ato në kontekst dhe të ngrejë vetëdijen.

Meqënëse ndërgjegjësimi është një fazë e hershme e zhvillimit, fermerët në këtë pikë janë të ballafaquar me koncepte dhe ide të reja, por lehtësisht të kuptueshme. Duke u shpjeguar mjaftueshëm në kontekstin dhe realitetin e tyre perceptual. Së pari krijohet ndërgjegjësimi, më pas bëhet e kuptueshme mjaftueshëm. Në teknikat e të mësuarit është i nevojshëm angazhimi dhe veprimi.

Në mënyrë që të marrim angazhim nga fermerët, është e nevojshme tu krijohet ideja se në fund ata do të përfitojnë diçka të dobishme dhe kryesisht me vlerë materiale. Vumë re se gjatë trajnimeve të mëparshme problemet e tyre ishin ngritur me zë të lartë, por nuk ju ishte dhënë asnjë zgjidhje nga trajnerët. Veprimi, si fazë e fundit, është një fazë që do ti angazhojë ata në procese praktike dhe të dobishme për të mësuar. Teoria

është e vështirë që të mbahet mend pa ditur bazat dhe duke marrë parasysh disa kufizime të moshës, ne zbatojmë moton “duke mësuar e duke bërë”. Veprimi më i vlefshëm dhe efektiv në perspektivën e fermerit është ai që rezulton nga të kuptuarit dhe nga angazhimi në çështjet e ngritura gjatë fazës së vetëdijes. Në këtë mënyrë fermerët do largohen nga trajnimi jo vetëm me përgjigje për pyetjet e tyre, por edhe me një nivel frymëzimi.

Përveç përbërjes së programit të trajnimit, ne propozojmë një qasje ndryshe të trajnimit, mjaftueshëm motivues për të lindur dëshira për të bërë detyrën. Me tu futur në temë, shpejt kthehet në udhëzuese, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të mësonin se si bëhet. Pastaj, ajo bëhet e zbatueshme, në mënyrë që pjesëmarrësit ta bëjnë atë vetë nën mbikëqyrjen tonë. Së fundi, ajo kthehet në argëtuese në mënyrë që ata të shijojnë eksperiencën dhe t’ju lindi dëshira për ta replikuar më vonë.

Modeli që ne propozojmë për të vlerësuar përvetësimin e njohurive është koni i të mesuarit i zhvilluar nga Edgar Dale. Kjo metodë mund të arrijë deri në 80-90% të përvetësimit të njohurive mbas trajnimit, në krahasim me 10-20% të metodave të tjera. Të mësuarit duke bërë është një metodë e fuqishme, baza e kësaj metodologjie është pjesëmarrja aktive e praktikantit, mjetet e ndryshme përfshirë simulimet, të praktikuarit e detyrës nën mbikëqyrje profesionale.

Fig. 8 Modeli i përthithjes së njohurive sipas E. Dale

Cone of Learning		
After 2 weeks we tend to remember		Nature of Involvement
90% of what we say and do	Doing the Real Thing	Active
	Simulating the Real Experience	
	Doing a Dramatic Presentation	
70% of what we say	Giving a Talk	
	Participating in a Discussion	
50% of what we hear and see	Seeing it Done on Location	Passive
	Watching a Demonstration	
	Looking at an Exhibit Watching a Demonstration	
	Watching a Movie	
30% of what we see	Looking at Pictures	
20% of what we hear	Hearing Words	
10% of what we read	Reading	



OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

- 
- OBJEKTIVI 01** Të kuptuarit e përfitimeve nga kooperativat
 - OBJEKTIVI 02** Të kuptuarit e dinamikave të formave të tilla të organizatave
 - OBJEKTIVI 03** Të kuptuarit dhe të zbatuarit e aftësive komunikuese dhe negociuese
 - OBJEKTIVI 04** Të kuptuarit dhe zbatuarit e bazave të menaxhimit, kanalet e marketingut dhe të shpërndarjes

Duke pasur parasysh objektivat e mësipërme, ne propozojmë modulet vijuese të trajnimit.

Moduli I

- Ndërgjegjësimi
- Të kuptuarit
- Angazhimi
- Të vepruarit



Moduli II

- Komunikimi
- Negociatat
- Zgjidhja e konflikteve



Moduli III

- Çfarë është kooperativa?
- Pse më mirë në një kooperativë?
- Qëllimi dhe objektivat
- Anëtarësia
- Kontrolli
- Struktura
- Operacionet



Moduli IV

- Bazat e kooperativave moderne
- Planifikimi i Biznesi për kooperativat
- Menaxhimi i Shoqatave
- Marketing
- Shpërndarja dhe logjistika
- Baza e ligjit
- Kërkim tregu
- Bazat e menaxhimit (financiare, administrative, burimet njerëzore)



Moduli V

- Rast studimi
- Rast studimi
- Rast studimi
- Rast studimi



6. GJETJET (FINDINGS)

Zona e studimit që ne kemi hulumtuar dhe analizuar për të zhvilluar një model koperative është i realizueshëm. Lushnja dhe Korça janë dy rajonet më të zhvilluara në Shqipëri. Përveç tokës së mirë për fermerët, faktor tjetër është karakteri social i njerëzve, dhe qasja e tyre kundrejt punës. Lushnja prodhon pjesën më të madhe të produkteve bujqësore për tregun vendas dhe për eksport, 5.9% të prodhimit të përgjithshëm të drufrutorëve në vend dhe 9.1% të bimëve të arave referuar Instat. Të gjithë distributorët e farave dhe inputeve bujqësore janë të vendosura dhe kryejnë fushata marketing dhe trajnime në Lushnje. Pjesa më e madhe e prodhuesve më të mëdhenj të, produkteve të qumështit, grurit dhe misrit, kanë zyrat e tyre në Tiranë por magazinat në Lushnje. Bashkia e Lushnjes historikisht ka qënë dhe vazhdon të mbetet një rajon me rendimente në nivele të larta krahasuar me gjithë vendin. E shtrirë në vetëm 1.3% të territorit të vendit, duke pasur në zotërim 4.4% të tokës bujqësore ky rajon prodhon 12.8% të perimeve, 9% të foragjereve dhe 7% të drithërave. Në një zonë të tillë ekzistojnë hapësira të mëdha për të rritur efijencën nëpërmjet uljes së kostove dhe rritjes së mëtejshme të rendimentit brenda kufijve të forimit të produkteve me cilësi konkurruese. Edhe pse një zonë kryesisht fushore Bashkia e Lushnjes ka mbjellë një numër të madh drufrutorët dhe siguron nivele të larta prodhimit të tyre në raport me sipërfaqen që zotëron. Kjo bashki ka mbjellë në total 3.9% të pemëve frutore në rang vendi dhe zotëron 5.7% të vreshtave duke prodhuar në total 5.9% të prodhimit të përgjithshëm të drufrutorëve në vend. Edhe këtu, disproporcioni midis sipërfaqes së mbjellë në rang vendi (3.9%) dhe peshës së prodhimit total në rang vendi (5.9%) vjen nga rendimentet e larta dhe përdorimi i teknologjive të reja në prodhimin e drufrutorëve siç janë pemët në kordon. Aplikimi i metodave të avancuara të menaxhimit dhe organizimit të burimeve që zotëron kjo zonë do të rriste prodhimin dhe shfrytëzonte sa duhet potencialet e saj për prodhime në frutikulturë. Edhe pse me 3.9% të mjeteve motorike në

rang vendi, me 1.3% të sipërfaqes dhe 4.4% të tokës bujqësore në rang vendi, Bashkia e Lushnjes prodhon 9.1% të sasisë së bimëve të arave dhe 5.9% të sasisë së prodhimit të drufrutorëve. Natyrisht që përpos cilësisë së tokës, kushteve të favorshme atmosferike një faktor me rëndësi është dhe tradita dhe shfrytëzimi me efikasitet mbi mesataren të mjeteve motorike në dispozicion. Të dhënat e mësipërme janë të mjaftueshme për të kuptuar se pjesë e këtij studimi nuk është një qark mesatar por një qark me të dhëna dukshëm mbi mesataren në pjesën më të madhe të parametrave që lidhen me bujqësinë. Fieri dhe brenda tij rajoni i Lushnjes përbëjnë laboratorin më të mirë të mundshëm në vend për të studiuar mundësinë e implementimit të Koperativave si një mundësi e bashkëpunimit të vërtetë bujqësor larg perceptimit dhe kompleksitetit të gabuar që krijoi tentativa e dhunshme e sistemit të centralizuar për të krijuar me imponim një bashkim vullnetar.

Siç e kemi përmendur më parë edhe në studimin e literaturës, ekzistojnë tre kategori faktorësh të cilët ndikojnë mbi koperativat: kushtet ekonomike, aftësitë organizative të fermerëve si dhe politikat publike. Duke studiuar zonën e Lushnjes dhe në takimet me fermerët ajo që arritëm të kuptonim ishte se sot nuk është e mjaftueshme që thjeshtë të prodhosh, por duhet të prodhosh me cilësi. Ne jemi munduar të mbajmë këtë taksonomi, ndërkohë që grupojmë gjetjet tona.

6.1 Faktorët që pengojnë zhvillimin e koperativave

Kushtet ekonomike

- Kushtet primitive të bujqësisë në Shqipëri, nuk janë të lidhura vetëm me investimet e ulëta, por gjithashtu edhe me implemetimin e dobët të politikave nga organet qeveritare. Ekziston një llogaritje e paverifikuar e cila demonstroi kushtet brutale të fermerëve. Supozohet se popullsia rurale në Shqipëri është rreth 50% dhe shumica janë fermerë të çdo lloji, ato ofrojnë pothuajse 25% të PBB në Shqipëri, dhe në këmbim marin vetëm 1% nga buxheti i shtetit. Infrastruktura

e dobët rrugore, mungesa e investimeve në sistemet e ujitjes, taksat e larta të shitjes së tokës dhe transaksionet e qiras i bëjnë fermerët të dobët dhe të paorganizuar.

- Në Bashkimin Europian, bujqësia subvencionohet shumë dhe zë rreth 40% të buxhetit total të BE. Kjo demonstron rëndësinë që ka bujqësia në ekonominë e një vendi dhe në përmirësimin e jetesës së banorëve. Rritja e kërkesës për produkte bujqësore si pasojë e urbanizimit dhe e rritjes së popullsisë, e kanë bërë parashikimin e kërkesës për këto produkte një çështje shumë të diskutueshme ndërmjet studiuesve dhe politikbërësve në të gjithë botën. Në Shqipëri duket se nuk kuptohen ashtu siç duhen implikime të tilla që lidhen me rëndësinë e bujqësisë.
- Në këtë kategori përfshihen gjithashtu edhe dukuri historike të cilat kanë prekur zhvillimin e bujqësisë në periudha të ndryshme kohore. Një dukuri e tillë mund të jetë organizimi i fermerëve në të ashtëquajturat koperativa në vitet 1990 dhe ndarja e pronave të tyre, duke vendosur kështu një gjykim të njëanshëm të rrënjësor thellë për organizime të tilla. Në çdo shtet madje edhe një shekull më parë koperativat kanë qenë organizime të krijuara dhe administruara vullnetarisht. Ky gjykim i njëanshëm mund të vërehet në mesin e fermerëve, veçanërisht atyre të rinj.
- Qeverisja vendore ka kontribuar pak me investime në Qarkun Fier. Përkundrejt shifrave të larta të prodhimit, njësitë e qeverisjes vendore kanë investuar një nivel të ulët nën mesataren e investimeve në rang vendi, duke mos dhënë kontributin e tyre në shtytjen e zhvillimit në këtë qark me kontribut në të ardhurat rajonale dhe ato kombëtare.
- Qarku i Fierit është një rajon me zhvillim thellësisht bujqësor, Janë 81.4% e të punësuarve në rajon të cilët punojnë në sektorin privat bujqësor. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se sa mesatarja në rang vendi e të punësuarve në bujqësi e cila është 58.2%.
- Sektori bujqësor ofron potenciale të larta punësimi dhe prodhimi. Aktualisht ky sektor jep një kontribut të zvogëluar në PBB (22% nga

55.8%) duke punësuar një numër në rënie individësh. Kjo përbën argument për të kërkuar mënyra më të mira të organizimit të punëve në bujqësi duke synuar rritjen e prodhimit dhe uljen e kostove. Të dyja këto arrihen nëpërmjet ekonomive të shkallës të cilat japin më shumë fryte sa më i madh të jetë biznesi bujqësor.

- Si në të gjithë Shqipërinë edhe në Bashkinë e Lushnjes dhe në Qarkun e Fierit më gjerë ekziston nevoja për mekanikë bujqësore. Kjo nevojë është rezultat jo vetëm i diskutimeve me fermerët dhe analizës së shifrave me specialistët por dhe krahasuar me vendet e rajonit. Maqedonia është një vend me potenciale natyrore zhvillimi në bujqësi jo më të mira se ato të Shqipërisë. Në këtë vend përdorin mbi 1,200 traktorë për 100 km² tokë të punueshme. Ndërkohë që kjo shifër është vetëm 265 për Qarkun e Fierit, një shifër kjo e lartë krahasuar me rajonet e tjera në Shqipërisë, por akoma larg zhvillimit të një bujqësie të mekanizuar. Në Bashkinë e Lushnjes kjo shifër është akoma më e ulët në 206 traktorë për 100 km².

- Në total në Bashkinë e Lushnjes operojnë 29 degë dhe agjenci bankare, SHKK dhe institucione të tjera mikrokrediti. Natyrisht që i rëndësishëm më shumë se sa numri është volumi i financimit. Por numri i ulët në një rajon si Bashkia e Lushnjes me natyrë thellësisht bujqësore të ekonomisë tregon për një interes të ulët sidomos nga bankat për të financuar këtë sektor të ekonomisë.

Aftësitë organizative të fermerëve

- Një gjetje e rëndësishme lidhur me aftësitë e fermerëve është mungesa e ndërgjegjësimit të tyre në lidhje me konceptin e kooperativave, përfitimet e tyre, apo edhe strukturës. Ne kemi zbuluar nga intervistat e realizuara që fermerët ndjekin mjaft trajnime dhe programe nga të cilat dalin me shumë pyetje dhe pa zgjidhje. Çka do të thotë që për një periudhë të gjatë kohe nuk ka pasur ndonjë iniciativë për të rritur ndërgjegjësimin rreth kooperativave si dhe për të zhdukur supozimet e mbetura nga sistemi i vjetër i organizimit të kooperativave.

• Cilësia e udhëheqësit, e cila është shumë e rëndësishme për organizatat sot, është shumë e ulët tek fermerët, për të mos thënë joekzistente. Kjo vjen për një sërë arsyesh. Literatura pronon se iniciativat koperativiste në vendet në zhvillim kanë dështuar përgjatë vitetve si pasojë e mungesës së besnikërisë nga anëtarët e tyre, që në shumicën e rasteve vjen nga injoranca e tyre. Ky është rasti tipik në Shqipëri, siç ne arritëm të identifikonim përgjatë kërkimit tonë. Duke mos qenë në dijeni, duke mos njohur kontekstin dhe mungesa e ekspertizës, shkatërron motivimin dhe besimin për një qëllim të tillë. Interesante në këtë pikë është një konstatim që u vu re që në fillim por që kuptohet më vonë. Disa fermerë të cilët prodhojnë produkte qumështi, kanë krijuar një formë koperative si një organizatë e cila ka krijuar një mardhënie me disa blerës të qumështit dhe kanë disa makineri që japin shërbime të lira për anëtarët e tyre, si dhe shërbime me çmime tregu për jo anëtarët. Kur ne shkuam ti intervistonim ato, zbuluam që kjo ishte rezultat i një projekti Gjerman që ka filluar rreth 10 vjet më parë. Çfarë është interesante është që në takimet e zhvilluara, pothuajse në të gjitha rastet në krye të kooperativave ishte një burrë në moshë mesatare dhe rreth e rrotull tavolinës ishin të gjitha femra. Nga një anë kjo tregon çështjen e besimit, problemet e lidhshmit, dhe mungesa e strukturës për këtë çështje. Sepse vendosja e femrave në kontekste të tilla lehtëson të gjithë presionin që vjen nga nevoja për organizime të tilla. Në anën tjetër kjo çon në balancimin gjinor dhe rritjen e punësimit për femrat, sado paradoksale që mund të tingëllojë.

• Edhe në këto iniciativa koperativiste, si këto të përmendura më lart, mungesa e llogaridhënies dhe rregullave të qarta vërehet mjaft. Mungesa e menaxhimit dhe strukturës administrative për të mbajtur dhe zhvilluar strukturën prodhon situata me potencial për rreziqe morale.

• Shumë evidente është mungesa e njohurive dhe eksperiencës në fushën e menaxhimit të kooperativave.

• Parcelizimi i tokës është më shumë përgjegjësi e vetë fermerëve

sesa politikave qeveritare. Fermerët kanë dështuar për tu grupuar dhe për të përfituar nga ekonomia e shkallës. Aftësitë e tyre financiare frenojnë mundësitë për të blerë makineri bujqësore e për pasojë çojnë në mekanizëm të ulët bujqësor.

Politikat Publike

- Literatura mbështet qëndrimin që infrastruktura institucionale është e lidhur ngushtë me rritjen ekonomike. Arkitektura institucionale në Shqipëri është de jure në vendin e duhur, gjithsesi ndërveprimi real ndërmjet institucioneve dhe fermerëve është joekzistent. Shërbimet qeveritare dhe konsultimet nga zyrat e tyre nuk janë tërësisht joekzistente, por mungesa e profesionalizmit të tyre nuk i përgjigjet nevojave reale të fermerëve.
- Mbyllja dhe degradimi i instituteve të kërkimit e ka bërë të pamundur nga fermerët testimin e inputeve, materialeve apo edhe zhvillimin e analizave të tokës. Për më tepër nuk ka kërkime dhe studime që kanë të bëjnë me bujqësinë, pjesa më e madhe e tyre është e parëndësishme apo janë studime plagjiaturë të cilat nuk kanë asnjë funksion konkret.
- Siç është përmendur edhe më lart, mungesa e subvencioneve aq të nevojshme, tregon për një politikë të gabuar qeveritare që vazhdon të veprojë për një kohë shumë të gjatë. Pavarësisht kësaj fermerët në Shqipëri, vuajnë mungesën e qëndrueshme të furnizimeve me energji elektrike si dhe infrastrukturës rrugore. Politika qeveritare më e nevojshme dhe më e diskutuar është ajo që lidhet me çmimet e inputeve bujqësore. Qeveria Shqiptare ka dështuar për më shumë se dy dekada në implementimin e një skeme e cila redukton çmin e naftës. Çmimi i naftës është më i larti në rajon dhe një nga komponentët kryesorë të kostove të prodhimit. Një kosto tjetër thelbësore për fermerët, janë ato të inputeve bujqësore, që përfshijnë: farërat, pesticidet, etj. Fermerët paguajnë TVSH 20% për të gjithë këto inpute, duke fryrë kështu kostot e prodhimit, në krahasim me fermerët e tjerë, pa filluar akoma të korrat.





6. FINDINGS (GJETJET)

Literature, as noted earlier, recognizes three categories of factors affecting cooperatives: economic conditions, farmers organizing capabilities and public policies. Going through the fields of Lushnja and meeting farmers we found that today is not enough to produce, but it is necessary to produce with quality. The study area that we explored and analyzed for setting a pilot cooperative is feasible. Lushnja and Korça are two of the most developed regions in Albania.

Beside good land for farmers, another factor is the social character of people and their approach toward work. In Lushnje is produced most of the agricultural production for Albanian market and for export. All seed and farm product inputs distributor are located and carry out marketing campaigns and trainings in Lushnja. Most of the biggest producers of dairy, wheat, corn, etc have their offices in Tirana but their magazines in Lushnje. Farmers have reached a certain point that seem to understand that being together is the only way to thrive in the market.

Lushnja Municipality has historically been and continues to be a region with yields at high levels compared with the whole country. Situated in only 1.3% of the territory, having owned 4.4% of agricultural land this region produces 12.8% of vegetable, 9% of forage and 7% of cereals. In such areas exist the potential for increasing efficiency by reducing costs and increasing productivity, producing high quality products. Although a mainly flat area, Lushnja municipality has planted a large number of fruit

trees and provides high levels of production in relation to the surface that owns. The municipality has planted a total of 3.9% of fruit trees nationwide and owns 5.7% of vineyards producing in total 5.9% of the total production of fruit trees in the country. Even here, the disproportion between the area planted nationwide (3.9%) and the share of total production in the country level (5.9%) comes from high efficiency and the use of new technologies in the production of fruit trees such as trees in cordon. The application of advanced management methods and organizational resources in this area will increase production and exploit its potential sufficiently to produce fruit growing. Although this multiplicity has only 3.9% of motor vehicle, 1.3% of surfaces, 4.4% of agricultural land nationwide, it produce more than 9.1% of arable crops and 5.9% of fruit trees. Except the quality of soil, favorable weather conditions a very important factor is the tradition and efficient use of motor vehicles.

The above data are sufficient to understand that this study analyzes not an average region of Albania, but one with indicators significantly above average in most of criteria related to agriculture. Fieri and its region, Lushnja comprise the best ecosystem to study the possibility of implementing cooperatives as an opportunity of true agricultural cooperation, far from the perception and complexity created from the brutality of the centralized communistic system trying to impose the so called voluntary cooperation. We tried to maintain this taxonomy while grouping our findings.

6.1 Factors impeding cooperative development

Economic conditions

- Primitive conditions of Albanian agriculture are not related only with low investment but also with poor policy implementation from government bodies. There is an unverified calculation that illustrates the brutality of farmer's condition. Is assumed that the rural population of Albania is almost 50% and most are farmers of any kind, they

provide almost 25% of the GDP of Albania and in return get only 1% from the government budget. Weak transportation infrastructure, lack of investment in irrigation systems, highly taxed land sale and rent transactions make farmers weak and unorganized.

- In the EU agriculture is highly subsidized and agriculture sizes up to 40% of the EU total budget. This illustrates the importance that agriculture has in providing to the economy and well-being of people. Growing demand for agricultural products due to urbanization and growing populations has made forecasting demand for such products a very debatable issue among researchers and policymakers all over the world. In Albania it seems that we do not fully grasp such implications related with importance of agriculture.
- In this category are included also historic occurrences conditioning unfolding events at certain point in time regarding agriculture and cooperative development. Such an occurrence might be forcing farmers in so called cooperatives 1990s and sizing their properties, therefore leaving a deeply rooted biased judgment about such organizational forms. In every country, even a century ago, cooperatives were voluntarily organized and administered organizations. This biased judgment could be noticed among farmers, especially those relatively in age.
- The local government has contributed less investment in Fier. Against high production figures, units of local government have invested a lower level below the average nationwide investment, not giving their contribution in pushing the development in this region with revenue contribution to regional and national.
- Fier region is a region with deep agricultural development, where 81.4% of people in the region work in the private agricultural sector. This number is significantly higher than the national average of employees in agriculture, which is 58.2%.
- The agricultural sector provides employment and higher potential

output. Currently, this section provides a reduced contribution to GDP (22% from 55.8%) employing a declining number of individuals. This makes up an argument to seek better ways of organizing work in agriculture aiming to increase production and reduce costs, both achieved through economies of scale that give more yield as bigger the agricultural business grows.

- As in the entire country, in the Municipality of Lushnja and Fier region there is a need for more extensive agricultural mechanics. This finding is not only the result of discussions with farmers and analysis of figures with specialists but comes also from the comparison to other regional countries. Macedonia is a country with potential in agriculture not better than that of Albania. In Macedonia over 1,200 tractors per 100 km² of arable land are used. While the same figure is only 265 for the district of Fier, a high figure compared with other regions in Albania, but still far from developing a mechanized agriculture. In the Municipality of Lushnja this figure is even lower at 206 tractors per 100 km².
- In multiplicity of Lushnja operate 29 branches and banking agencies, savings and credit unions and other microcredit institutions. Obviously more important than the number of financial institutions is the volume of financing. What we can see is the low interest of banking institution for financing the sector.

Farmers organizing capabilities

- One important finding related with farmers capabilities was the lack of awareness related with the concept of cooperatives, their benefits, structure, and why was it important. We found from our interviews that they went through many kind of trainings and programmes, which at the end left them with unquestioned answers and no solutions. It means that for a long time there has not been any initiative to raise awareness toward cooperatives and to deflamate the old presumption that stuck from history.

- Quality of leadership among farmers, which is crucial for an organization nowadays, was poor, not to say inexistent. It does not even go to a leadership struggle that has its own process. This comes for several reasons. Literature recognizes that in developing countries cooperative initiatives have failed through the years due to lack of loyalty from its members which in most of cases coming from their ignorance. This is the exact case in Albania as we found through our research. Not being aware, not knowing the context, and not having any expertise destroys motivation and beliefs on such intent. Interesting to this point is an observation that was observed right at the point but understood later. Several farmers producing dairy products had form a cooperative like organization that had created leverage with some milk buyers and had some machinery giving cheap services for its members, and services at market prices for non members. When we went to interview them, we found out that this was the result of a Dutch project started almost ten years ago. What was most interesting was that in the meeting with presumably all of them the head of a cooperative was a middle aged man and the rest surrounding the table were all women. From one hand this explains the trust issues, leadership problems, and lack of structure on the matter. Because having women in such contexts releases all the pressure that comes from such organizational needs automatically. On the other hand, it pushes toward gender balance and woman empowerment, however paradoxally it might sound.

- Even in those cooperative like initiatives, such the one mentioned above, the lack of accountability and clear rules was duly noted. No management and administrative structures to sustain and develop the structure, thereby producing situations with potential moral hazards.

- The most evident was the lack of knowledge and experience in management related topics.

- Land division (parcelization) is as much farmers responsibility as public policy responsibility. Farmers have failed to group and profit from economies of size of their land. Their financial capabilities also

restrain their machinery buying options, thereby the low mechanization of agriculture.

Public policy

- Literature supports the view that institutional infrastructure is associated with economic growth. The Albanian institutional architecture is de jure in place, however the real interactions among institutions and farmers are inexistent. Government services and consultancy from its offices is not relatively inexistent, but lack professionalism and do not respond to farmers needs.
- Closing and degradation of research institutes has made it impossible for farmers to test inputs, materials, or even carry out land analysis. Moreover, there are is no R&D related with agriculture, most of them are irrelevant and full of plagiaries studies that are of no service.
- As noted above, the lack of so much needed subsidies shows a wrong public policy going on for too long. Despite that, farmers in Albania lack stable sources of energy supplies and road infrastructure. The most needed and most debated public policy is that related with the prices of inputs in agriculture. The Albanian government has failed for more than two decades to implement a scheme that reduces the price of fuel. Fuel prices are the highest in the region and one of the main cost components of production. Another essential cost component for farmers are those of farming inputs, including: seeds, pesticides, etc. Farmers pay VAT tax of 20% on all those inputs, thereby inflating production costs in comparison with other farmers without even starting to harvest.

7. REKOMANDIMET

